



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 maj 2025
Nr. ref.:AGJ 2689/25

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KO152/24 dhe KO158/24

parashtrues

**të kërkesës KO152/24, Abelard Tahiri dhe 9 deputetë të tjerë të Kuvendit
të Republikës së Kosovës;
të kërkesës KO158/24, Arben Gashi dhe 9 deputetë të tjerë
të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-289
për Komisionin e Pavarur të Mediave**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KO152/24 është parashtruar nga Abelard Tahiri, Ariana Musliu-Shoshi, Ardian Kastrati, Rashit Qalaj, Bekim Haxhiu, Blerta Deliu-Kodra, Eliza Hoxha, Ferat Shala, Hajdar Beqa dhe Hisen Berisha, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës/kërkesave).

2. Kërkesa KO158/24 është parashtruar nga Arben Gashi, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Agim Veliu, Besian Mustafa, Doarsa Kica-Xhelili, Dritan Selmanaj, Kujtim Shala, Hykmete Bajrami dhe Rrezarta Krasniqi, deputetë të Kuvendit të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK), të cilët i përfaqëson deputeti Arben Gashi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës/kërkesave).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës KO152/24, kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 4 (Kompetencat e KPM-së), 10 (Edukimi medial), 12 (Politika e transmetimit), 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM), 17 (Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të KPM), 18 (Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së), 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve) dhe 60 (Sanksionet me gjobë) të Ligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), të miratuar me Vendim [nr. 08-V-769] të Kuvendit, të 11 korrikut 2024. Ndërsa, parashtruesit e kërkesës KO158/24, kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar, nëpërmjet Vendimit [nr. 08-V-769] të Kuvendit, të 11 korrikut, si dhe kushtetutshmërinë e dispozitave të neneve 4, 14 (Përbërja e KPM), 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar.
4. Parashtruesit e kërkesës KO152/24, kërkojnë gjithashtu nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), që të zbatojë dispozitat e nenit 43 të Ligjit për Gjykatën (në tekstin e mëtejme: Ligji), për sa i përket efektit pezullues *ex-lege* të zbatimit të Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, duke u bazuar në praktikën e Gjykatës dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efektet e Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Ndërsa, parashtruesit e kërkesës KO158/24, kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 116 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, dhe rregullin 55 (4) (c) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës), për të evituar pasojat (dëmet) e pariparueshme, që mund të shkaktojë Ligji i kontestuar, në (i) kredibilitetin e Republikës së Kosovës (ii) në medie; (iii) në lirinë e medias; dhe (iv) lirinë e shprehjes.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes së kërkesës KO152/24 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së përmbajtjes së dispozitave të neneve 4, 10, 15, 17, 18, 43 dhe 60 të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesit e kësaj kërkeje pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 42 [Liria e Mediave], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës.
6. Ndërsa, objekt i çështjes së kërkesës KO158/24 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së (i) procedurës së ndjekur gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar, nëpërmjet Vendimit [nr. 08-V-769] të Kuvendit, të 11 korrikut 2024, me pretendimin se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është kundërkushtetuese, si dhe (ii) vlerësimi i kushtetutshmërisë së përmbajtjes së dispozitave të neneve 4, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar, me pretendimin se të njëjtat nuk janë në përputhshmëri me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 42 [Liria e Mediave], 54 [Mbrotjtja

Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medie] të Kushtetutës.

Baza juridike

7. Kërkesat bazohen në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

8. Më 18 korrik 2024, parashtruesit e kërkesës KO152/24 e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
9. Më 19 korrik 2024, parashtruesit e kërkesës KO158/24 e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
10. Më 24 korrik 2024, Kryetarja e Gjykatës, nëpërmjet Vendimit [Nr. GJR. KO152/24], për rastin KO152/24, caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues dhe nëpërmjet Vendimit [Nr. KSH. KO152/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
11. Po të njëjtën ditë, Kryetarja, në pajtim me nënregullin (3) të rregullit 32 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores, nëpërmjet Urdhrit [KO152/24 dhe KO158/24], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO158/24 me kërkesën KO152/24. Bazuar në nënregullin (3) të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën KO152/24.
12. Më 26 korrik 2024, Gjykata për regjistrimin e kërkesave KO152/24 dhe KO158/24 dhe bashkimin e tyre njoftoi parashtruesit e kërkesave. Po ashtu, në të njëjtën ditë, në cilësinë e palëve të interesuara nga një kopje e kërkesave iu dërgua: (i) Presidentes së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit), me kërkesën që kopjet e kërkesave t'i u shpërndahen të gjithë deputeteve të Kuvendit; (iii) Kryeministrit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iv) Avokatit të Popullit; (v) Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit; (vi) Komisionit të Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejme: KPM); dhe (vii) Asociacionit të Gazetareve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AGK).
13. Palët e interesuara u njoftuan gjithashtu për (i) bashkimin e kërkesave, në pajtim me nënregullin (3) të rregullit 32 të Rregullores; dhe (ii) për mundësinë e dorëzimit të komenteve, nëse kanë, deri më 9 gusht 2024. Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit iu kërkuar të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me Ligjin e kontestuar. Ndërsa, Gjykata për efektet e kontestimit të Ligjit të kontestuar në Gjykatë, njoftoi: (i) Presidenten, (ii) Kryetarin e Kuvendit dhe (iii) Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, duke ua rikujtuar kërkesat e paragrafit 2, të nenit 43 të Ligjit për Gjykatën, i cili përcakton: “... në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me

modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”. Gjykata sqaroi se kjo dispozitë e Ligjit nënkupton që Ligji i kontestuar, nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, ose të prodhojë efekte ligjore deri në vendimin final të Gjykatës, lidhur me çështjen e ngritur pranë saj.

14. Më 2 gusht 2024, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit të kontestuar në Kuvend, dorëzoi dokumentet si në vijim:
 1. Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media (në tekstin e mëtejshëm: Projektligjin për KPM-në), së bashku me memorandumën shpjegues dhe shkresat përcjellëse të procedura nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria), më 11 janar 2024;
 2. Raportin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal, për shqyrtim në parim të Projektligjit për KPM, nr. 08/5031/L-289, të 7 shkurtit 2024;
 3. Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal, për shqyrtim në parim të Projektligjit për KPM-në, nr. 08-V-697, të 7 shkurtit 2024;
 4. Kopjen e Vendimit të Kuvendit, për miratimin në parim të Projektligjit për KPM-në, nr. 08-V-697, të 7 marsit 2024;
 5. Pjesë nga transkriptet e seancave plenare, për shqyrtimin e parë të Projektligjit për KPM-në, të 15 shkurtit dhe 7 marsit 2024;
 6. Pjesë nga procesverbalet e seancave plenare të Kuvendit, për shqyrtimin e parë të Projektligjit për KPM-në, të 7 marsit 2024;
 7. Komentet e Zyrës së BE-së për Projektligjin për KPM-në, të 22 marsit 2024;
 8. Komentet e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: OSBE), lidhur me Projektligjin për KPM-në, të marsit 2024;
 9. Komentet e KPM-së, lidhur me Projektligjin për KPM-në;
 10. Qëndrimet e “BIRN” dhe “Internews Kosova”, lidhur me Projektligjin për KPM-në;
 11. Rekomandimet e forumit për integritet të informacionit, lidhur me Projektligjin për KPM-në, të 25 marsit 2024;
 12. Raportin e Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit, lidhur me Projektligjin për KPM-në, të 23 prillit 2024;
 13. Opinionin ligjor të Këshillit të Evropës lidhur me Projektligjin për KPM-në, të 24 majit 2024;
 14. Raportin me amendamente lidhur me Projektligjin për KPM-në, i Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal, të 5 qershorit 2024;
 15. Raportin final me amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal, të proceduara për shqyrtim dhe votim në seancë plenare, nr. 08/5551/L-289, të 6 qershorit 2024;
 16. Raportin final me amendamente të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere nr. 08/5496/L-289, të 6 qershorit 2024;
 17. Raportin e Komisionit për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit nr. 08/5505/L-289, të 6 qershorit 2024;
 18. Raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nr. 08/5519/L-289, të 7 qershorit 2024;
 19. Raportin e Komisionit për Integritet Evropian, nr. 08.5542/L-289, të 19 qershorit 2024;

20. Kërkesën e Kryetarit të GP të PDK-se, Abelard Tahiri për tërheqjen nga shqyrtimi në Kuvend të Projektligjit për KPM-në, të 11 korrikut 2024;
 21. Kopjen e Vendimit të Kuvendit, për miratimin e Ligjit për KPM-në, nr. 08-V-769, të 11 korrikut 2024;
 22. Ligjin e kontestuar.
15. Më 2 gusht 2024, Kryetari i Bordit të AGK-së kërkoi nga Gjykata afat shtesë deri më 20 gusht 2024 për dorëzimin e komenteve në lidhje me kërkesat e parashtruesve të kërkesës, me të cilat është kontestuar kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar.
 16. Më 6 gusht 2024, Gjykata njoftoi Kryetarin e Bordit të AGK-së për miratimin kërkesës së tij, për dhënie të afatit shtesë për dorëzimin e komenteve. Rrjedhimisht, Gjykata njoftoi AGK-në, që komentet në lidhje me Ligjin e kontestuar, duhet t'i dorëzonte në Gjykatë, jo më vonë se 20 gushti 2024.
 17. Më 9 gusht 2024, Gjykata, në lidhje me kërkesat, pranoi komente nga (i) Kryeministri, në emër të Qeverisë; dhe (ii) Avokati i Popullit.
 18. Më 20 gusht 2024, AGK-ja, në lidhje me Ligjin e kontestuar, i dorëzoi komentet në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesave dhe palët e interesuara për pranimin e komenteve nga (i) Kryeministri; (ii) Avokati i Popullit; dhe (iii) AGK-ja.
 19. Më 18 shtator 2024, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që shqyrtimin e kërkesave ta shtyjë për një seancë të radhës, pas plotësimeve shtesë.
 20. Më 10 tetor 2024, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që shqyrtimin e kërkesave ta shtyjë për një seancë të radhës, pas plotësimeve shtesë.
 21. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24], gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.
 22. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024, të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë, bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërzhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
 23. Më 16 prill 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesave për shqyrtimin në merita.

24. Më 16 prill 2025, Gjykata njëzëri vendosi që (i) të deklarojë kërkesat të pranueshme; si dhe (ii) të konstatojë, se nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medie] të Kushtetutës; (iii) të konstatojë se nënparagrafët 3.4 dhe 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 (Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medie] të Kushtetutës; (iv) të konstatojë se nënparagrafët 2.4 dhe 2.5 të paragrafit 2 të nenit 4 (Kompetencat e KPM-së), paragrafi 5 i nenit 25 (Leja e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre) dhe paragrafi 2 i nenit 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (v) të konstatojë, se pikat 1.2.1 dhe 1.2.24 e nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1, dhe pikat 1.3.5 dhe 1.3.6 të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 60 (Sanksionet me gjobë) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (vi) të konstatojë se Ligji i kontestuar, shfuqizohet; si dhe (vii) të refuzojë kërkesat për masa të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

25. Në vitin 2021, Qeveria kishte iniciuar procedurën për draftimin e Ligjit të kontestuar.
26. Nga 15 nëntori 2021 deri më 3 dhjetor 2021, Projektligji për KPM-në ishte vendosur në konsultime publike përmes platformës për konsultime publike të Qeverisë.
27. Më 27 shtator 2022, ishte nxjerrë Opinioni i Ministrisë së Financave përkitazi me koston buxhetore të Projektligjit për KPM-në, ndërsa më 17 tetor 2022, Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit kishte nxjerrë Deklaratën e Përputhshmërisë me *Acquis* të Bashkimit Evropian.
28. Më 27 dhjetor 2023, Qeveria përmes Vendimit [Nr. 03/180] miratoi Projektligjin për KPM-në.
29. Më 11 janar 2024, Projektligji për KPM-në, së bashku me shkresat përcjellëse, përfshirë Memorandumin Shpjegues dhe listën me komente nga institucionet e administratës publike dhe organizatave të shoqërisë civile përkitazi me Projektligjin e KPM-së, u procedua në Kuvend për shqyrtim parlamentar.
30. Më 15 janar 2024, Kryetari i Kuvendit ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin e mëtejme: Komisioni funksional) që të shqyrtojë Projektligjin për KPM-në dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.
31. Më 7 shkurt 2024, Komisioni funksional, pas shqyrtimit të parë të Projektligjit për KPM-në, Kuvendit i rekomandoi miratimin e të njëjtit në parim.
32. Më 7 mars 2024, Kuvendi, pas shqyrtimit të parë, nëpërmjet Vendimit [Nr. 08-V-698] me gjashtëdhjetë e një (61) vota “për” dhe një (1) “kundër”, e miratoi në parim Projektligjin për KPM-në. Kuvendi, nëpërmjet të njëjtit vendim, ngarkoi (i) Komisionin funksional; si dhe (ii) Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Integrim Evropian dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (në tekstin e mëtejme: Komisionet e përhershme), që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të

shqyrtojnë Projektligjin për KPM-në dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandimet e tyre.

33. Gjatë muajit prill 2024, diskutime publike përkitazi me draftin e Ligjit të kontestuar janë organizuar në shtatë (7) rajone kryesore të vendit, ndërsa një dëgjim publik ishte organizuar nga Kuvendi, më 25 mars 2024
34. Ndërmjet 5 qershorit 2024 dhe 19 qershorit 2024, komisionet e përhershme dorëzuan raportet e tyre në lidhje me Projektligjin për KPM-në.
35. Më 21 qershor 2024, Komisioni funksional, pas shqyrtimit të Projektligjit për KPM-në, miratoi Raportin me rekomandime. Raporti përfundimtar i Komisionit funksional, së bashku me amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit, me rekomandimin që Projektligji për KPM-në, bashkë me amendamentet e propozuara, të miratohet.
36. Kuvendi, pasi pranoi raportin final nga Komisioni funksional, ftoi deputetët në seancë plenare të radhës, ku ndër të tjera, pikë e rendit të ditës ishte edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për KPM-në.
37. Më 11 korrik 2024, Kuvendi, pas shqyrtimit të dytë, me pesëdhjetë e nëntë (59) vota “për”, asnjë “kundër” dhe dy (2) “abstenime”, e miratoi Ligjin e kontestuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO152/24

38. Parashtruesit e kërkesës KO152/24 pretendojnë se nenet 4, 10, 12, 15, 17, 18, 43 dhe 60 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 42 [Liria e Mediave], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme], dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës.
39. Në vijim, Gjykata do të reflektojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO152/24 për mospërputhshmërinë e neneve specifike të Ligjit të kontestuar me nene specifike të Kushtetutës.

I. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 4 (Kompetencat e KPM-së) të Ligjit të kontestuar, me nenet 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës

40. Parashtruesit e kërkesës KO152/24 theksojnë se në bazë të nenit 141 Kushtetutës, KPM është organ i pavarur që rregullon spektrin e frekuencave transmetuese në Republikën e Kosovës, i cili licencon transmetuesit publikë dhe privatë, si dhe përcakton e zbaton politikën e transmetimit, duke përfshirë edhe ushtrimin e kompetencave të tjera të përcaktuara në ligj. Parashtruesit theksojnë përderisa Kushtetuta i ka rezervuar një vend të veçantë KPM-së në kapitullin XII të saj [Institucionet e pavarura], neni 4 i Ligjit të kontestuar, përveç tjerash përcakton kompetencën e KPM-së në paragrafin 2.21, që të themelojë Komisionin e Ankesave për të trajtuar ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, si dhe hartimin dhe miratimin e rregullores për funksionimin e këtij Këshilli.
41. Në këtë mënyrë, derisa Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejme: Ligji aktual në fuqi apo Ligji i vitit 2012), nga neni 36 (Bordi i Ankesave) e deri

në nenin 44 (Vendimet e Bordit të Ankesave), ka përcaktuar në mënyrë të qartë dyshkallshmërinë e vlerësimit të kërkesave apo ankesave të subjekteve ndaj të cilave zbatohet ky ligj, Ligji i kontestuar, në mënyrë kundër kushtetuese, e shuan ekzistencën e Bordit të Ankesave, si një organ i shkallës së dytë në procedurë administrative dhe i pavarur për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të KPM-së, duke e shkelur kështu nenin 32 të Kushtetutës, sipas të cilit, çdo person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat i cenojnë të drejtat dhe interesat e tij/saj. Për më tepër, parashtuesit e kërkesës theksojnë se përderisa ligji aktual në fuqi, në nenin 44 kishte të rregulluar efektin juridik të vendimeve të Bordit të Ankesave, si vendime përfundimtare në procedurë administrative ndaj të cilave ligji ka lejuar shprehimisht të drejtën e subjekteve që të ndiqnin të drejtën e tyre ligjore me mjete juridike në rrugë gjyqësore, Ligji i kontestuar jo vetëm se shkel garancinë për shqyrtimin administrativ, sipas nenit 32 të Kushtetutës, por edhe i zhvesh subjektet ndaj të cilave zbatohet ky ligj, nga e drejta për të gëzuar mbrojtjen gjyqësore me rastin e shkeljes apo mohimit të një të drejte ligjore. Parashtuesit e kërkesës theksojnë se nuk e kontestojnë krijimin, respektivisht ekzistencën e Komisionit për Ankesa të krijuar përmes Ligjit të kontestuar, por konsiderojnë se ky komision, duke qenë se zgjidhet nga ana e vetë KPM-së, nuk mund të bëjë vlerësim të paanshëm dhe të pavarur të ligjshmërisë së vendimeve të KPM-së, e për rrjedhojë, një instancë e tillë ankimimi është qartazi joefektive. Sipas parashtuesve të kërkesës KPM-ja, duke qenë institucion i pavarur kushtetues, ka dështuar që të sigurojë mjete juridike efektive të cilat sigurojnë efektivisht vlerësimin e ligjshmërisë nga një organ i shkallës së dytë në procedurë administrative, siç është rasti me ligjin aktual në fuqi, i cili nëpërmjet Bordit për Ankesa siguron kontrollin administrativ të ligjshmërisë së punës së KPM-së, e të cilin po ashtu në një procedurë të veçantë zgjedhore e zgjedhë Kuvendi.

II. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 10 (Edukimi medial) të Ligjit të kontestuar dhe nenit 12 (Politika e transmetimit) me nenin 42 [Liria e Medias] të Kushtetutës

42. Tutje, parashtuesit e kërkesës theksojnë se përkundër faktit që paragrafi 1 i nenit 10 i Ligjit të kontestuar përcakton përgjegjësinë e KPM-së për të përgatitur "*materiale tekstuale, animacione, video dhe forma tjera të komunikimit për të promovuar edukimin medial*", paragrafët 2, 3 dhe 4 të tij, nëpërmjet të cilëve Radio Televizioni i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: RTK), si dhe kanalet e tjera gjeneralistike, obligohen që të transmetojnë materialet e përcaktuara nga ana e KPM-së, përbën cenim të parimit dhe garancisë së lirisë së medieeve, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 42 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, po ashtu neni 12 i Ligjit të kontestuar, në kuadër të përgjegjësisë së KPM-së, për të vendosur për politikën e transmetimit, në paragrafin 7 të tij ka imponuar detyrimin për transmetuesit që të rezervojnë të paktën 10% të kohës së tyre të transmetimit, si dhe 10% të buxhetit të tyre programor ta orientojnë "*për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesi*". Një përcaktim i tillë, theksojnë parashtuesit e kërkesës, përkundër se mund të ketë një qëllim legjitim, përbën një ndërhyrje joproporcionale në lirinë e garantuar të medieeve, në bazë të nenit 42 të Kushtetutës.

III. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 15 (Zgjedha e anëtarëve të KPM-së) të Ligjit të kontestuar, me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medieeve] të Kushtetutës

43. Në lidhje me këtë pretendim, parashtuesit e kërkesës theksojnë se Ligji i kontestuar, në paragrafin 1 të nenit 15 të tij, ka përcaktuar që anëtarët dhe Kryetari i KPM-së zgjidhen nga Kuvendi. Parashtuesit e kërkesës KO152/24, në fakt theksojnë se nuk e kontestojnë të drejtën e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët e KPM-së, por ky i fundit, duke qenë një

institucion i pavarur kushtetues me përbërje kolegjiale, theksojnë se zgjedhja e Kryetarit të KPM-së nga ana e Kuvendit dhe jo nga anëtarët tjerë të KPM-së përbën cenim të pavarësisë funksionale dhe organizative të këtij institucioni kushtetues. Si rezultat, parashtuesit e kërkesës theksojnë se zgjedhja e Kryetarit të KPM-së si organ kolegjial nga ana e Kuvendit, përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë të Kuvendit në pavarësinë vendimmarrëse të këtij institucioni, që shpie në krijimin e "varësisë" dhe "vartësisë" të Kryetarit të KPM-së, ndaj Kuvendit dhe jo ndaj KPM-së, në të cilin e ushtron funksionin e tij. Për dallim nga ky përcaktim dhe duke vendosur një tjetër standard për të njëjtin institucion, paragrafi 3 i nenit 17 të Ligjit të kontestuar, nga ana tjetër ka përcaktuar se nënkryetari i KPM-së zgjedhet nga anëtarët e KPM-së, *"me shumicë të thjeshtë, me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër, si dhe është i gjinisë tjetër nga Kryetari"*.

IV. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 17 [Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së] të Ligjit të kontestuar, me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës

44. Pretendimet për mospërputhshmërinë e paragrafit 1 të nenit 17 të Ligjit të kontestuar parashtuesit e kërkesës theksojnë se, përderisa kjo dispozitë e këtij neni përcakton se kryetari dhe anëtarët e KPM-së zgjidhen me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër, paragrafi 2 i të njëjtit nen ka krijuar mundësinë që në rast të dështimit për t'u zgjedhur kryetari dhe anëtarët e rinj të KPM-së, kryetari dhe anëtarët e KPM-së, të cilëve u ka skaduar mandati të vazhdojnë të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre deri në zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të rinj nga Kuvendi. Një standard i tillë i përcaktuar në këtë nen përbën një rast të paprecedent të përligjjes jokushtetuese të ushtrimit të funksionit dhe mandatit të anëtarit dhe/apo kryetarit të KPM-së dhe i cili bie në kundërshtim të plotë me paragrafin 1 të po të njëjtit nen, duke krijuar rrethana të pasigurisë juridike, respektivisht të cenimit të parimit të sundimit të ligjit, si njëra ndër vlerat e garantuara nga neni 7 i Kushtetutës dhe, si e tillë, është në shpërputhje të plotë me konceptin e mandatit si përkufizim kohor, por edhe në kundërshtim të plotë me standardet kushtetuese të aplikueshme për sa i përket ushtrimit të mandatit të mbajtësve të pozitave të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara jo vetëm në Kapitullin XII [Institucionet e pavarura] të Kushtetutës, por në raport me të gjitha pozitat e tjera mandatore të parapara në Kushtetutë, përveç atyre në Kapitullin XII.

V. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 18 (Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së) të Ligjit të kontestuar, me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, gjegjësisht me parimin e sigurisë juridike

45. Në lidhje me këtë pretendim, parashtuesit e kërkesës KO152/24 theksojnë se KPM, duke qenë institucion i pavarur kushtetues, i cili ka përbërje kolegjiale, me Ligjin e kontestuar është vënë në një situatë të pastër të "varësisë" dhe "vartësisë" nga Kuvendi, respektivisht nga shumica e thjeshtë e tij, edhe për sa i përket shkarkimit të kryetarit dhe anëtarit të KPM-së. Për dallim nga institucionet e tjera të pavarura kushtetuese nga njëra anë, si dhe për dallim nga ligji në fuqi nga ana tjetër, të cilat kanë përcaktuar se anëtari i një institucioni të pavarur kushtetues, respektivisht të KPM-së në rrethanat e rastit konkret, mund të bëhet me propozim të anëtarëve të vetë KPM-së. Ligji i kontestuar, në paragrafin 2 të nenit 18 ka përcaktuar mundësinë e vetme të shkarkimit të kryetarit dhe anëtarit të KPM-së, vetëm nga Kuvendi, respektivisht me propozim të Komisionit Parlamentar përgjegjës për media.
46. Në dritën e këtij pretendimi, parashtuesit e kërkesës konsiderojnë se përkitazi me këtë nen, janë me rëndësi të trajtohen, së paku tri aspekte: (i) që kryetari dhe anëtarët e KPM-

së, si një institucion i pavarur kushtetues, shkarkohen me shumicën e thjeshtë të Kuvendit, respektivisht me shumicën e njëjtë e cila i zgjedh dhe jo me shumicë më të madhe të deputetëve, në mënyrë që shkarkimi i tyre të reflektojë pavarësinë dhe paanësinë në raport, përveç tjerash, edhe me Kuvendin, pa frikën se ky i fundit mund t'i shkarkojë lehtësisht për veprimet dhe vendimet e tyre, siç është rasti p.sh. me Avokatin e Popullit, i cili bën pjesë në Kapitullin XII të Kushtetutës dhe i cili zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputeteve të Kuvendit, ndërsa shkarkohet me shumicën e të të gjithë deputeteve të tij, apo siç është rasti me anëtarët e KGJK-së dhe të KPM-së të cilët i zgjedh Kuvendi me shumicën e deputetëve të pranishëm, ndërsa të njëjtit mund t'i shkarkojë me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Pra, edhe në rastin e KPM-së, si një institucion i pavarur kushtetues, një standard i tillë për shkarkim do të duhej të ishte më i lartë se sa standardi për emërim; (ii) neni 18 i Ligjit të kontestuar, në paragrafin 3 të tij ka paraparë shprehimisht rrethanat, përmbushja e të cilave mund të çojë në shkarkimin e anëtarëve të KPM-së, por nuk ka paraparë rrethanat të cilat mund të çojnë në shkarkimin e kryetarit të KPM-së, përderisa për këtë të fundit edhe pse ka paraparë një procedurë të veçantë zgjedhore, nuk e ka përcaktuar asnjë rrethanë për shkarkimin e tij. Ky rregullim sipas parashtruesve të kërkesës qartazi përbën trajtim të pabarabartë para ligjit, në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, përderisa anëtarët e KPM-së i vendos në pozitë të pabarabartë në raport me kryetarin e këtij institucioni; dhe (iii) neni 18 i Ligjit të kontestuar, në nënparagrafin 5 të paragrafit 3 të tij, ka paraparë shprehimisht se si një nga rrethanat për shkarkimin e anëtarit të KPM-së është *"humbja e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM"*. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se kriteri i *"integritetit"* i propozuar në këtë nënparagraf, në kuptim të parimit të sigurisë juridike, nuk i përmbush kërkesat për *"qartësinë dhe saktësinë"* por dhe *"parashikueshmërinë"* e normës ligjore, aq më tepër për faktin se propozuesi i Ligjit të kontestuar, në dokumentacionin përgatitor të cilin e ka dërguar në Kuvend, nuk ka qartësuar dhe përkufizuar se për qëllime të *"integritetit"* cilat janë rrethanat që e cenojnë të njëjtin, në mënyrë që të konstatohet qartë dhe në mënyrë të parashikuar, se si përmbushet, ose jo, një kriter i tillë. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se çështja e *"humbjes së besimit nga organi mbikëqyrës"* (Kuvendi), përbën një standard të pashembullt dhe të pa aplikueshëm për sa i përket institucioneve të pavarura kushtetuese, siç është KPM-ja. Në këtë mënyrë, anëtarin e KPM-së e vendos para një situatë të ekspozimit të vazhdueshëm për shkarkim, rrethanë e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon edhe në ushtrimin e detyrës dhe funksionit të tij në mënyrë *"të anshme"* dhe *"të varur"* nga një shumicë e thjeshtë parlamentare.

VI. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 43 [Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve] të Ligjit të kontestuar, me nenin 42 [Liria e Mediave], në ndërlidhje me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës

47. Parashtruesit e kërkesës KO152/24 pretendojnë se Ligji i kontestuar, në paragrafin 1, 2 dhe 4 të nenit 43 vendos detyrime për subjektet e licencuara/regjistruara për sa i përket ndryshimit të pronësisë dhe aksioneve të subjektit, në atë mënyrë që për secilin ndryshim jo vetëm që ta njoftojë me shkrim KPM-në, por madje edhe të marrin aprovimin paraprak me shkrim të këtij institucioni nëse vëllimi i ndryshimit të pronësisë është mbi 10% të vlerës së aksioneve. Përveç këtyre detyrimeve, në paragrafin 4 të këtij neni, subjektit të licencuar/regjistruar i ndalohet zotërimi i më shumë se 10% të aksioneve të një subjekti tjetër i licencuar. Në këtë kuptim, vendosja e detyrimeve të tilla sipas parashtruesve të kërkesës përbën ndërhyrje flagrante në lirinë e medieve nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe përbën ndërhyrje flagrante në të drejtën në veprimtari ekonomike, si një e drejtë

kushtetuese e cila, përveç tjerash, në rrethanat e rastit konkret është e rregulluar edhe me legjislacionin në fuqi për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe cenimi i saj përbën edhe shkelje të paragrafit 1 të nenit 119 të Kushtetutës, sipas të cilit, Republika e Kosovës është e obliguar të sigurojë një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e lirë të tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.

VII. Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 60 [Sanksionet me gjobë] të Ligjit të kontestuar, me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës

48. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kërkesës KO152/24 pretendojnë Ligji i kontestuar ka përcaktuar se shkelja e dispozitave të tij nga subjektet ndaj të cilëve zbatohet, përbën bazë për shqiptimin e masave ndëshkuese, përkatësisht gjobave nga pesëqind (500,00), deri në katërmijë (4,000.00) euro, për personat fizikë, ndërsa për nga pesëqind, (500,00) deri në njëzetmijë (20,000.00) euro për personat juridikë. Ndërkohë që Ligji për Kundërvajtje, theksojnë parashtruesit, në mënyrë uniforme ka përcaktuar kundërvajtjet të cilat mund të aplikohen, përfshi këtu edhe subjektet e lidhura me *“informimin publik”*, duke përcaktuar kushtet nënë të cilat mund të shqiptohet gjoba, si e tillë. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë se kolizioni i ligjeve përbën bazë të mjaftueshme për cenimin e garancive kushtetuese, të tilla si parimi i sigurisë juridike, i ligjshmërisë dhe i parashikueshmërisë, si elemente të sundimit të ligjit, në kuptim të nenit 7 të Kushtetutës.
49. Si përmbledhje, parashtruesit e kërkesës, theksojnë: *“Për sa më sipër, nën dritën e fakteve dhe mbrojtjes së garancioneve kushtetuese mbi pavarësinë e KPM-së, garancione këto të shkelura me ligjin kontestues (në nenet e lartcekura të tij), kërkojmë nga Gjykata si institucion kushtetues e i pavarur i mbrojtjes së e kushtetutshmërisë që e bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar dhe ta shfuqizojë pjesërisht atë, si të pa bazuar dhe i papajtueshëm me Kushtetutën. Si parashtrues të kërkesës, jemi të bindur se ligji kontestues, nuk ka bazë kushtetuese e ligjore, është në kundërshtim me pari me rendin demokratik të Republikës së Kosovës, cenon dhe minon pavarësinë e institucioneve të pavarura dhe lirinë e medias, si e drejtë kushtetuese.”*
50. Sa më sipër, parashtruesit e kërkesës KO152/24, bazuar në pretendimet e elaboruara të kësaj kërkeje, duke u mbështetur në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i propozojnë dhe kërkojnë Gjykatës që sipas përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore të nxjerrë Aktgjykim, dhe (i) të shpallë të pranueshme kërkesën; dhe (ii) të shpallë nenet 4, 10, 15, 17, 18, 43 dhe 60 të Ligjit Nr. 08/L-289 për KPM-në, në kundërshtim me Kushtetutën.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO158/24

51. Parashtruesit e kërkesës KO158/24, pretendojnë së Vendimi [nr. 08-V-769] i Kuvendit, i 11 korrikut 2024, për miratimin e Ligjit të kontestuar është kundërkushtetues, sepse është shkelur procedura e përcaktuar me aktet juridike në fuqi, gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar nga Kuvendi. Për më tepër, të njëjtit po ashtu pretendojnë se nenet 4, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 42 [Liria e Mediave], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës.
52. Në vijim, Gjykata do t'i reflektojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO158/24 për (i) shkeljen e procedurës së ndjekur nga Kuvendi gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar, dhe

(ii) në mënyrë të përmbledhur do t'i paraqesë pretendimet për mospërputhshmërinë e neneve specifike të Ligjit të kontestuar, me nene specifike të Kushtetutës.

I. Pretendimet përkitazi me procedurën e ndjekur gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar në Kuvend

53. Parashtruesit e kërkesës KO158/24 theksojnë se Ligji i kontestuar është akt juridik me interes të përgjithshëm, i cili përmban rregulla të përgjithshme për rregullimin e fushave të një institucioni publik dhe të pavarur kushtetues, siç është KPM-ja. Dispozitat e Ligjit të kontestuar, sipas tyre, prekin liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, lirinë e mediave dhe të shprehjes së lirë, si dhe pavarësinë e KPM-së. Parashtruesit e kërkesës KO158/24 pretendojnë se gjatë procesit të hartimit të Ligjit të kontestuar nuk ka pasuar konsultime publike të mjaftueshme për përfshirje të mediave, gazetarëve, qytetarëve dhe të grupeve të interesit që ndikohen drejtpërdrejt nga ky ligj, duke theksuar se me këto veprime është cenuar rëndë transparenca dhe demokracia, si parime themelore kushtetuese në vendimmarrje për çështje me interes publik. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Komisioni funksional organizoi vetëm tre (3) ditë konsultime publike, respektivisht nga 21 marsi 2024, deri më 25 mars 2024, ku dy nga tre ditët ishin ditë vikendi, gjegjësisht ditë pushimi. Sipas parashtruesve të kërkesës konsultimet e duhura publike në lidhje me këtë ligj, mund të çonin në ndryshimin e draft-propozimit të Ligjit të kontestuar, nëpërmjet të cilit do të mund të nënvizoheshin problemet potenciale në fazën e hershme të procesit të miratimit, duke u dhënë kohën e duhur autoriteteve publike propozuese, në ndryshimin e draft-propozimit të Ligjit të kontestuar.
54. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës KO158/24 theksojnë se konsultimi publik është i rëndësishëm për të identifikuar pasojat e padëshiruara për lirinë e medias dhe për lirinë e shprehjes, si parime fundamentale kushtetuese. Sipas tyre, pjesëmarrja e qytetarëve, e mediave, gazetarëve dhe e palëve tjera të interesuara, në diskutime publike në procesin e hartimit të ligjeve nga Kuvendi është thelbi i demokracisë dhe parim themelor kushtetues. Si përfundim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Komisioni funksional dështoi në dhënien e mundësisë dhe të kohës së duhur të përfshirjes së qytetarëve, mediave, gazetarëve dhe palëve të interesuara në diskutime publike përgjatë procesit të hartimit dhe miratimit të këtij ligji.

II. Pretendimet përkitazi me mospërputhshmërinë e nenit 4 (Kompetencat e KPM-së) të Ligjit të kontestuar, 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 42 [Liria e Mediave], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës

55. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se pika 21 e nenit 4 të Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 24, 32, 42, 54 dhe 119 të Kushtetutës, sepse ky nen cenon rëndë sigurinë juridike, të drejtën për mjete juridike, si dhe barazinë para ligjit të mediave, gazetarëve dhe atyre personave që afektohen nga ky ligj ose nga puna e të licencuarve sipas Ligjit të kontestuar. Parashtruesit e kërkesës tutje theksojnë se në asnjë dispozitë tjetër të Ligjit të kontestuar, Këshillit të Ankesave (neni 4, paragrafi 2.21) nuk i janë përcaktuar detyrat, nuk i është garantuar pavarësi në vendimmarrje nga KPM-ja, si dhe nuk i përcaktohet as strukturë e as përbërje, dhe as buxhet për të funksionuar si trupë e pavarur për shqyrtimin e ankesave të palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj, elemente të cilat sipas parashtruesve të kërkesës janë qenësore për të funksionuar si organ i pavarur që trajton ankesat e palëve. Tutje, në vazhden e

pretendimeve të tyre, theksohet se pavarësia e Këshillit të Ankesave duhet të jetë e garantuar me ligj dhe jo me akte nënligjore të aprovuara nga KPM-ja. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se nga teksti i dispozitës së nenit 2.21 nuk është e qartë nëse Këshilli i Ankesave trajton edhe ankesat e palëve, në raport me vendimet e KPM-së, dhe ky fakt, sipas tyre, cenon parimin e dyshkallshmërisë në vendimmarrje në procedurën e vendosjes për ankesat e palëve, si dhe nuk është e qartë procedura se si zgjedhën anëtarët e Këshillit të Ankesave, dhe mbi bazën e cilave kriterë dhe cila është përbërja e këtij organi.

56. Për të garantuar të drejtën për mjete juridike, siç e garanton neni 32 i Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Këshilli i Ankesave do të duhej të ishte organ i pavarur, i definuar në mënyrë të qartë me Ligjin e kontestuar, dhe jo me akt nënligjor, i cili duhet të ketë përbërje dhe strukturë të qartë dhe me buxhet të ndarë nga KPM-ja. Duke qenë se Këshilli i Ankesave i mungojnë atributet dhe elementet e lartcekura, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se neni 4, pika 2.21 i Ligjit të kontestuar, cenon të drejtat e palëve për mjete efektive juridike, të garantuara me Kushtetutë, ku përveç tjerash ekziston rreziku i krijimit të varësisë dhe vartësisë së Këshillit të Ankesave ndaj KPM-së, dhe të veprojë njëanshëm në raport me ankesat e palëve, duke u shndërruar në një mjet të KPM-së për të ndëshkuar të licencuarit dhe të regjistruarit, duke cenuar kështu edhe parimin kushtetues të lirisë së mediejeve.

III. Pretendimet përkitazi me mospërpushmërinë e neneve 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar, me nenet 42 dhe 141 të Kushtetutës

57. Parashtruesit e kërkesës, në këtë kontekst, theksojnë se paragrafi 2 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar nuk garanton barazi gjinore në përfaqësim në përbërjen e KPM-së, sepse në mënyrë të përgjithshme i referohet legjislacionit për barazi gjinore. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se nëse i referohemi Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, përkatësisht paragrafit 6 të nenit 8 të tij, vërehet qartë se në raport me KPM-në nuk ka dispozitë mandatore e cila kërkon përfaqësim në kuotën pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 2 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar ka diskriminim gjinor, sepse kjo dispozitë nuk ka precizuar në mënyrë të saktë përfaqësimin gjinor, për të garantuar kështu mosdiskriminimin gjinor, në përbërjen e KPM-së. Mbi këtë bazë parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shpallë kundërkushtetues këtë nen, duke detyruar Kuvendin që në përbërjen e KPM-së të evitohet diskriminimi gjinor.
58. Në vazhdim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nenet 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar, cenojnë pavarësinë dhe integritetin e KPM-së, nga shumica politike parlamentare, duke ndikuar drejtpërdrejtë në lirinë e mediejeve, duke pasur parasysh se të gjithë anëtarët kanë mandat katër (4) vjeçar, i jep varësi kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së ndaj shumicës politike parlamentare për të kontrolluar përbërjen e KPM-së. Duke pasur kontrollë dhe mbikëqyrje mbi anëtarët e KPM-së, shumica parlamentare, sipas parashtruesve të kërkesës mund të imponojë shkarkimin e kryetarit dhe të anëtarëve të KPM-së, dhe të krijojë varësi tek kryetari dhe anëtarët e KPM-së, ndaj shumicës politike parlamentare. Ky fakt, sipas parashtruesve të kërkesës, shprehet më së miri në gjuhën e vetë Ligjit të kontestuar, ku thuhet: *“Humbje e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit , qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar”*. Kjo dispozitë ligjore, theksohet se legjitimon dhe krijon mundësi ligjore për shumicën politike parlamentare, që duke përdorur funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, ndaj KPM-së, si organ i pavarur kushtetues, të shkarkojnë në çdo kohë, kryetarin dhe anëtarët e KPM-së, meqë Ligji i kontestuar nuk përcakton asnjë kriter matës *“të cenimit të*

integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar”, dhe se kjo mundësi është lënë tërësisht në diskrecion të organit mbikëqyrës të Kuvendit (shih, në këtë kontekst, dispozitat e nenit 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar).

59. Në vazhdim, parashtuesit e kërkesës theksojnë se pavarësia e KPM-së është e lidhur ngushtë me parimin kushtetues të lirisë së mediejeve, duke shtuar se kur cenohet pavarësia e KPM-së, shkelet dhe parimi kushtetues i lirisë së mediejeve. Mbi këto pohime, parashtuesit e kërkesës theksojnë se organizatat ndërkombëtare ku vendi ynë synon të anëtarësohet, siç është Këshilli i Evropës, OSBE-ja dhe Bashkimi Evropian kanë shprehur mospajtimet e tyre në lidhje me mënyrën dhe formën në të cilën është miratuar ky ligj nga shumica parlamentare, të cilat nëpërmjet opinioneve ligjore dhe raporteve të nxjerra kanë vlerësuar se është cenuar pavarësia e KPM-së dhe është rrezikuar liria e mediejeve. Tutje, theksohet se është në diskrecionin e Gjykatës për të vlerësuar rëndësinë juridike të këtyre dokumenteve të nxjerra nga këto organizata ndërkombëtare, lidhur me vendosjen e kësaj çështje kushtetuese.
60. Si përfundim, parashtuesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) të vendosë masë të përkohshme ndaj Ligjit të kontestuar, në pajtim me nenin 116.2 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 27.1 të Ligjit për Gjykatën, dhe rregullin 55. 4 (c) të Rregullores së punës; (ii) Të deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita dhe procedurë; (iii) të shpallë Ligjin e kontestuar dhe Vendimin [nr. 08/V-769] e Kuvendit, të 11 korrikut 2024, në tërësi, si të papajtueshme me Kushtetutën, përkatësisht me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Efektive], 42 [Liria e Mediave], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës; (iv) të shpallë të pavlefshëm, Ligjin e kontestuar dhe Vendimin [nr. 08/V-769] e Kuvendit, të 11 korrikut 2024.

Komentet e dorëzuara nga Kryeministri në emër të Qeverisë

61. Në cilësinë e palës së interesuar, Kryeministri, në emër të Qeverisë më 9 korrik 2024, dorëzoi komente në lidhje me kërkesat KO152/24 dhe KO158/24. Qeveria, fillimisht thekson se e drejta e mediejeve, njihet përmes nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) për garantimin e lirisë së shprehjes, duke iu referuar rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 6538/74, Vendimi i 26 prillit 1979. Parashtuesit e kërkesës, sipas Qeverisë, nuk kanë paraqitur asnjë argument që shpjegon se si Ligji i kontestuar kufizon mundësinë apo aftësinë e mediejeve për t'u shprehur lirshëm.
62. Për më tepër, në komentet e tij, theksohet se edhe nëse eventualisht parashtuesit do të argumentonin në ndonjë mënyrë se Ligji i kontestuar kufizon lirinë e shprehjes, për të konstatuar shkelje kushtetuese do të duhej argumentuar nga të njëjtit se këto kufizime megjithatë nuk janë të justifikuara dhe nuk ndjekin një qëllim legjitim, siç kërkon paragrafi 2 i nenit 10 të KEDNJ-së. Sipas Qeverisë, këta dy hapa nuk janë argumentuar nga parashtuesit e kërkesave, për të vërtetuar nëse Ligji i kontestuar ka prodhuar ndonjë shkelje të të drejtave kushtetuese apo të normës ndërkombëtare të inkorporuar në Kushtetutë. Tutje, Qeveria thekson se Ligji i kontestuar jo vetëm që nuk i shkel normat evropiane për të drejtat e njeriut, por edhe i zbaton ato në kuadër të Marrëveshjes ndërkombëtare të Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Evropian, nëpërmjet së cilës Republika e Kosovës ka marrë obligime në zbatimin e standardeve evropiane. Në komente, tutje theksohet se Ligji i kontestuar transponon Direktivën e Bashkimit Evropian për

Mediet Audio-Vizuele 2010/13, e 10 marsit 2010, e ndryshuar përmes Direktivës 2018/1808 të 14 nëntorit 2018 (në tekstin e mëtejshëm: Direktiva e AVMS-së) dhe bart frymën e saj.

I. Përkitazi me konsultimet publike

63. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për mungesë të konsultimeve publike, Qeveria thekson se, pas konsultimeve publike të mbajtura nga Zyra e Kryeministrit si sponsorizuese e Ligjit të kontestuar, nga 15 nëntori 2021 deri më 3 dhjetor 2021 është zhvilluar dhe procedura e diskutimit publik (25 nëntor 2021 dhe 6-7 shtator 2022), ku shoqëria civile, qytetarët, partnerët ndërkombëtarë dhe të gjitha palët e interesuara, kishin mundësinë e dërgimit të komenteve dhe kështu të bëheshin pjesa e hartimit të politikës së re që përcjell atë të BE-së, lidhur me KPM-në. Në vijim të komenteve theksohet se Zyra e Kryeministrit ka organizuar edhe tryezë me ekspertët e Bashkimit Evropian që kanë hartuar Ligjin për KPM-në, me palët e interesit e me përfaqësues të institucioneve publike, për të adresuar çdo pyetje lidhur me formën finale të Ligjit të kontestuar. Tutje, theksohet se për Ligjin e kontestuar ZKM është njoftuar se Komisioni përgjegjës i Kuvendit, në 7 rajone kryesore të vendit ka mbajtur edhe dëgjim publik. Në Ligjin e kontestuar theksohet se një numër i konsiderueshëm i amendamenteve janë përmirësuar dhe përsosur pas diskutimeve, andaj pretendimi se me këtë rast është shkelur parimi i sundimit të ligjit, sipas Qeverisë, nuk qëndron në asnjë rrethanë. Më tej, në komente theksohet se Ligji i kontestuar përfshinë legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe garanton trajtim të barabartë, profesional e të dinjitetshëm, për të siguruar cilësi në raport me rregullimin e sistemit medial në Kosovë dhe se përcaktimet e ligjit lidhur me funksionimin e KPM-së nuk bien ndesh me asnjë dispozitë të Kushtetutës. Kjo sepse Ligji i kontestuar, theksohet tutje, rregullon kompetencat e KPM-së në raport me Kushtetutën dhe parimet e lirisë së shprehjes, medias dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për qytetarët e Kosovës, veçanërisht për fëmijët.

II. Përkitazi me kompetencat e KPM-së, sipas nenit 4 (Kompetencat e KPM-së) të Ligjit të kontestuar

64. Pretendimi i parashtruesve të kërkesës për mospërpushmërinë e nenit 4 të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën, sipas Qeverisë tenton pasuksesshëm që të dëshmojë shkelje kushtetuese për mungesë të parashikueshmërisë, në ndërlidhje me Bordin që do të mbikëqyrte vendimmarrjen e KPM-së, më saktë të anëtarëve të KPM-së, të zgjedhur nga Kuvendi. Në vijim të komenteve, theksohet se parashtruesit e kërkesave pretendojnë se mungesa e një shkalle të dytë të ankesës në procedurën administrative, përbën shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, që rezulton në mohimin e ushtrimit të ankesës. Megjithatë, sipas Qeverisë një pretendim i tillë nuk përkon as me thelbin e nenit 32 të Kushtetutës dhe as me jurisprudencën e GJEDNJ-së, praktikë gjyqësore kjo në zbatim të KEDNJ-së. Qeveria mëton se as në Kushtetutë, as në KEDNJ, kjo e drejtë nuk garanton mundësinë e ankimit për posaçërisht përmes procedurës administrative, përderisa ekziston një formë tjetër e ankimit në nivelin kombëtar, e garantuar me ligj, përkatësisht në Gjykatë.
65. Në këtë drejtim, theksohet se vendimet e KPM-së nuk mund t'i nënshtrohen një komisioni tjetër si shkallë e dytë, brenda vet këtij institucioni, dhe se Kushtetuta nuk i njeh këto komisione ankesash si kategori kushtetuese, prandaj si të tilla nuk mund të jenë as të lejuara me ligj. Në vazhdim të komenteve theksohet se për të siguruar zbatimin e të drejtës në mjete juridike efektive në Republikën e Kosovës ekzistojnë dhe mund të përdoren pa asnjë pengesë gjykatat e të gjitha niveleve, siç u argumentua më lart dhe se vendimet e

KPM-së në rast kontestimi i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata, rregull ky i cili vlen për vendimet e të gjitha institucioneve të pavarura dhe agjencive të Kuvendit. Tutje, theksohet se as Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, as Organi Shqyrtues i Prokurimit, as Autoriteti i Konkurrencës, e as “KPM”, Zyra e Rregullatorit për Energji, e Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nuk kanë komision të ankesave përmbi organet e tyre kolegjiale, si rrjedhojë mundësia e ankesës në gjykatë për të kontestuar kundër vendimeve të KPM-së, e plotëson këtë kriter, andaj nuk mund të konstatohet shkelje e nenit 32 të Kushtetutës dhe mungesa e shfrytëzimit të mjeteve juridike efektive për të goditur vendimin. Për më tepër, në komente theksohet se Ligji i kontestuar qartazi thotë se Këshilli i Ankesave do trajtojë ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj dhe ky Këshill do të shërbejë për adresimin e ankesave të qytetarëve, lidhur me punën e të licencuarve dhe regjistruarve, dhe assesi nuk do të shërbejë si komision i ankesave ndaj vendimeve të KPM-së, pasi vendimet e KPM-se, si organ i pavarur kushtetues, janë përfundimtare në procedurën administrative.

III. Përkitazi me “nenin 9 dhe 12 - Edukimi medial dhe Politika e transmetimit”

66. Në lidhje me këtë nen (*shënim i Gjykatës*: komentet i referohen nenit 9 përkitazi me edukimin medial, megjithatë kjo çështje rregullohet me nenin 10 të Ligjit të kontestuar), Qeveria thekson se njëra nga kompetencat e KPM-së është edhe obligimi i RTK-së dhe i kanaleve tjera gjeneralistike të transmetojnë materialet mbi edukimin medial, dhe se kjo nuk mund të merret si ndërhyrje në politikat editoriale, por si detyrë që KPM duhet ta zbatojë në saje të kompetencave që ia ka dhe ligjvënësi, kjo përgjegjësi e KPM-së është qartazi e dhënë me ligj dhe si e tillë, është e njohur për publikun e gjerë. Në këtë kontekst, Kryeministri në emër të Qeverisë thekson se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtuesve të kërkesave për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës, kjo sepse të obliguarit për transmetim të edukimit medial në emër të vetë rregullatorit-KPM-së, nuk hyn në politika editoriale, nuk kufizojnë apo në çfarëdo mënyre tjetër ndikojnë në pavarësinë e mediumit për të transmetuar lajmin. Rrjedhimisht, nuk mund të pretendohet se këto dispozita të Ligjit të kontestuar shkelin nenin 42 të Kushtetutës.

IV. Përkitazi me nenin 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së)

67. Në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të KPM-së, Qeveria thekson se Ligji i kontestuar, parasheh përzgjedhjen e njëmbëdhjetë (11) anëtarëve të KPM-së nga Kuvendi, me tendencë që të sigurojë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të profesionistëve të fushës, duke zvogëluar dukshëm koncentrimin e pushtetit brenda një grupi të vogël njerëzish. Sipas Qeverisë, ligjvënësi ka paraparë kësaj edhe përzgjedhjen e kryetarit të KPM-së, nga Kuvendi, ashtu siç ka bërë me Organin Shqyrtues të Prokurimit apo Autoritetin e Konkurrencës, duke shtuar se kryesuesi i KPM-së është i pari ndër të barabartët, me peshë të njëjtë vote si çdo anëtar tjetër i KPM-së. Ligji i kontestuar parasheh se të gjithë anëtarët i përgjigjen komisionit përkatës të Kuvendit për punën e tyre. Pra, me faktin që kryetari përzgjedhet nga Kuvendi, si çdo anëtar tjetër, thekson Qeveria, nuk e dallon atë nga anëtarët tjerë, as në kuptim të performancës, e as të përgjegjësisë në vendimmarrje, brenda KPM-së. Në këtë kontekst, Qeveria i referohet paragrafit 2 të nenit 141 të Kushtetutës, që përcakton: *"Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent"*, duke theksuar tutje se askund në këtë dispozitë, apo në ndonjë dispozitë tjetër të Kushtetutës, nuk përmendet as shprehimisht, e as tërthorazi, se kryetari i KPM-së, duhet t'i nënshtrohet një procedure tjetër të përzgjedhjes që dallon prej procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të tjerë të KPM-së. Rrjedhimisht, komenti i parashtuesve të

kërkesës, sipas Qeverisë, nuk ka si të bëjë me shkelje të nenit 141, apo ndonjë dispozite tjetër të Kushtetutës.

V. Përkitazi me nenin 17 –(Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së)

68. Ligji i kontestuar, përcakton qartazi që anëtarët e KPM-së zgjidhen për një mandat katër (4) vjeçar dhe me pamundësi rizgjedhjeje. Një gjë e tillë, sipas Qeverisë, përkon edhe me nenin 141 të Kushtetutës dhe komentarin e Kushtetutës. Ky rregullim, sipas Qeverisë është bërë për të pamundësuar vakumin e pasigurinë juridike, në raport me ushtrimin e detyrës së kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj. Sipas Qeverisë, pretendimi i parashtruesve për cenimin e nenit 7 të Kushtetutës, nuk qëndron marrë për faktin se anëtarët e KPM-së zgjidhen nga Kuvendi, ashtu siç e përcakton vetë Kushtetuta. Prandaj, ky rregullim theksohet tutje është bërë për të pamundësuar dhe evituar pasigurinë juridike si dhe mungesën e rregullimit të sferës mediatike në Kosovë, dhe se në plotni këtë e ka bërë Kuvendi në përputhje me nenin 7 të Kushtetutës.

VI. Përkitazi me nenin 18 (Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së)

69. Në lidhje me shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, Qeveria i rikthehet sërish nenit 141 të Kushtetutës dhe komentarin të Kushtetutës (pa specifikuar të njëjtin), ku sqarohet se anëtarët e KPM-së zgjedhen nga Kuvendi, sipas procedurës së paraparë me ligj, duke shtuar se kompetencat e KPM-së, por edhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, shtuar edhe përbërjen e tyre, parashikohen me ligj. Kësisoj, sipas Qeverisë edhe shkarkimi i anëtarëve parashihet me ligj, ashtu siç bëhet edhe emërimi i tyre, prandaj numri i nevojshëm për emërim, aplikohet edhe për shkarkim, duke shtuar se kështu e parasheh ligji dhe nuk e kundërshton Kushtetuta. Tutje në komente theksohet se nuk mund të tërhiqet një paralele ndërmjet procedurës që parasheh përzgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit, të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Presidentit, e cila parashihet shprehimisht me Kushtetutë, për faktin se Kushtetuta rregullimin e KPM-së ia ka lënë Kuvendit nëpërmjet ligjit. Tutje theksohet se integriteti i anëtarëve nuk mund të matet me kuantitet, rrjedhimisht nuk mund të përkufizohet me nxjerrje të një numri të caktuar vendimesh, apo pjesëmarrjes në takime të KPM-së dhe se në anën tjetër pozitat publike nuk mund t'i takojnë apo vazhdojnë t'i takojnë dikujt që tregon mungesë integriteti, siç mund të konstatohet nga shumica e Komisionit Mbikëqyrës Parlamentar të KPM-së. Gjithashtu, sipas tyre, një anëtar mund të shkarkohet vetëm nëse për shkarkim voton shumica e deputetëve të Kuvendit. Në këtë linjë theksohet se anëtari i KPM-së nuk luan rolin e një gjyqtari, kompetencat e detyrat e të cilit kanë ndikim më të madh mbi të drejtat apo kufizimin e të drejtave të qytetarëve. Rrjedhimisht, marrë parasysh faktin që qëllimi i Kushtetutës është që rregullimi i KPM-së të lihet në duart e ligjvënësit, nuk mund të pretendohet që një ndër bazat për shkarkimin, si integriteti, të jetë në kundërshtim me Kushtetutën.

VII. Përkitazi me nenin 43 (Rregullimi i pronësisë së të regjistruarve/licencuarve)

70. Në këtë kontekst, Qeveria i referohet Direktivës AVSM [nr. 2010/13/EU] dhe opinionëve të Komisionit të Venecias në lidhje me Lirinë e shprehjes dhe të Medieve. Sipas Qeverisë, parimi i garantuar i lirisë së mediave ka si imperativ ndalimin e koncentrimin të pronësisë së mediave në të njëjtin pronar, prandaj neni 43 i Ligjit të kontestuar është zbrëthim në praktikë i rregullimit kushtetues për pluralizmin e mediave. Kjo dispozitë e Ligjit të kontestuar, sipas Qeverisë, jo vetëm që nuk e shkel nenin 42 të Kushtetutës, përkundrazi është masë e domosdoshme për zbatimin e këtij neni në praktikë. Në këtë linjë, për qëllime

të sigurimit të pluralizmit politik dhe funksionimit të demokracisë, komentet gjejnë referencë në Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili nuk lejon që një individ të jetë kryetar i më shumë se një subjekti politik. Qeveria thekson tutje se sipas parashtruesve të kërkesës, kjo mund të duket si kufizim i lirisë së asociimit, por ky fakt është absurd në vetvete, sepse një kufizim i tillë është i domosdoshëm për të siguruar pluralizmin politik, që pushteti politik të mos koncentrohet në duart e vetëm një ose më pak personave. Në këtë kuptim, pluralizmi medial është një çështje e rëndësishme së veçantë për KPM-në. Si pasojë, e njëjta duhet të rregullojë me ligj se si e garanton atë. Për më tepër, thekson Qeveria se përqindjet e përcaktuara nga Ligji i kontestuar janë tashmë pjesë e rregullores në fuqi të KPM-së, që përmbajnë standarde të pranueshme ndërkombëtarisht për sektorin dhe tregun mediatik, andaj, sipas tij, për t'u për siguruar pluralizmi medial duhet të ketë kufizim të qartë të koncentrimin të aksioneve të të njëjtit pronar, në media të ndryshme. Tutje, në komente theksohet se parashtruesit e kërkesës e kundërshtojnë faktin që Ligji i kontestuar kërkon që për çdo ndryshim në pronësi të informohet KPM-ja, përkatësisht të kërkohej leje nga i njëjti organ, kur ndryshimi i pronësisë është mbi dhjetë përqind (10%) të vlerës së aksioneve, duke pretenduar se neni 43 përbën ndërhyrje flagrante në veprimtari ekonomike, pasi ndalohej zotërimi i më shumë aksioneve në një subjekt tjetër të licencuar. Sipas Qeverisë, kërkesa për të marrë një miratim paraprak nga KPM-ja dhe për të njoftuar atë, në rast të ndryshimit të vlerës së aksioneve në një përqindje të caktuar është garanci që parandalon koncentrimin e pronësisë së medias në të njëjtin pronar, siç kërkon dhe direktiva AVMS dhe legjislacioni i BE-së, që çdo qytetar të jetë i njoftuar me përfituesit fundor të medias, dhe me këtë të dijë se kush ia plasoi lajmin dhe përmbajtjen mediatike. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës, theksohet në komentet e Qeverisë, nuk kanë arritur të dëshmojnë apo argumentojnë pretendimet e tyre për shkeljet e neneve 42 dhe 119 të Kushtetutës.

71. Si përfundim, referuar argumenteve të shtjelluara më lart, theksohet në komentet e Qeverisë, parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të argumentojnë se në Ligjin e kontestuar ka ndonjë element që është në kundërshtim me Kushtetutën, për më tepër që ky i fundit është hartuar duke transpozuar në formë të plotë, për aq sa ishte e mundur nga një vend jo-anëtar i BE-së, direktivën e AVMS, dhe se ky ligj po ashtu është në përputhje të plotë me Marrëveshjen ndërkombëtare të Stabilizimit Asociimit, si dhe parimet ndërkombëtare të lirisë së medias dhe pluralizmit mediatik.

Komentet e dorëzuara nga Avokati i Popullit

72. Më 9 gusht 2024, Avokati i Popullit, në cilësinë e palës së interesuar, ka dorëzuar komente përkitazi me kërkesat e parashtruesve. Avokati i Popullit vlerëson se çështja e lirisë së medieve dhe lirisë së shprehjes janë ngushtë të lidhura ndërmjet tyre, duke pasur parasysh këtë fakt konsideron se është shumë e rëndësishme të vlerësohet se çështjet kontestuese që janë ngritur në kërkesat KO152/24 dhe KO158/24, lidhur me Ligjin e kontestuar. Komentet e Avokatit të Popullit fokusohen në çështjet që ndërlidhen me (i) lirinë e medieve, e drejtë e garantuar me nenin 42 të Kushtetutës; (ii) lirinë e shprehjes, e drejtë e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës; dhe frymën e kapitullit dymbëdhjetë (XII) të Kushtetutës, që ka të bëjë me institucionet e pavarura kushtetuese.
73. Avokati i Popullit, nëpërmjet komenteve të tij, shprehet se për përmbajtjen e dispozitave të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, duke theksuar se për të nuk është kontestuese kompetenca e Kuvendit për shkarkimin e kryetarit apo anëtarit të KPM-së, sepse ashtu siç ka përcaktuar edhe Gjykata në disa nga rastet e saj, Kuvendi ka kompetencë mbikëqyrëse ndaj institucioneve publike. Megjithatë, sipas tij, në rastin konkret duhet pasur kujdes tek

procedurat e shkarkimit, përkatësisht tek shumica e cila kërkohet nga Kuvendi për shkarkimin e kryetarit apo anëtarit të KPM-së, si dhe tek rrethanat për të cilat mund të kërkohet shkarkimi. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit rikujton rastin KO134/21, paragrafin 114, ku Gjykata, ndër të tjera, kishte theksuar se: *"ushtrimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit është i rëndësishëm të posaçme veçanërisht në fushën e lirisë së medias marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e saj në një shoqëri demokratike [...]. Praktika gjyqësore e GJEDNj-së përcakton jo vetëm detyrimin e shtetit për të mos ndërhyrë në vlerat e lirisë dhe pluralizmit të mediave dhe në lirinë e shprehjes, por edhe detyrimet pozitive të shtetit [...]"*. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit thekson se duke pasur parasysh parimet e përcaktuara për lirinë e medieve, nëpërmjet së cilës garantohet liria dhe pluralizmi i medieve, dhe liria e shprehjes si liri që përfshinë të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush, në lidhshmëri me KPM-në, si institucion i pavarur kushtetues që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publikë e privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit, si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj, vlerëson se është i nevojshëm vlerësimi i Gjykatës lidhur me pajtueshmërinë e nenit 18 të Ligjit të kontestuar, përkitazi me procedurën e shkarkimit dhe të rrethanave për të cilat mund të shkarkohet kryetari apo anëtari i KPM-së.

I. Përkitazi me shkarkimin e kryetarit dhe anëtarit të KPM-së, sipas paragrafit 2 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar

74. Bazuar në këtë dispozitë, Avokati i Popullit konsideron se mundësia e shkarkimit të kryetarit apo anëtarit të KPM-së me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, në dukje shpërfaq mundësi shumë më të lehtë të ndikimit politik tek kryetari apo anëtari KPM-së, prandaj në rastin konkret, sipas Avokatit të Popullit shkarkimi i tyre me shumicë të thjeshtë mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e pavarur të KPM-së. Vendosja e mënyrës së shkarkimit të kryetarit apo anëtarit të KPM-së, me një shumicë më të lartë sesa shumica e thjeshtë, sipas tij, do të sillte siguri më të madhe tek kryetari apo anëtari i KPM-së, në ushtrimin e funksioneve të tyre. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se votimi për shkarkim të kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, me shumicë prej 2/3, do të ishte zgjidhje më e sigurt për funksionimin e pavarur të KPM-së.

II. Përkitazi me rrethanat për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarit të KPM-së, sipas paragrafit 3 të nenit 18.3 të Ligjit të kontestuar.

75. Nga analizimi i përmbajtjes së paragrafit 3, të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit thekson se mospërcaktimi i rrethanave për të cilat mund të shkarkohet kryetari i KPM-së, dhe përcaktimi i rrethanave për të cilat mund të shkarkohet anëtari i KPM-së, ngre çështje të trajtimit të pabarabartë ndërmjet kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së sipas nenit 24 të Kushtetutës, dhe ky mospërcaktim, sipas tij, mund të rezultojë me mundësinë e abuzimit me detyrën e kryetarit, sepse me Ligjin e kontestuar, përveç nënparagrafit 3.1 (paaftësia profesionale) Ligji i kontestuar nuk ka paraparë rrethanë tjetër për shkarkimin e kryetarit të KPM-së. Avokati i popullit thekson se duhet të ekzistojë përcaktueshmëria e normës për secilin institucion të pavarur, në mënyrë që të kërkohet shkarkimi i udhëheqësve apo anëtarëve, sepse përcaktimet e tilla rrisin përgjegjësinë e të njëjtëve, në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, në institucionet e pavarura kushtetuese. Avokati i Popullit thekson se formulimi i paragrafit 3, *"Shkarkimi i anëtarit të KPM-së bëhet si rezultat i këtyre rrethanave:"*, në zbatimin praktik sjellë paqartësi dhe pasaktësi, sepse ky paragraf i referohet shkarkimit të anëtarit

të KPM-së, ndërsa në nënparagrafin 3.1, shprehimisht përcaktohet: “3.1 paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t’i përmbushë detyrat e Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së”. Avokati i Popullit thekson se një formulim i tillë parqet pasiguri juridike për pozicionin e kryetarit të KPM-së, sepse bëhet e pakuptueshme se a vlen paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 edhe për kryetarin, apo vetëm për anëtarin e KPM-së. Sipas Avokatit të Popullit, pasiguria juridike e anëtarëve të KPM-së, rezulton edhe në faktin se norma nuk e ka sqaruar se cili institucion apo organ e vlerëson paaftësinë profesionale në të cilën dështojnë ta kryejnë anëtarët e KPM-së. Duke pasur parasysh faktin se kërkesën për shkarkim e bën komisioni parlamentar, është e rrezikshme që vlerësimi i paaftësisë profesionale t’i lihet në diskrecion komisionit parlamentar, sepse një normë e tillë do të rriste rrezikun e ndikimit politik në funksionimin e pavarur të KPM-së.

76. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se lënia në diskrecion të komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e punës së KPM-së, përkatësisht (i) vlerësimin të paaftësisë profesionale, dështimit të realizimit të detyrave për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muaj, pa aprovim nga KPM-ja, (ii) marrje pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM, duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje, apo (iii) humbjen e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM, i vë kryetarin dhe anëtarët e KPM-së në një situatë të pasigurisë juridike, sepse përcaktimet e përgjithshme ligjore, nuk e qartësojnë se në cilat raste mund të konsiderohet përmbushja e ndonjëres nga rrethanat e listuara në nenin 18, paragrafin 3, dispozita bie ndesh me parimin e pavarësisë dhe mosndërhyrjes në vendimmarrje të KPM-së, që është një ndër parakushtet për institucionet e tilla të parashikuara në kapitullin dymbëdhjetë (XII) të Kushtetutës.
77. Si përfundim, Avokati i Popullit konsideron se rrethanat për të cilat mund të shkarkohet kryetari apo anëtar i KPM-së duhet të listohen shprehimisht, në mënyrë që siguria juridike dhe përcaktueshmëria e normës të mos cenohen për kryetarin dhe anëtarët e KPM-së, e po ashtu që të shmangen mundësitë e çfarëdo ndërhyrje politike apo tjetër, e cila mund të ndikojë negativisht në funksionimin e pavarur të KPM-së. Avokati Popullit e konsideron shumë të rëndësishme që Gjykata të vlerësojë nëse neni 18, paragrafi 2 dhe 3 është në pajtim me nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], neni 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës.

Komentet e dorëzuara nga AGK-ja

78. AGK, po ashtu, në cilësi të palës së interesuar, ka dorëzuar komente në lidhje me Ligjin e kontestuar, duke konsideruar se i njëjti është kundërkushtetues, si për nga procedura e ndjekur për miratimin e tij, ashtu edhe për nga përmbajtja e tij. Më saktësisht, AGK thekson se nenet 1, 3.1.1.3, 4.2.21, 14.1, 14.6, 15, 17.1, 17.2, 18.2.1 dhe 18.3.5 të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me nenet 7, 32, 40, 42, 99 dhe 141 të Kushtetutës.
79. AGK, në hyrje të komenteve, thekson se Ligji i kontestuar është një ligj jetik për lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në Republikën e Kosovës. Mangësitë dhe lëshimet serioze procedurale gjatë hartimit të këtij ligji dhe përmbajtja tejet shqetësuese e disa neneve specifike ka ngjallë reagime dhe diskutime të shumta në publik dhe ka zgjuar interesin e organizatave të ndryshme vendore e ndërkombëtare, përfshirë atë të AGK-së. Kjo e fundit thekson se në mesin e atyre që kanë reaguar kundër Ligjit të kontestuar dhe e kanë konsideruar të njëjtin se është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe

evropiane për lirinë e medias janë: Këshilli i Evropës; Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut; ambasadorë të ndryshëm të vendeve evropiane; organizata të ndryshme të shoqërisë civile në Kosovë; dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare si *Article 19 Europe, ECPMF, OSCE*, etj. AGK, në vijim, i referohet gjetjeve të Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, i cili duket të ketë theksuar se miratimi i Ligjit të kontestuar nuk përfshin disa rekomandime kyçe të bëra nga Këshilli i Evropës në opinionet ligjore të kësaj organizate dhe nëse miratohet, si i tillë, Ligji i kontestuar rrezikon të cenojë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias. Në këtë drejtim, AGK konsideron që Gjykata duhet ta shohë këtë ligj në kuadër të zhvillimeve shqetësuese të lirisë së medias në Kosovë dhe të përdorë juridiksionin e saj kushtetues për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të lirisë së medias në vend. AGK, bën të ditur se nuk e konteston në asnjë mënyrë ingjencën kushtetuese të Kuvendit për rregullim të çështjeve specifike që ndërlidhen me KPM-në, nëpërmjet një ligji të veçantë. Sipas saj, është vetë Kushtetuta ajo që parasheh se aspekte të caktuara për KPM-në do të përcaktohen me ligj. Megjithatë, AGK rikujton parimin e përgjithshëm kushtetues, duke iu referuar rasteve KO72/20 dhe KO79/23, ku theksohet se Kuvendi është i obliguar *“të respektojë procedurat e ligjbërjes dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e proklamuar aty”*.

80. Mbi këtë bazë, AGK i propozon Gjykatës që të vlerësojë: (i) nëse janë respektuar normat kushtetuese për ligjvënien në aspekt procedural të hartimit të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) nëse janë respektuar normat kushtetuese në aspekt përmbajtësor përmes ndryshimeve ligjore që shpërfaqen në Ligjin e kontestuar, duke u shprehur në fund se Ligji i kontestuar duke pasqyruar edhe procedurën e ndjekur, të shpallët në tërësi si kundërkushtetues dhe t'i hapë rrugë një procesi të ri për ndryshimin e Ligjit aktual në fuqi, në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, respektivisht ato Këshillit të Evropës.

I. Përkitazi me procedurën e ndjekur

81. AGK-së, në lidhje me procedurën e ndjekur, thekson se faza e përgatitjes së Projektligjit për KPM-në është përcjellë me mungesë të transparencës, të konsultimeve të mirëfillta publike dhe parregullsi të vazhdueshme ligjore. Në këtë drejtim, AGK i referohet nenit 99 [Procedurat] të Kushtetutës, që përcakton: *“Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri rregullohen me ligj dhe me rregullore”*. AGK rikujton se më 7 shtator të vitit 2011 Qeveria ka nxjerrë Rregulloren Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila në nenin 32, rregullon çështjen e konsultimeve publike si në vijim: *“1. Gjatë përgatitjes së propozimeve për të cilat kërkohet koncept dokumenti, përveç konsultimit të ministrave dhe organeve të tjera të administratës publike sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, organi propozues duhet të publikojë përmbajtjen e propozimit të saj për komente nga publiku dhe në mënyrë specifike do të kërkojë komente nga organizatat joqeveritare të cilat ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga propozimi. 2. Gjatë këtij konsultimi, organi propozues do të ofrojë informata të mjaftueshme në një formë të kuptueshme nga publiku për t'i mundësuar publikut që të kuptojë natyrën dhe pasojat e propozimit. Organi propozues gjithashtu do të shpallë publikisht fillimin e procesit të konsultimit dhe do të lejojë kohë të mjaftueshme për publikun dhe organizatat joqeveritare që të shqyrtojnë rekomandimet dhe të japin përgjigjet e tyre të mirëfillta. 3. Rezultatet e procesit të konsultimit do të raportohen në mbledhjen e Qeverisë ose në mbledhjen e Komisionit Ministror dhe do jenë pjesë përbërëse e koncept dokumentit ose memorandumit shpjegues sipas nenit 29 dhe 30. 4. Proces i konsultimit do të zhvillohet në pajtim me një udhëzues që lëshohet nga Sekretari sipas propozimit nga Zyra Ligjore. 5. Përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Kryeministri, Qeveria ose*

një Komision Ministror mund të kërkojë nga një Ministër që të zhvillojë konsultimin publik që çfarëdo çështje tjetër”.

82. Në këtë linjë, AGK thekson se Qeveria ka hapur konsultime publike lidhur me Ligjin e kontestuar, më 15 nëntor 2021 dhe afati i përmbylljes së konsultimeve për këtë ligj ishte paraparë të jetë 3 dhjetori 2021. Megjithatë, në faqen e dokumentacionit përcjellës përveç dokumentit të Projektligjit për KPM-në, që i ka paraprirë Ligjit të kontestuar dhe një dokumenti të emëruar si “*Dokumentacioni shtesë*”, i cili përmban formularët për palët e interesuara që përdoren për parashtrimin e komenteve të tyre, nuk ka asnjë informatë tjetër lidhur me kontributet e dorëzuara. Kjo mungesë e kontributeve nga palët e interesuara lidhur me Ligjin e kontestuar, sipas AGK-së, ngre dyshime për parregullsi procedurale në këtë proces. Ky dyshim, sipas AGK-së, përforcohet më tej me Raportin Vjetor për vitin 2021, të nxjerrë në muajin maj 2022, nga Zyra për Qeverisje të Mirë që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ku në faqen 28 të Raportit, vlerësimi për procesin e konsultimeve për Ligjin e kontestuar është negativ. Për më tepër, AGK thekson se dokumenti i Projektligjit për KPM-në, i hedhur për konsultim publik ndryshon thelbësisht nga versioni të cilin Qeveria e ka dërguar më vonë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Për shembull, sipas së njëjtës, versioni i vitit 2021 nuk i përmban dispozitat e kontestuara nga parashtruesit e kërkesave KO152/24 dhe KO158/24, siç janë ato lidhur me kompetencat e KPM-së, për mënyrën e zgjedhjes së kryetarit të KPM-së. Ky fakt tregon që për dispozitat më problematike të Ligjit të kontestuar nuk ka pasur konsultime të mirëfillta publike e as shpjegime të duhura në dokumentet përgatitore.
83. Një aspekt tjetër që ngre dyshime lidhur me rregullsinë e procesit, sipas AGK-së, është ai lidhur me obligimin që rrjedh nga neni 7 i Rregullores së punës të Qeverisë, i cili thekson: *“1. Para dorëzimit për shqyrtim në Qeveri, nga organi propozues ose nga një trup qeveritar, të koncept dokumenteve, memorandumeve shpjeguese, apo projekt aktet ligjore dhe nënligjore, planeve strategjike të ministrive ose strategji sektoriale, Organi i cili ka përgatitur materialin (“organi propozues”) është përgjegjës për të siguruar që të gjitha organet e larta të administratës shtetërore, organet qendrore të administratës shtetërore, organet e pavarura të administratës shtetërore dhe organet tjera relevante, me të cilat Qeveria është e obliguar të konsultohet në pajtim me Kushtetutën, apo puna e të cilave mund të ndikohet nga propozimi përkatës (projektligji, akti nënligjor apo politika), të kenë mundësi të të komentojnë lidhur me propozimin. Në veçanti, organi propozues duhet të konsultohet me: 1.1 Ministrinë përkatëse për Financa, me qëllim të shqyrtimit të plotë të ndikimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta të propozimit në shpenzimet publike ose në ekonomi; 1.2 Ministrinë përkatëse për Integrime Evropiane, për të siguruar që propozimi të jetë në përputhje me prioritetet e integritetit në Bashkimin Evropian (BE) dhe që të jetë në përputhje me kërkesat e BE-së dhe *acquis communautaire*. (...)”*. Bazuar në dyshimet e ngritura për procesin, AGK shprehet se Gjykata do të duhej të kërkonte nga Qeveria dhe Kuvendi dorëzimin e dokumentacionit të plotë përgatitor lidhur me Ligjin e kontestuar për të vërtetuar se a ka pasur shkelje të nenit 99 të Kushtetutës në rastin konkret.

II. Përkitazi me përmbajtjen e dispozitave të Ligjit të kontestuar

i. Pretendimin për shkelje të nenit 141 [Komisioni i Pavarur i Medie] të Kushtetutës nëpërmjet neneve 14.1, 15, 17.1, 17.2, 18.2.1 dhe 18.3.5 të Ligjit të kontestuar (Çështjet që ndërlidhen me numrin e anëtarëve të KPM-së, mandatin, shkarkimin e anëtarëve dhe zgjedhjen e Kryetarit të KPM-së)

84. AGK, në vijim të komenteve të saj, thekson se një ndër çështjet kryesore kushtetuese që ngërthen ky rast ka të bëjë me faktin nëse është cenuar pavarësia e KPM-së, përmes ndryshimeve ligjore të parapara me Ligjin e kontestuar, duke shtuar se janë disa nene kyçe të Ligjit të kontestuar të cilët kanë ndikim thelbësor në pavarësinë e KPM-së dhe ulin në mënyrë drastike standardin e krijuar deri më tani lidhur me pavarësinë organizative dhe funksionale të KPM-së. Më konkretisht, përmbajtja e neneve 14.1, 15, 17.1, 17.2, 18.2.1, 18.3.5 të Ligjit të kontestuar, që ndërliqhen me numrin e anëtarëve të KPM-së, mandatin, shkarkimin dhe zgjedhjen e Kryetarit të KPM-së, sipas AGK-së, cenojnë pavarësinë e KPM-së, deri në masën që shkelet neni 141 i Kushtetutës. AGK në këtë kontekst: i referohet (i) praktikës së Gjykatës Kushtetuese, lidhur me pavarësinë funksionale dhe organizative të institucioneve të pavarura, të parapara në Kapitullin XII të Kushtetutës; (ii) rregulimeve që bën Ligji i vitit 2012, dhe ndryshimeve që janë bërë me Ligjin e kontestuar; (iii) raporteve dhe opinioneve ligjore të ofruara nga Këshilli i Evropës. Në raport me pavarësinë e KPM-së, AGK i referohet rastit specifikisht KO79/23, ku Gjykata, ndër të tjera, kishte theksuar: *“Kushtetuta i ka njohur një status dhe rol të veçantë e të rëndësishëm në mbarëvajtjen e detyrave publike shtetërore edhe Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, të cilat janë veçuar, si të tilla, jo pa arsye dhe të cilat përfshijnë (...) Komisionin e Pavarur të Mediave [...]”*. Tutje, AGK i referohet edhe Opinionit Ligjor përkitazi me Ligjin e kontestuar të Divizionit për Bashkëpunim sa i përket Lirisë e Shprehjes të Këshillit të Evropës, i 24 majit 2024, i draftuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtejshëm: Opinionit i Këshillit të Evropës), duke theksuar se ky i fundit në faqet 33-36 ka theksuar se *“Pavarësia dhe autonomia”* e Autoriteteve Rregullative Kombëtare, siç është në këtë rast KPM-ja, nuk janë terme që thjesht konfirmohen nëpërmjet një dispozite ligjore, por që një pavarësi/autonomi duhet të jetë e dukshme në aspekt të funksionimit të këtyre autoriteteve rregullative, resurseve financiare të tyre, metodave të emërimit, shkarkimit dhe menaxhimit të këtyre trupave dhe në aspekt praktik të implementimit të kornizës ligjore. Në zbatim të parimeve të lartcekura, AGK konsideron se Ligji i kontestuar: (i) krijon një *“ndërhyrje”* kundërkushtetuese në pavarësinë e KPM-së; krijon *“varësi”* dhe *“vartësi”* kundërkushtetuese të KPM-së, ndaj Kuvendit; se përgjatë procesit të miratimit, ligjvënësi nuk ka marrë parasysh garancinë kushtetuese të KPM-së që të trajtohet si organ i pavarur; se Ligji i kontestuar, përveç që nuk zbaton në mënyrë korrekte nenet relevante të Kushtetutës; injoron në tërësi praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe dështon ta *“mishërojë”* atë në këtë iniciativë ligjore.

ii. Përkitazi me zgjedhjen e Kryetarit dhe numrin e anëtarëve të KPM-së

85. AGK, në këtë kuptim, thekson se me Ligjin në fuqi për KPM-në, të vitit 2012, parashihej që Kryetari i KPM-së zgjidhet nga vetë anëtarët e tij, ndërsa me nenin 15 të Ligjit të kontestuar tashmë parashihet që Kryetari i KPM-së do të zgjidhet nga Kuvendi, me shumicë të thjeshtë votash. Përderisa, anëtarët e KPM-së, thekson AGK, deri më tani e kishin të drejtën e përzgjedhjes së Kryetarit të tyre, Ligji i kontestuar ia delegon këtë të drejtë Kuvendit, duke ndërhyrë kështu në pavarësinë organizative të KPM-së, në kundërshtim me nenin 141 të Kushtetutës. Sipas AGK-së, imponimi i një Kryetari do të mund të shihej si një tendencë e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ për të kontrolluar një organ të pavarur, siç është KPM-ja, duke ua marrë anëtarëve të saj të drejtën për të menaxhuar në mënyrë të pavarur me aspektet organizative dhe funksionale të këtij Institucioni. Në lidhje me këtë, AGK i referohet Opinionit nr. 798/2015, të 22 qershorit 2015, të Komisionit të Venecias, që ishte thirrur të analizojë, shqyrtojë dhe të ofrojë opinion ligjor lidhur me dy ligje nga fusha e mediave, të miratuara nga parlamenti hungarez. Ky opinion, thekson AGK, ndër të tjera, përcakton: *“Në rrethana normale, qëllimi i vendosjes së një kriteri për një shumicë të*

cilësuar është sigurimi i një mbështetje ndërpartiake për masa të rëndësishme ose personalitete të rëndësishme. Megjithatë, aty ku kërkesa për një super-shumicë futet me iniciativën e një grupacioni politik që ka atë supershumicë, ky rregull, në vend që të sigurojë pluralizëm dhe shkëputjen e organit rregullator nga ndikimi politik, në fakt “çimenton” ndikimin e këtij grupacioni të veçantë brenda organit rregullator dhe e mbron këtë ndikim kundër erërave politike në ndryshim”. Në rrethanat e rastit konkret, AGK, i referohet Opinionit Ligjor të Këshillit të Evropës, duket të ketë theksuar: “se praktika e re e emërimit të Kryetarit të KPM-së nga Kuvendi, mund të rrisë ndikimin politik në KPM-në, veçanërisht duke pasur parasysh që të gjitha emërimet për KPM-në bëhen nga Kuvendi ekskluzivisht”. Sipas AGK-së, kjo praktikë nuk është në linjë me standardet evropiane dhe standardet e rajonit, ngase procesi i emërimit për Kryetar të KPM-së duhet të jetë i pavarur. Më tutje, AGK thekson se Ligji në fuqi për KPM-në i vitit 2012, parashihte që KPM përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, neni 14.1 i Ligjit të kontestuar parasheh përbërje prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve. Gjithnjë duke iu referuar Opinionit Ligjor të Këshillit të Evropës, lidhur me shtimin e numrit të anëtarëve të KPM-së nga 7 në 11, theksohet se përcaktimi i një mandati katërvjeçar nuk është i pazakontë, mirëpo mandatet më të gjata (me mundësi vazhdimi pas skadimit të mandatit) mund të paraqesin probleme lidhur me pavarësinë e KPM-së, posaçërisht duke marrë për bazë faktin se të gjitha emërimet i bën Kuvendi dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në proces të nominimit/emërimit është tërësisht e përjashtuar. Rrjedhimisht, AGK i propozon Gjykatës që nenet 14.1 dhe 15 të Ligjit të kontestuar t’i shpallë si të papajtueshëm me nenin 141 të Kushtetutës.

iii. Përkitazi me mandatin e anëtarëve të KPM-së

86. AGK, në lidhje me këtë, thekson se Ligji në fuqi për KPM-në, i vitit 2012, nëpërmjet nenit 13, rregullonte çështjen e mandatit ashtu që ngërthente në vete një përpjekje serioze: (i) për të pamundësuar emërimin e të gjithë anëtarëve të KPM-së nga një legjislaturë e vetme; dhe (ii) për të pamundësuar zgjatjen e mandatit të anëtarëve të KPM-së, përtej mandatit të rregullt, në afat të pa limituar. Mundësia reale/praktike që mandati i një anëtari të vazhdohet për kohë të pacaktuar, përtej mandatit të rregullt prej 8 viteve është padyshim një rregullim ligjor që bie ndesh me parimet kushtetuese të kufizimit të një mandati për poste publike. AGK vë theksin në faktin që Kuvendi nuk ka paraparë asnjë kufizim se deri në sa ditë, muaj ose vite mund të qëndrojë një anëtar ose kryetari i KPM-së në detyrë pas skadimit të mandatit të rregullt. Kjo nënkupton, thekson AGK, që përderisa Kuvendi sipas legjislacionit në fuqi ishte i obliguar të fillojë dhe të përfundojë procesin e emërimit të anëtarëve të KPM-së në mënyrë rotative (në legjislatura të ndryshme) me Ligjin e kontestuar, Kuvendi mund të prolongojë pafundësisht mandatin e anëtarëve të KPM-së. Ky ndryshim ligjor, sipas AGK-së, është i rrezikshëm, duke marrë për bazë numrin e lartë të dështimeve që Kuvendi ka shënuar në përzgjedhjen e anëtarëve të KPM-së. Rrjedhimisht, AGK konsideron se ndryshimi thelbësor i rregullave për mandatin e anëtarëve të KPM-së dhe mos kufizimi i mandatit, paraqet një rregullim ligjor i cili mund të krijojë “varësi” dhe “vartësi” në mes të të emëruarit për post në KPM, ndaj deputetëve dhe partive politike që emërojnë personat në fjalë. Andaj, mbi këtë bazë, AGK propozon që nenet 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të kontestuar të shpallën të papajtueshëm me nenin 141 të Kushtetutës.

iv. Përkitazi me shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së

87. AGK rikujton se për çështjen e shkurtimit të mandatit dhe të shkarkimit të Kryetarit dhe të anëtarëve të KPM-së, Opinionit Ligjor i Këshillit të Evropës, ndër të tjera, thekson se: “(i) Mënyra e kërimit të përgjegjësisë (accountability)” nga autoritetet rregullative siç është

KPM-ja duhet të definohen qartë në ligj; (ii) Emërimet e anëtarëve në autoritetet rregullative siç është KPM-ja duhet të bëhen për mandat specifik dhe “mandati i tillë mund të shkurtohet vetëm bazuar për arsye dhe rrethana të qarta ligjore”; (iii) Ligji i kontestuar krijon një “mekanizëm arbitrar sipas të cilit Kuvendi mund të largojë dhe të zëvendësojë të gjithë anëtarët e KPM-së bazuar në kritere të gjëra dhe të padefinuara – gjë e cila nuk është në linjë me standardet evropiane”. Sipas AGK-së, Ligji në fuqi për KPM-në i vitit 2012 rregullonte procedurën e shkarkimit, ashtu që i jepte shumë më tepër pavarësi dhe fuqi anëtarëve të KPM-së për të menaxhuar lirshëm me institucionin e KPM-së në aspekt organizativ dhe të udhëheqësisë. AGK, thekson se neni 14 i Ligjit në fuqi për KPM-në, parashihte që shkarkimi i një anëtari të KPM-së mund të bëhet nga Kuvendi vetëm nëse “propozimi për shkarkim vinte nga KPM” ose nga “ndonjë iniciativë tjetër nga jashtë”. Për dallim nga sistemi i deritashëm i shkarkimit, Ligji i kontestuar nuk ia njeh fare të drejtën anëtarësisë së KPM-së që të propozojë shkarkimin e anëtarit të KPM-së ose të Kryetarit, por vetëm Kuvendit, përkatësisht komisionit parlamentar përgjegjës për media. Në rrafshin praktik, sipas AGK-së kjo nënkupton që edhe nëse 10 nga 11 anëtarët e ardhshëm të KPM-së konsiderojnë se një anëtarë i këtij organi, ose Kryetari i tij nuk përmbushin detyrat, ose për arsye të tjera duhet të shkarkohen, të njëjtit nuk do të propozojnë shkarkimin, ngase këtë të drejtë, Kuvendi ia ka bartur vetvetes.

88. Tutje në komentet e AGK theksohet se Ligji i kontestuar për dallim nga Ligji në fuqi për KPM-në, vendos një kriter tejet problematik për pavarësinë e KPM-së me vetë faktin që Kuvendi mund të shkarkojë Kryetarin ose anëtarët e KPM-së, nëse “*humbet besimi nga organi mbikëqyrës*”. Sipas AGK-së, kjo dispozitë e Ligjit të kontestuar krijon një “*ndërrhyrje*” kundërkushtetuese në pavarësinë e KPM-së që rezulton me një “*varësi*” dhe “*vartësi*” të KPM-së ndaj Kuvendit e që rrjedhimisht shkel nenin 141 të Kushtetutës. Kjo për faktin se, sipas saj, pushteti legjislativ ia ka mundësuar vetvetes që të shkarkojë me një shumicë të thjeshtë të gjithë anëtarët e KPM-së dhe Kryetarin e saj, kurdo që konsideron se është “*humbur besimi*”. Për më tepër, kriteri i humbjes së besimit, sipas AGK-së, paraqet ndërhyrje direkte në vendimmarrjen e KPM-së dhe është kriter subjektiv, sepse nëpërmjet Ligjit të kontestuar, praktika e mëhershme, ndryshohet tërësisht ashtu që e drejta e rishikimit të qëndrimeve të anëtarëve të KPM-së i kalon deputetëve të partisë në pushtet të cilët do të gëzojnë të drejtën të ofrojnë vlerësime politike të qëndrimeve të anëtarëve të KPM-së. Po ashtu, sipas AGK-së, ka mangësi dhe paqartësi për sa i përket asaj se çfarë nënkupton “*humbje e besimit*”, cilat janë kriteret për një matje të tillë, si mbrohen anëtarët e KPM-së dhe si garantohet pavarësia e KPM-së nga arbitrariteti i mundshëm që mund të pasojë në zbatim të këtij neni.
89. AGK, duke analizuar nenin 18 të Ligjit të kontestuar lidhur me procedurat e shkarkimit të anëtarëve të KPM-së, dhe duke bërë krahasimin e procedurës së shkarkimit që është aktualisht në fuqi, si dhe analizimi i standardeve evropiane të vendosura në Opinionin Ligjor të Këshillit të Evropës lidhur me këtë çështje është e mendimit se është shkelur pavarësia e KPM-së, e garantuar nëpërmjet nenit 141 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, AGK propozon që nenet 18.2.1 dhe 18.3.5 të Ligjit të kontestuar të shpallen të papajtueshme me nenin 141 të Kushtetutës.

v. Përkitazi me nenin 1 dhe nenin 4 Ligjit të kontestuar

90. Sipas AGK-së, parimi i sundimit të ligjit përbën një ndër shtyllat kryesore të funksionimit të rendit kushtetues, në funksion të të cilit janë edhe parimet e qartësisë dhe parashikueshmërisë së normave ligjore. Në këtë drejtim, AGK i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës, në trajtimin e parimit të parashikueshmërisë së normave juridike,

ku Gjykata, ndër të tjera, kishte theksuar: “*Parashikueshmëria, para së gjithash, kërkon që norma ligjore të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme, ashtu që t’u mundësohet individëve dhe subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljet e tyre në përputhje me të. Individët dhe subjektet tjera juridike duhet të dinë saktësisht se si dhe sa ndikohen nga një normë e caktuar ligjore dhe se si një normë e re ligjore e ndryshon statusin ose gjendjen e tyre të mëparshme të paraparë me një normë tjetër ligjore. Autoritetet publike, gjatë hartimit të ligjeve duhet të marrin parasysh edhe këto parime bazë të sundimit të ligjit – si pjesë të rëndësishme të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës*”. Tutje, AGK përmend dokumentin nr. 34, të 12 shtatorit 2011, të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku lidhur më lirinë e mendimit dhe të shprehjes, ndër të tjera, thuhet: “(...) një normë, për t’u karakterizuar si “ligj”, duhet të jetë formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar një individ të rregullojë sjelljen e tij ose të saj në përputhje me rrethanat, dhe ajo normë duhet të jetë e qasshme për publikun. Një ligj nuk mund të përcjellë diskrecion të papenguar për kufizimin e lirisë së shprehjes për ata që janë të ngarkuar me zbatimin e atij ligji”, duke rikujtuar se një linjë me këtë interpretim ishte edhe GjEDNj, kur kishte vendosur për rastet *Steel & Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Nasrullojev kundër Rosisë*, duke theksuar se nocioni i “*ligjshmërisë*” kërkon që testi i sigurisë juridike dhe cilësisë së ligjit duhet të përmbushet, i cili kërkon që të gjitha ligjet të jenë publike dhe mjaftueshëm precize që të jenë të arsyeshme në të gjitha rrethanat, dhe të parashohin pasojat që mund të pasojnë si rezultat i një veprimi të caktuar, në mënyrë që të shmangen të gjitha rreziqet e arbitraritetit. Në rastin e Ligjit të kontestuar, AGK konsideron se në kuptim të qartësisë dhe parashikueshmërisë, neni 1 (Qëllimi) dhe neni 4 (Kompetencat) shfaqen jashtëzakonisht problematike, duke shtuar se në nenin 1 të Ligjit të kontestuar, thuhet se qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë kompetencat e KPM-së “*me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shërbimeve audiovizuele, që u shërben të gjithë qytetarëve*”. Megjithatë, sipas AGK-së, kur analizohet në hollësi përmbajtja e tërësishme e Ligjit të kontestuar, është e qartë se ligjvënësi në nenin 1 do të duhej të theksonte qartë se qëllimi i këtij ligji është të rregullojë sektorin e mediave audiovizuele, duke elaboruar qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e medieve audiovizuele dhe të platformave të shpërndarjes së videove.

91. Më tej, AGK konsideron se neni 4 që rregullon kompetencat e KPM-së është edhe më problematik, sa i përket qartësisë, precizitetit dhe parashikueshmërisë së çështjeve të cilat i rregullon me këtë dispozitë të Ligjit të kontestuar. Sipas AGK-së ligjvënësi ka dështuar të ofrojë qartësi saktësi dhe parashikueshmëri të mjaftueshme të normës në fjalë, dhe se ky fakt e bën këtë normë të ligjit të jetë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, të proklamuar si një nga vlerat themelore të rendit kushtetues në Republikën e Kosovës. Tutje, AGK thekson se në nënparagrafin 2.1 të Ligjit të kontestuar, thuhet se KPM-ja, “*rregullon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime mediale audio, audiovizuele përfshirë ato të ofruara online, shërbimet e platformës për shkëmbimin e videove, operatorët e shpërndarjes si dhe operatorët e tjerë të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë ofrues të shërbimeve mediale audiovizuele*”. Kjo përfshirje nën ombrellën e KPM-së, sipas AGK-së, e shton edhe më shumë nivelin e paqartësisë dhe sjellë edhe më shumë pasiguri juridike në rregullimin e tregut medial në Kosovë. Më tej, AGK shton se në nënparagrafin 2.2 të këtij neni thuhet se KPM-ja ka lëshuar leje për ofruesit e shërbimeve audio, audiovizuele, platformat për shpërndarjen e videove, operatorët e shpërndarjes, operatorët e rrjetit dhe operatorët e multipleksit, gjersa në nënparagrafin pasues 2.3 thuhet se KPM-ja mban dhe përditëson regjistrin e shërbimeve mediale audiovizuele online sipas nënparagrafit 1.1.2. të nenit 3 të këtij ligji. Përderisa Ligji i kontestuar (thekson AGK) shtjellon në mënyrë të detajuar çështjen e licencimit, përkatësisht lejeve për transmetim (shih, nenet 25-39), përfshirë këtu

lejet dhe ripërtëritjen e tyre, aplikimet për leje, llojet e lejeve, lejet për shërbime analoge dhe dixhitale, etj, çështja e regjistrimit dhe regjistrimit të shërbimeve mediale audiovizuale online vazhdon të mbetet tërësisht e paqartë. Tutje, në komentet e AGK-së theksohet se Ligji i kontestuar nuk përmban asnjë dispozitë shtesë që do të sillte sado pak qartësi në këtë drejtim.

92. Bazuar në të lartcekurat, AGK shprehet e shqetësuar seriozisht lidhur me mungesën e theksuar të qartësisë në formulimin e kësaj dispozite të Ligjit të kontestuar, dhe se një mungesë e tillë e qartësisë, saktësisë dhe parashikueshmërisë, ofron pasiguri të theksueshme tek subjektet që i rregullon KPM-ja në njërën anë, dhe ofron hapësirë tejet të gjerë për arbitraritet nga KPM-ja, në raport me mediat audiovizuale në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, AGK propozon që nenet 1 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, nga shkaku se nuk ofrojnë qartësi, saktësi dhe parashikueshmëri të normës juridike, të shpallen të papajtueshme me nenin 7 të Kushtetutës, sepse në veçanti shkelin parimin e sigurisë juridike si një ndër vlerat themelore të rendit kushtetues në Republikën e Kosovës.

vi. Përkitazi me barazinë gjinore sa i përket përbërjes së KPM-së

93. AGK, në lidhje me këtë pretendim, thekson se përderisa paragrafi 2 i nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së) i Ligjit të kontestuar parasheh që *“Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore”*, në anën tjetër paragrafi 5 i nenit 10 (Përbërja e KPM-së) i Ligjit në fuqi për KPM-në, i vitit 2012, përcakton që: *“Përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë të KPM-së, ... duhet të jenë të gjinisë femërore”*. Tutje, AGK i referohet Ligjit për Barazinë Gjinore të vitit 2012, i cili parasheh: *“1. Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi. (...) 7. Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. 8. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”*. Në këtë kontekst, AGK mendon se Ligji i kontestuar ka përligjur një ulje drastike të standardit të deritashëm për barazi gjinore, duke eliminuar tërësisht përfaqësimin obligativ të të paktën të dy (2) grave në përbërje të KPM-së, përderisa Ligji në fuqi për KPM-në i vitit 2012 kishte vendosur një masë të veçantë sipas së cilës të paktën dy (2) nga shtatë (7) anëtarët e KPM-së do duhej të ishin gra, në anën tjetër Ligji i kontestuar e eliminon këtë obligim ligjor, duke përdorur një formulë universale që thirret në reflektim të përgjithshëm të parimit të barazisë gjinore, duke mos përmbajtur një obligim ligjor për përfaqësim minimal të grave në KPM. Rrjedhimisht, garancioni ligjor që obligonte Kuvendin dhe mundësonte pjesëmarrjen e grave në organin më të lartë të KPM-së është eliminuar. Në terma praktik, sipas AGK-së, ky ndryshim ligjor e shkel nenin 7 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Ligjit për Barazi Gjinore, meqë me Ligjin e kontestuar rrezikohet që KPM të mos ketë asnjë anëtare grua, ndërkohë që Ligji në fuqi për KPM-në, ligjërisht e pamundësonte një skenar të tillë ngaqë parashihte obligim ligjor që të paktën dy (2) nga shtatë (7) anëtarët e KPM-së të jenë gra.
94. Ligji i kontestuar, sipas AGK-së tani edhe ligjërisht e bën të mundur që nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë të KPM-së, të gjithë të jenë burra dhe asnjë grua, për dallim që Ligji në fuqi për

KPM-në, e obligonte Kuvendin që të paktën 28.5% të anëtarëve të KPM-së të ishin gra. Në këtë drejtim, AGK konsideron se, për arsye të panjohura dhe të pambështetura me analiza të mirëfillta paraprake, Ligji i kontestuar përfaqon një politikë publike që është në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Ligjit për Barazi Gjinore. Nga ana tjetër, AGK propozon që neni 15.2 i Ligjit të kontestuar të shpallet i papajtueshëm me nenin 7 të Kushtetutës.

vii. Përkitazi me nenin 3.1.1.2 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me çështjet e përkufizimit të shërbimeve mediale audiovizuale online

95. Përkitazi me këtë, AGK thekson se, dy dispozitat kushtetuese më të rëndësishme në raport me veprimtarinë dhe përgjegjësitë e AGK-së, janë ato që kanë të bëjnë me *“lirinë e shprehjes”* dhe *“lirinë e medias”*, duke shtuar se inkuadrimi i disa përkufizimeve tejet problematike në nenin 3 (Përkufizimet) të Ligjit të kontestuar, bie ndesh me të drejtat kushtetuese të mishëruara në nenin 40.1 dhe neni 42.1 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, AGK e sheh inkuadrimin e një përkufizimi për *“shërbimet mediale audiovizuale online”*, si një hap tejet të rrezikshëm që do të ndikojë negativisht në përkeqësimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, dhe në pluralizmin e tregut medial në Republikën e Kosovës. AGK-ja rikujton se çështja e rregullimit të mediave *online* vazhdon të jetë temë debati në botën demokratike dhe akoma nuk ka një konsensus të plotë në shtetet e Evropës dhe të mbarë botës demokratike lidhur me atë se si do të duhej të përkufizohen dhe rregullohen mediat që veprimtarinë e tyre e bazojnë ekskluzivisht përmes faqeve të tyre në internet. Në nivel të Bashkimit Evropian, dokumenti kryesor në fuqi në fushën e shërbimeve të mediave audiovizuale është Direktiva AVMS). Ky instrument, sipas AGK-së, ka paraqitur një ndryshim në mënyrën e rregullimit të mediave online, duke kërkuar që ato të cilat publikojnë video t'i nënshtrohen një rregullimi shtesë, duke i obliguar të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së të miratojnë ose ndryshojnë kuadrin e tyre ligjor në fushën e rregullimit të mediave audiovizuale, në përputhje të plotë me parimet e përfshira në direktivën, e cila u lë hapësirë shteteve anëtare që rregullimin e mediave online të vazhdojnë t'ia lënë si kompetencë vetë industrisë së medias, nëpërmjet vetërregullimit dhe ky vetërregullim promovohet fuqishëm nga Këshilli i Evropës.
96. AGK tutje konsideron se Ligji i kontestuar e ndryshon në mënyrë thelbësore rregullimin e mediave në Kosovë, në atë mënyrë që mediat online që përmbajnë video, të cilat deri më tani janë rregulluar nga KMSHK, t'i kalojnë si kompetencë KPM-së. Kjo është arritur nga ligjvënësi duke zgjeruar definicionin e shërbimeve mediale audiovizuale përmes përfshirjes së një definicioni të ri për media online, i cili definicion nuk ekziston në të drejtën evropiane. Duke iu referuar formulimeve të nënparagrafit 1.1 të nenit 3 të Ligjit të kontestuar për KPM-në, sipas komenteve, AGK shprehet e brengosur për mungesën e qartësisë së përkufizimit të këtyre dispozitave, pasi një formulim i këtillë, kaq i paqartë krijon pasiguri te mediat që publikojnë video online dhe i cili mund të interpretohet në formë të ndryshme nga KPM-ja, e cila nuk ka asnjë përvojë me rregullimin e mediave online. Rrjedhimisht, mundësia ligjore që KPM të interpretojë mediat online sipas dëshirës, bazuar në një definicion që nuk ekziston në direktivën AVMS-së mund të shkaktojë pasiguri. Në këtë kontekst, AGK i referohet Opinionit Ligjor të Këshillit të Evropës, ku thuhet se përfshirja e përkufizimit për *“shërbime mediale audiovizuale online”* e ndryshon kuptimin e shërbimeve mediale audiovizuale, në të drejtën e BE-së dhe paraqet një inkuadrin të një lloji të ri të medias, duke shtuar se një përkufizim i tillë është i panevojshëm, pasi krijon paqartësi dhe konfuzion. AGK thekson me tej se tregu medial në Kosovë, kohëve të fundit është i bazuar në ofrimin e shërbimeve përmes internetit dhe se zhvillimet e teknologjisë i kanë mundësuar mbijetesën edhe mediave të cilat në të kaluarën

kanë funksionuar si gazeta të shtypura. AGK e konsideron jetike ruajtjen e pluralizmit medial në Kosovë, që të eliminohen paqartësitë si më sipër. AGK në vijim i referohet Opinioni 980/202 të 19 qershorit 2020 të Komisionit të Venecias, lidhur me amendamentet e Ligjit për Shërbimet Mediale Audiovizuale, të Shqipërisë, ku ky Opinion, ndër të tjera, thekson: *“(...) Për të adresuar problemin e sjelljes keqdashëse ose të papërgjegjshme të medias në internet, Komisioni i Venecias inkurajon autoritetet shqiptare të mbështesin themelimin e një organi vetërregullues efektiv dhe të pavarur që përfshin të gjithë akterët përkatës të komunitetit medial dhe i aftë për të siguruar një sistem efektiv dhe të respektuar të llogaridhënies për mediat në fushën e medias online nëpërmjet vetërregullimit. [...] Në kontekstin e Kosovës, sipas AGK-së, zbatimi i Opinioni të lartcekur të Komisionit të Venecias do të nënkuptonte që ligjvënësi është dashur të parashihet këtë në Ligjin e kontestuar ose në ligje të tjera të cilat në fakt do të fuqizonin trupin vetërregullues të KMSHK-së. Përveç, Komisionit të Venecias, edhe vetë direktiva AVMS-së e BE-së (thekson AGK), kërkon që shtetet anëtare të nxisin vetërregullimin nëpërmjet kodeve të sjelljeve. AGK-ja është e mendimit se futja e këtij përkufizimi në Ligjin e kontestuar, përveç që do ta frenonte lirinë e shprehjes dhe do ta dëmtonte në nivel të pariparueshëm pluralizmin medial në vend, në të njëjtën kohë do të paraqiste edhe zgjerim të autorizimeve të KPM-së, nëpërmjet interpretimit dhe transpozimit të gabuar të direktivës së AVMS-së.*

97. Si përmbledhje e mësipërme, AGK thekson: *“liria e mediave cenohet drejtpërsëdrejti edhe me nenet 14.1, 15, 17.1, 17.2 dhe 18 të trajtuara më lart. Paragrafi i parë i nenit 42 parashihet që garantohet liria dhe pluralizmi i mediave. Pluralizimi i mediave varet nga vendimet e KPM-së për licencimin dhe revokimin e licencave për subjektet mediale. Nëse KPM ka përbërje profesionale e cila ka mundësi që të veprojë tërësisht e pavarur nga pushteti, atëherë licencimi dhe revokimi i licencave bëhet bazuar në kritere të qarta ligjore. Rrjedhimisht, kështu krijohet një skenë mediale që përmban llojllojshmëri të subjekteve që ofrojnë përmbajtje të larmishme dhe mundësohet praktikisht pluralizmi medial. Mirëpo, nëse përbërja e KPM-së funksionon në raport varësie nga pushteti përmes Kuvendit, vendimet për licencimin dhe revokimin potencial të licencave të subjekteve mediale nuk do të bëhen bazuar në kritere ligjore por në preferenca politike. Për këto arsye, nenet 14.1, 15, 17.1, 17.2 dhe 18 janë në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës që garanton pluralizim medial. 92. Rrjedhimisht, AGK me respekt i propozon Gjykatës që nënparagrafin 1.1.2. të nenit 3 të Ligjit të kontestuar ta shpallë si të papajtueshëm me nenin 40.1 dhe nenin 42.1 të Kushtetutës”.*

viii. Përkitazi me çështjet që ndërlidhen me zëvendësimin e Bordit të Ankesave me Këshillin e Ankesave

98. Në lidhje me këtë pretendim, AGK i referohet parimit të dyshkallshmërisë dhe thekson se ky parim është pjesë integrale e të drejtës për mjete efektive juridike, që nënkupton se secili person ndaj të cilit nxirret një vendim, përfshirë edhe masat administrative, gëzon të drejtën kushtetuese të ushtrojë ankesë kundër atij vendimi ose mase. Në këtë aspekt, sipas AGK-së, Ligji në fuqi për KPM-në përmban një kapitull të tërë [Kapitulli VI – Bordi për Ankesa], më 9 nene që rregullojnë në mënyrë të detajuar çështjet lidhur me ankesat kundër vendimeve të KPM-së, siç janë neni 36 [Përgjegjësitë], neni 37 [Përbërja e Bordit për Ankesa], neni 38 [Zgjedhja e anëtarëve të Bordit për Ankesa], neni 39 [Papajtueshmëria për të qenë anëtar i Bordit për Ankesa], neni 40 [Mandati i Anëtarëve të Bordit për Ankesa], neni 41 [Shkarkimi nga Bordi për Ankesa dhe sjellja e anëtarëve], neni 42 [Procedurat e Bordit për Ankesa], neni 43 [Dorëzimi i Ankesës] dhe neni 44 [Vendimet e Bordit të Ankesave]. Në anën tjetër, Ligji i kontestuar nuk e përmend fare bordin e ankesave, duke e

eliminuar në tërësi këtë mekanizëm të brendshëm korrigjues, që ia mundësonte KPM-së rishikimin e vendimeve të veta, në përputhje me standardet kushtetuese. Për më tepër, Ligji i kontestuar në paragrafin 2 të nenit 4, që i rregullon kompetencat e KPM-së, ndër të tjera thotë: “2. KPM, përveç kompetencave të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, ushtron edhe këto kompetenca: (...) 2.21. themelon Këshillin e Ankesave që trajton ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore si dhe harton e miraton rregulloren e funksionimit të këtij këshilli”. Në këtë kontekst, AGK thekson se është degraduar mbrojtja ligjore për subjektet që bien nën kompetencën rregullative të KPM-së, sepse sipas saj qëllimi i parimit të dyshkallshmërisë, sipas ligjit aktual në fuqi, është që të mundësojë rishikimin administrativ të vendimeve të KPM-së, nga Bordi i Ankesave në mënyrë të pavarur nga KPM-ja. Me ndryshimet e bëra në Ligjin kontestues (thekson AGK), vendimet e KPM-së do t’i nënshtrohen rishikimit administrativ nga një trup që emërohet nga vetë KPM-ja dhe i cili për nga natyra ka funksion subordinues ndaj KPM-së, prandaj në këtë kontekst, Këshilli (Bordi) i Ankesave nuk mund të konsiderohet si mjet efektiv juridik për të kontrolluar ligjshmërinë e vendimeve të KPM-së.

99. AGK, duke i referuar gjithnjë Opinionit ligjor të Këshillit të Evropës, thekson se ndryshim e kornizës ligjore për ushtrimin e ankesave kundër vendimeve të KPM-së, KE-ja e ka vlerësuar si zhvillim negativ në këtë fushë. Më tej, AGK thekson se paragrafi 2.21 i nenit 4 të Ligjit të kontestuar, përveç se është tejet i paqartë dhe bie ndesh me parimin e parashikueshmërisë së normës juridike, përbën edhe shkelje flagrante të nenit 32 të Kushtetutës, i cili shprehimisht thekson se e drejta për mjete juridike garantohet edhe në raport me vendimet administrative, dhe se përdorimi i tyre, kundër këtyre vendimeve rregullohet me ligj. Ndërsa, dispozita përkatëse e Ligjit të kontestuar, përcakton që kjo çështje do të rregullohet në të ardhmen me akt nënligjor të nxjerrë nga KPM-ja. Rrjedhimisht, AGK propozon që neni 4.2 i Ligjit të kontestuar të shpallët i papajtueshëm me neni 32 të Kushtetutës.
100. Si përfundim, AGK thekson: “AGK, me respekt për vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës, konsideron se Ligji i kontestuar është kundërkushtetues si për nga procedura e ndjekur për miratimin e tij ashtu edhe për nga përmbajtja e tij. AGK konsideron se nenet 1, 3.1.1.3, 4.2.21, 14.1, 14.6, 15, 17.1, 17.2, 18.2.1 dhe 18.3.5 të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me nenet 7, 32, 40, 42, 99 dhe 141 të Kushtetutës. Duke qenë se është e pamundur që Ligji i kontestuar të mbijetojë pas shfuqizimit të këtyre dispozitave dhe duke marrë parasysh shkeljet thelbësore procedurale, AGK i propozon Gjykatës që të njëjtin ta shpallë në tërësi si kundërkushtetues”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

1. “Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. *Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”*

Neni 7

[Vlerat]

1. *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*

2. *Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”*

Neni 10

[Ekonomia]

“Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.”

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*

3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”*

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 40

[Liria e Shprehjes]

1. *“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*

2. *Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”*

Neni 42
[Liria e Medieeve]

1. *“Garantohet liria dhe pluralizmi i medieeve.*

2. *Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieeve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

3. *Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.”*

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

[...]

(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;”

[...]

Neni 99
[Procedurat]

“Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri rregullohen me ligj dhe me rregullore.”

Neni 119
[Parimet e Përgjithshme]

1. *“Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.*

2. *Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.*
3. *Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.*
4. *Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.*
5. *Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.*
6. *Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.*
7. *Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.*
8. *Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.*
9. *Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.*
10. *Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.”*

Neni 141
[Komisioni i Pavarur i Medieve]

1. *“Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.*
2. *Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent.”*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 10
(Liria e shprehjes)

1. *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysht kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.*

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Neni 14 (Ndalimi i diskriminimit)

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër

Protokolli Nr. 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit)

1. “Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

Ligji nr. 08/1-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji i kontestuar)

Neni 1 Qëllimi

1. “Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejshëm: KPM) me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të audiovizuele, që u shërben të gjithë qytetarëve.
2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën (ED) 2010/13/EU për Shërbimet Mediale Audio-Vizuele dhe Direktivën (EU) 2018/1808.”

Neni 2 Fushëveprimi

“Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për KPM-në dhe të gjitha subjektet që ofrojnë shërbime audio dhe audiovizuele në Republikën e Kosovës, të licencuara dhe të regjistruara nga KPM.”

Neni 3 Përkufizimet

1. *“Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:*

1.1. Shërbimi medial audiovizuel nënkupton:

1.1.1. shërbimin nën përgjegjësinë redaktuese të një ofruesi të shërbimit medial, qëllimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve me qëllim të informimit, argëtimit ose edukimit të publikut të gjerë përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike sipas ligjit përkatës për Komunikimet Elektronike. Shërbimi medial audiovizuel është transmetim televiziv sipas nën-paragrafit 1.21. të këtij neni apo shërbim medial audiovizuel sipas kërkesës, siç përkufizohet në nënparagrafin 1.29. të këtij neni dhe komunikimet komerciale audiovizuele siç përkufizohet në nënparagrafin 1.24 të këtij neni;

1.1.2. Shërbimet mediale audiovizuele online - shërbime qëllimi kryesor i të cilave është ofrimi i programeve me qëllim të informimit, argëtimit dhe edukimit. Qëllimi kryesor përmbushet edhe kur ofruesi i shërbimit ofron përmbajtje audiovizuele e cila është e ndarë nga aktiviteti kryesor i ofruesit të shërbimit, siç janë pjesë të pavarura të gazetave elektronike që paraqesin programe audiovizuele ose video të krijuara nga përdoruesit, të cilat mund të konsiderohen të ndara nga aktiviteti i tyre kryesor, përfshirë:

1.1.2.1. Një shërbim nga nën-nënparagrafi 1.1.2. i këtij neni, konsiderohet pjesë e pandarë nga aktiviteti kryesor si rezultat i lidhjeve ndërmjet ofrimit të shërbimit medial audiovizuel dhe aktivitetit kryesor siç është ofrimi i lajmeve në formë të shkruar.

1.1.2.2. Kanalet ose çdo shërbim tjetër audiovizuel nën përgjegjësinë editoriale të një ofruesi mund të përbëjnë shërbime mediale audiovizuele në vetëvete, edhe nëse ato ofrohen në platformat për shpërndarjen e videove ose në mediat sociale për të cilat mungon përgjegjësia editoriale.”

[...]

Neni 4 Kompetencat e KPM-së

1. “KPM është organ i pavarur, përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit.

2. KPM përveç kompetencave të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, ushtron edhe këto kompetenca:

2.1. rregullon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik që ofrojnë shërbime mediale audio, audiovizuele përfshirë ato të ofruara online, shërbimet e platformës për shpërndarjen e videove, operatorët e shpërndarjes si dhe operatorët e tjerë të cilët pavarësisht eknologjisë së përdorur shpërndajnë ofrues të shërbimeve mediale audiovizuele;

2.2. lëshon leje për ofruesit e shërbimeve audio, audiovizuele, platformat për shpërndarjen e videove, operatorët e shpërndarjes, operatorët e rrjetit dhe operatorët e multipleksit;

2.3. mban dhe përditëson Regjistrin e shërbimeve mediale audiovizuele online sipas nën-nënpagrafit 1.1.2. të nenit 3 të këtij ligji;

2.4. KPM shqyrton dhe miraton çdo ndryshim të pronësisë për të gjithë të licencuarit dhe të regjistruarit sipas përkufizimit në nënpagrafin 2.2. të këtij neni;

2.5. KPM në rast të miratimit të ndryshimit të pronësisë e pajis me vërtetim subjektin e licencuar ose regjistruar për lejimin e ndryshimit të pronësisë edhe në regjistrin e bizneseve pranë agjencionit përkatës për regjistrimin e bizneseve;

2.6. shqipton sanksione mbi subjektet e licencuara dhe të regjistruara që shkelin dispozitat e këtij ligji, aktet nënligjore dhe kushtet e lejes;

2.7. KPM obligon operatorët (ofruesit e shërbimit të internetit) të ndërmarrin të gjitha masat teknike për ndërprerjen e platformave, kanaleve, ose përmbajtjeve të dëmshme vendore ose të huaja të cilat cenojnë sigurinë publike dhe rendin kushtetues në Republikën e Kosovës;

2.8. shqyrton në mënyrë periodike planin e frekuencave të transmetimit, realizon ndryshime të nevojshme dhe njofton autoritetin përkatës në lidhje me çdo ndryshim të planit frekuencor;

2.9. përgatit dhe procedon për miratim në Qeveri, Strategjinë për kalim në transmetim dixhital në Republikën e Kosovës, si dhe dokumentet tjera strategjike për kryerjen e funksioneve të saj;

2.10. kryen analizën e tregut medial për të licencuarit e KPM-së;

2.11. për qëllimin e nënpagrafit 2.9. të këtij neni KPM obligon operatorët që të lejojnë vendosjen e matësve në pajisje elektronike të destinuara për marrjen e sinjalit të koduara apo të pakoduara nga KPM apo çdo subjekt i lejuar prej KPM-së;

2.12. aprovon kushtet për licencim dhe vendos në lidhje me aplikimet për leje dhe për rilicencim, si dhe dhënien e të drejtës së përdorimit të frekuencave sipas planit të Spektrit të Frekuencave të Transmetimit;

2.13. mbledh tarifat nga subjektet e licencuara;

2.14. nxjerr akte nënligjore për të rregulluar ofruesit e shërbimeve audio, shërbimeve mediale audiovizuele përfshirë ato të ofruara online, platformat për shpërndarjen e videove, operatorët e shpërndarjes, operatorët e rrjetit dhe operatorët e multipleksit, të cilat janë të nevojshme për realizimin e funksioneve në përputhje me standardet ndërkombëtare;

2.15. shqyrton dhe miraton propozimin për buxhetin vjetor të KPM-së dhe përmes Ministrisë përkatëse për financa, e dërgon në Kuvend për miratimin e tij përfundimtar;

2.16. i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri më 31 mars të vitit vijues një raport vjetor për vitin paraprak, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e lejeve dhe shqyrtimin

e ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor publikohet pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

2.17. emëron Kryeshefin e Zyrës Ekzekutive në pajtim me nenin 21 të këtij ligji;

2.18. nxjerr Kodin e Etikës për anëtarët e KPM-së;

2.19. nxjerr Rregulloren e punës me të cilën përcaktohet mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në pajtim me këtë ligj;

2.20. nxjerr rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës dhe çështjeve të tjera organizative në pajtim me këtë ligj;

2.21. themelon Këshillin e Ankesave që trajton ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore si dhe harton e miraton rregulloren e funksionimit të këtij këshilli.”

Neni 7 Pavarësia e KPM-së

1. “KPM gëzon pavarësi organizative, administrative, funksionale dhe financiare në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

2. Anëtarët e KPM-së si dhe personeli i KPM-së, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga organet qeveritare, ndonjë person apo subjekt tjetër publik ose privat. Pavarësia e KPM-së respektohet në çdo kohë dhe asnjë person, subjekt tjetër publik apo privat nuk lejohet të ndikojë tek anëtarët dhe personeli i KPM-së në realizimin e detyrave të tyre.

3. KPM-së ka buxhetin e tij vjetor.”

Neni 8 Pluralizmi medial

“KPM themelon fond të veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbështetjen e programeve mediatike dhe mediave të licencuara apo të regjistruara në përputhje me parimet e këtij ligji në fushën e edukimit, demokracisë, arteve, sporteve dhe ekonomisë.”

Neni 10 Edukimi medial

4. “KPM përgatit materiale tekstuale, animacione, video dhe forma tjera të komunikimit për të promovuar edukimin medial.

5. Obligohet RTK që materialet e edukimit medial t'i transmetojë se paku një herë në javë në kohën prime sipas rekomandimeve të KPM-së me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë.

6. Obligohen të gjitha kanalet gjeneralistike që të transmetojnë materialet e edukimit medial së paku një herë në muaj me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë.

7. RTK dhe kanalet tjera gjeneralistike obligohen të shfaqin emisione ose debate në funksion të edukimit medial së paku një herë në tre (3) muaj.”

Neni 12 **Politika e transmetimit**

1. “Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM obligohet të jetë në përputhje me legjislationin në fuqi dhe standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut.

2. Politika e transmetimit, e përcaktuar nga KPM, mbron dhe mbështet:

2.1. produksionin e krijuesve vendas;

2.2. shërbimet cilësore, të shumëllojshme duke përfshirë shtrirjen gjeografike në mënyrën më të mirë të mundshme për t'i shërbyer të gjitha komuniteteve në Kosovë;

2.3. mbështetë programe edukative cilësore;

2.4. siguron krijimin e kushteve për cilësinë teknike të transmetimit në Kosovë;

2.5. përdorimin e teknologjisë së re dhe të sigurojë të drejtën e publikut për të ditur dhe për t'u njoftuar, përmes promovimit të programeve të sakta dhe informative.

3. Politika e transmetimit promovon transmetimin e programeve vendore me karakter edukativ, arsimor dhe kulturor, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë.

4. KPM siguron që programet të përmbajnë dhe pasqyrojnë barazi mes qytetarëve të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

5. Politika e transmetimit promovon vepra me origjinë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian si dhe produksione me origjinë nga shtetet e treta evropiane të përfshira në Konventën Evropiane për Televizionin pa kufij të Këshillit të Evropës.

6. KPM ndërmerr masat e nevojshme për t'i siguruar rëndësinë e duhur shërbimeve mediale audiovizuele me interes të përgjithshëm.

7. KPM siguron, aty ku është e mundur dhe me mjetet e duhura, që transmetuesit rezervojnë të paktën dhjetë përqind (10%) të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshoping, ose me rradhë, të paktën dhjetë përqind (10%) të buxhetit të tyre programor për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit. Ky proporcion, duke pasur parasysh përgjegjësitë informative, arsimore, kulturore dhe argëtuese të transmetuesit ndaj publikut të tij shikues, duhet të arrihet në mënyrë progresive, mbi bazën e kritereve të përshtatshme. Kjo arrihet duke caktuar një proporcion të përshtatshëm për veprat e fundit, si veprat e transmetuara brenda pesë (5) viteve nga prodhimi i tyre.

8. Detyrimi nga paragrafi 7 i këtij neni nuk vlen për ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe rajonal dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale tematike.

[...]

12. Mënyra e mbështetjes financiare të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga KPM.”

[...]

Neni 14 Përbërja e KPM

1. “KPM përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.

2. Anëtarët e KPM-së duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, financat, ekonomia, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media, teknologjia informative, telekomunikimi, politikat publike, inteligjenca artificiale, inxhinieria dhe fusha të tjera të përafërta.

3. Anëtarët e KPM-së duhet të jenë individë me integritet dhe autoritet të lartë profesional të dëshmuar. Gjatë punës së tyre, anëtarët e KPM-së duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm.

4. Në përbërje të Komisionit duhet të jenë së paku një (1) anëtar/e nga fusha e drejtësisë, një (1) anëtar/e nga fusha e financave, një (1) anëtar/e nga fusha e inxhinierisë së telekomunikimit, një (1) anëtar/e nga fusha e gazetarisë.

5. Anëtarët e KPM-së emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë KPM-së. Atyre nuk u lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë udhëzim në lidhje me aktivitetet e KPM-së nga asnjë person apo subjekt jashtë institucionit.

6. Përbërja e anëtareve të KPM-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku tre (3) anëtarë të KPM-së emërohen nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

7. Anëtarëve të KPM-së u ndalohet keqpërdorimi i pozitës për përfitim personal apo familjar, të ndonjë pale apo entiteti tjetër si dhe para çdo procesi të vendimmarrjes secili/a anëtar/e deklarohet me shkrim dhe nën betim sipas ligjit përkatës për konfliktin e interesit për konfliktet eventuale.”

Neni 15 Zgjedhja e anëtarëve të KPM

1. “Anëtarët dhe kryetari i KPM-së zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, si në vijim:

1.1. brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para kalimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj;

1.2. kandidaturat e pranuar për kryetar dhe ato për anëtarë shqyrtohen nga Komisioni përkatës për media i Kuvendit të Kosovës;

1.3 brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni përkatës për media, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë të lirë të kryetarit dhe anëtarit të KPM-së, për të cilët konsideron se janë me të përshtatshmit në bazë të kompetencave, përgatitjes profesionale integritetit dhe përkushtimit të tyre për fushëveprimin e KPM-së;

1.4. Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të tij, që janë të pranishëm dhe që votojnë, duke u bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit.

2. Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore.”

Neni 17

Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të KPM

1. “Kryetari dhe anëtarët e KPM-së zgjedhen me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

2. Pas përfundimit të mandatit, nëse kryetari dhe anëtarët e rinj nuk kanë mundur të zgjidhen, sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj, kryetari dhe anëtarët e KPM-së të cilëve u ka skaduar mandati vazhdojnë të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe anëtarëve të rinj nga Kuvendi.

2.1. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet në rastin e shkarkimit dhe dorëheqjes të Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së.

3. Nënkryetari i KPM-së zgjidhet nga anëtarët e KPM-së me shumicë të thjeshtë, me mandat katër (4) vite, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër si dhe është i gjinisë tjetër nga Kryetari.

4. Kryetari dhe anëtarët e KPM-së janë të angazhuar sipas detyrave dhe përgjegjësiave të caktuara me këtë ligj dhe në bazë të seancave dhe takimeve të KPM-së.

5. Detyrat specifike të Kryetarit, Nënkryetarit dhe anëtarëve përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga KPM.”

Neni 18

Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së

1. “Kryetari dhe anëtari i KPM-së shkarkohet nga detyra kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për shkarkim sipas paragrafit 3 të këtij neni.

2. *Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së bëhet sipas procedurës në vijim:*
 - 2.1. *propozimi për shkarkim vjen nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për media;*
 - 2.2. *Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë vendos për shkarkimin ose jo të Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së.*
3. *Shkarkimi i anëtarit të KPM-së bëhet si rezultat i këtyre rrethanave:*
 - 3.1. *paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t'i përmbushë detyrat e Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së;*
 - 3.2. *paaftësisë mendore apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit;*
 - 3.3. *dështimit në realizimin e detyrave për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muaj, pa aprovim nga KPM-ja;*
 - 3.4. *marrje pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje;*
 - 3.5. *humbje e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM.*
 - 3.6. *dënimi për veprë penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burgim efektiv;*
 - 3.7. *mos përmbushja e kushteve sipas nën-paragrafëve 1.3 dhe 1.5. të paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji;*
 - 3.8. *mungesa në punë mbi pesëmbëdhjetë (15) ditë pa arsye;*
 - 3.9. *pjesëmarrja aktive në aktivitete politike pas emërimit si anëtar i KPM-së.*
4. *Anëtarët e KPM-së mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim KPM-në të paktën tre (3) muaj përpara.”*

Neni 25

Leja e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre

- “1. KPM lëshon leje për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transmetimit dhe shpërndarjes të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele në Republikën e Kosovës, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.*
- 2. Lejet e lëshuara nga KPM kanë vlefshmëri dhjetë (10) vjet.*
- 3. Lejet nuk mund të shfrytëzohen në asnjë rrethanë pa aprovimin paraprak me shkrim të lëshuar nga KPM.*
- 4. Lejet nuk lejohet të transferohen në asnjë rrethanë pa aprovimin paraprak me*

shkrim të lëshuar nga KPM.

5. Vazhdimi i shfrytëzimit të lejes mund të bëhet vetëm pasi të jetë miratuar me shkrim ndryshimi i pronësisë nga KPM.

6. Subjektet e licencuara janë të obliguara të veprojnë në përputhje me këtë Ligj dhe legjislacionin tjetër përkatës, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me politikat transmetuese të përcaktura nga KPM.

7. Leja nga KPM lëshohet pas vërtetimit zyrtar nga agjencioni përkatës për regjistrimin e bizneseve dhe agjencioni përkatës për tatimet se subjekti i regjistruar biznesor nuk ka masa ndëshkimore apo nuk ka detyrime të pashlyera, kurse për entitetet që funksionojnë si OJQ duhet vërtetim zyrtar mbi regjistrimin e tyre pranë ministrisë përkatëse.

8. KPM e lëshon lejen pasi të ketë marrë deklarinin nën betim të subjektit që nuk është në asnjë obligim financiar apo nën një masë ndëshkuese nga ndonjë insitucion tjetër që lëshon leje dhe licenca.

9. KPM kërkon deklarinin e burimeve të financimit dhe pronarët përfitues të subjektit që ka aplikuar për leje apo për regjistrim.

10. KPM verifikon saktësinë e të dhënave të dorëzuara nga aplikuesi në formë zyrtare me institucionet përkatëse.”

Neni 39 **Shkelja e kushteve të lejes**

1. “KPM monitoron të licencuarit dhe mund të iniciojë dhe të pranojë ankesa përkitazi me mosveprimin në përputhje me kushtet e lejes, kodit të etikës, dhe akteve të tjera të nxjerra në pajtueshmëri me këtë ligj.

2. KPM shqyrton ankesat që pretendojnë shkeljen e kushteve të lejes, kodit të etikës dhe akteve të tjera të nxjerra në pajtueshmëri me këtë ligj.

3. KPM përmes Zyrës Ekzekutive e njofton me shkrim subjektin transmetues për çdo pretendim lidhur me shkeljen e kushteve të lejes, kodit të etikës dhe akteve të tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj, dhe siguron që subjekti transmetues të ketë mundësi efektive për të paraqitur deklaratat e tij.

4. Pas përfundimit të hetimit, KPM nxjerr vendim bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit përkatës.

5. Të licencuarit nga KPM kanë të drejtë ankese në gjykatën kompetente, lidhur me lejen, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të vendimit.”

Neni 42 **Pronësia dhe koncentrimi i mediave**

1. “Me qëllim të përcaktimit të standardeve në lidhje me pluralizmin dhe diversitetin e medias dhe transparencën në pronësinë e medias, përcaktimin e rregullave për

koncentrimin e pronësisë në media, parandalimin e monopolit në tregun medial, ndalimin e dominimit dhe presionit të medias, zhvillimin dhe promovimin e lirisë së shprehjes, duke ruajtur pavarësinë editoriale dhe të drejtën për informacion objektiv në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikën më të mira evropiane, të licencuarit i nënshtrohen rregullave të përcaktuara nga KPM për parandalimin e koncentritimit të mediave.

2. Të gjitha kanalet televizive me përmbajtje gjeneralistike, si dhe ato lokale që kanë leje të përdorimit të frekuencës, i nënrenditen rregullit të bartjes së detyrueshme (must carry) nga ana e operatorëve kabllor dhe atyre dixhital të shpërndarjes. Në rast të tejngarkesës me të tilla kanale, KPM ruan të drejtën të vendos rregulla komerciale të qasjes.”

Neni 43 **Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve**

1. “Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë dhe/ose aksioneve të njoftojë me shkrim KPM-në.

2. Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të merr aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja.

3. Asnjë i licencuar/regjistruar nuk mund të transmetojë më shumë se tridhjetë përqind (30%) të vlerës së tregut të përgjithshëm medial të komunikimeve komerciale audiovizuale.

4. Një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër.

5. Pronësia në media është e lejuar vetëm për kompanitë ose organizatat të cilat janë të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Në shërbim të pluralizmit medial dhe për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, pronarët përfitues duhet të ofrojnë të gjitha informacionin e nevojshëm për preardhjen e pasurisë me rastin e regjistrimit dhe raportimit financiar vjetor.

7. KPM bazuar në rezultatet dhe nevojat të cilat rezultojnë nga analiza e tregut medial, me akt nënligjor përcakton rregulla specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave.”

KAPITULLI VIII **SANKSIONET**

Neni 60 **Sanksionet me gjobë**

1. Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, KPM ndërmerr masat ndëshkuese si në vijim:

1.1. Shqipton gjobë nga pesëqind (500) deri në katër mijë (4,000) euro për personin fizik në rastin kur operon pa leje nga KPM;

1.2. Shqipton gjobë nga pesëqind (500) deri në njëzet mijë (20,000) euro për personin juridik për rastet kur:

1.2.1. nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga ky ligj;

1.2.2. nuk dorëzon raportin vjetor në KPM brenda afatit të parashikuar;

1.2.3. nuk zbaton afatin e ruajtjes së arkivës së transmetimeve, sipas kushteve dhe termeve të përgjithshme të lejes dhe rregullores përkatëse për ofruesit e shërbimeve mediale;

1.2.4. nuk respekton kohën e përcaktuar për transmetim, sipas kushteve dhe termeve të përgjithshme të lejes dhe rregullores përkatëse për ofruesit e shërbimeve mediale;

1.2.5. nuk respekton përcaktimet e nenit 41 të këtij ligji për transmetimin e komunikimeve komerciale dhe rregullores përkatëse për komunikimet komerciale audiovizuale;

1.2.6. nuk respekton kushtet e lejes për sa i përket programeve të prodhuara në vend dhe veprave evropiane;

1.2.7. nuk njofton për ndryshimet që kanë ndodhur në të dhënat e paraqitura në leje për të cilat nuk kërkohet miratim nga KPM, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike nga data e kryerjes së ndryshimeve;

1.2.8. ndalon hyrjen e zyrtarëve të KPM-së në mjediset ku janë vendosur pajisjet audio dhe audiovizuale të të licencuarit ose nuk ofrohen të dhënat e kërkuara prej tyre;

1.2.9. shkakton interferenca ndaj një subjekti tjetër, si rezultat i mosrespektimit të kushteve teknike në transmetim;

1.2.10. kryen transmetime në një frekuencë tjetër të paautorizuar;

1.2.11. kryen transmetime me fuqi rrezatuese më të madhe se atë të autorizuar;

1.2.12. transmeton nga vende të ndryshme nga atë të përcaktuara në leje;

1.2.13. transmeton apo kryen aktivitet në shërbime audio dhe/ose audiovizuale sipas kërkesës, pa autorizimin e KPM-së;

1.2.14. nuk respekton në transmetim kufijtë territoriale, të përcaktuar në kushtet e lejes;

1.2.15. instalon pajisje televizive ose radioje, për transmetim tokësor apo përmes operatorëve të shpërndarjes me sinjal audio ose audiovizuale pa lejen e KPM-së;

1.2.16. transmeton, ritransmeton ose shpërndan shërbime mediale audio dhe audiovizuale në mënyrë të paautorizuar;

1.2.17. instalon pajisje për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale;

1.2.18. instalon pajisje për shpërndarjen e videove pa lejen e KPM-së;

1.2.19. nuk respekton të drejtën e reagimit, sipas nenit 52 të këtij ligji;

1.2.20. prodhon, importon, shpërndan, shet, jep me qira ose posedon, për qëllime tregtare, pajisje të ndaluara;

1.2.21. instalon, mirëmban ose zëvendëson, për qëllime tregtare, pajisje të ndaluara;

1.2.22. përdor komunikime tregtare për promovimin e pajisjeve të ndalura;

1.2.23. nuk respekton kushtet e lejes sipas këtij ligji;

1.2.24. nuk respekton obligimet e tjera sipas këtij ligji.

1.3. KPM mund të dyfishojë sanksionin me gjobë nga nënparagrafi 1.2. i këtij neni në rastet kur personi juridik:

1.3.1. shkakton në mënyrë të përsëritur interferenca të dëmshme ndaj një subjekti tjetër;

1.3.2. përsërit shkeljet e përcaktuara në nënparagrafin 1.2. të këtij neni;

1.3.3. transmeton, ritransmeton, apo shpërndan përmbajtje programore që nxisin urrejtje, dhunë dhe trazira;

1.3.4. transmeton, ritransmeton, apo shpërndan përmbajtje që cenon rendin dhe sigurinë publike;

1.3.5. transmeton, ritransmeton, apo bën shpërndarje ilegale të përmbajtjeve programore;

1.3.6. nuk dorëzon në afatin parashikuar raportin vjetor në KPM.

2. Gjatë shqiptimit të sanksioneve me gjobë sipas këtij neni, KPM merr parasysht:

2.1. nivelin e dëmit të shkaktuar nga shkelja;

2.2. kohëzgjatjen e shkeljes;

2.3. rrethanat lehtësuese, ose rënduese të personit fizik apo juridik;

2.4. qëndrueshmërinë financiare të subjektit.”

Pranueshmëria e kërkesave

101. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
102. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
103. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”
104. Andaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet (i) të parashtrohet nga së paku dhjetë (10) deputetë të Kuvendit; (ii) të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, përkitazi me përmbajtjen dhe/ose për procedurën e ndjekur; si dhe (iii) të parashtrohet brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.
105. Gjykata, në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesat përkatëse, vëren se kërkesat janë parashtruar nga dhjetë (10) deputetë secila, numër ky i cili përmbush kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën.
106. Gjykata, gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, vëren se parashtruesit e kërkesave e kontestojnë Ligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, të miratuar në Kuvend më 11 korrik 2024. Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa/kërkesat përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se kërkesa KO152/24 është dorëzuar në Gjykatë, më 18 korrik 2024, ndërsa kërkesa KO158/24 më 19 korrik 2024, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi, më 11 korrik 2024, që nënkupton se kërkesat janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
107. Andaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesave legjitimohen si palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar para Gjykatës, si për nga procedura e ndjekur ashtu edhe për nga përmbajtja e dispozitave të tij, pasi në rastin konkret, parashtruesit e kërkesave, që të gjithë janë deputetë të legjislaturës së VIII të Kuvendit, andaj të njëjtit konsiderohen palë e autorizuar dhe rrjedhimisht, e kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi më 11 korrik 2024.
108. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Neni 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.”

109. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72

(Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“[...]

(3).Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4).Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.

110. Në kontekst të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave (i) kanë shënuar emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesat e tyre përkatëse; (ii) kanë specifikuar Ligjin e kontestuar të Kuvendit; (iii) iu janë referuar neneve specifike të Kushtetutës, me të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) kanë dorëzuar argumentet në mbështetje të pretendimeve të tyre.
111. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave përkatëse, Gjykata i deklaron kërkesat e parashtruesve të kërkesave të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e tyre.

Meritat e kërkesës

Hyrje

112. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesave, respektivisht njëzet (20) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes dy (2) kërkesave të ndara, duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar dhe i cili pretendojnë se është në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 42 [Liria e Medieve], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 119 [Parimet e Përgjithshme]

dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës. Pretendimet e tyre, në esencë dhe sipas sqarimeve të dhëna në pjesën që ndërlidhet me pretendimet dhe përgjigjet e palëve të interesuara para Gjykatës, mbështeten në parim edhe nga Avokati i Popullit dhe AGK, ndërsa kundërshtohen nga Kryeministri, në emër të Qeverisë.

113. Gjykata në vijim, për aq sa është relevante, do të përmbledhë esencën e (i) Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave të vitit 2012, aktualisht në fuqi; (ii) raporteve të progresit/vendin që ndërlidhet me funksionimin e KPM-së dhe dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian përkitazi me mediat audiovizuele, përfshirë ato online; dhe (iii) Ligjin të kontestuar dhe pretendimet e palëve. Gjykata gjithashtu në këtë pjesë do të përmbledh edhe standardet e BE-se për rregullimin e mediave audiovizuele.

Ligji për KPM-në i vitit 2012

114. Gjykata fillimisht rikujton se Ligji i kontestuar në nenin 64 (Shfuqizimi) përcakton se me hyrjen në fuqi të të njëjtit, shfuqizohet Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në fuqi nga viti 2012, dhe i cili aktualisht rregullon kompetencat e KPM-së dhe tregun e shërbimeve mediale audiovizuele në Kosovë.
115. Në këtë kuptim, Ligji aktual në fuqi i vitit 2012 bazuar në (i) nenin 3 (Kompetencat e KPM-së) përcakton kompetencat e KPM-së, përfshirë licencimin e transmetuesit publik e privat dhe ripërtëritjen licencave; vendosjen e sanksioneve për subjektet e licencuara; shqyrtimin e planit të frekuencave të transmetimit; aprovimin e kushteve për licencim; dhe kompetencën e saj që të nxjerr “akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin” e tij. I njëjti gjithashtu përcakton në (ii) nenin 6 (Pavarësia e KPM-së), se “Anëtarët e KPM-së si dhe personeli i KPM-së, nuk marrin udhëzime nga ndonjë person apo subjekt tjetër, duke përfshirë edhe subjektet qeveritare”; ndërsa në (iii) nenet 10 (Përbërja e KPM-së), 11 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së), 13 (Mandati i Anëtarëve të KPM-së) dhe 14 (Shkarkimi nga KPM dhe sjellja e anëtarëve) përcakton se, KPM ka shtatë (7) anëtarë të cilët zgjedhën “me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë”, pas rekomandimit të një “komisioni ad-hoc” të Kuvendit, dhe se të njëjtit mund të rizgjedhën vetëm edhe për një mandat tjetër; dhe se shkarkimi i anëtarëve të KPM-së bëhet nga Kuvendi “me shumicë të thjeshtë” të votave për arsyet e përcaktuara në Ligjin e KPM-së. Për më tepër, (iv) Ligji i vitit 2012 në Kapitullin VI (Bordi i Ankesave), ka përcaktuar Bordin e Ankesave si trupë e pavarur e emëruar nga Kuvendi i cili, ndër të tjera, shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së (v) në Kreun IV përcakton Licencimin e Shërbyesve Medial Audiovizuel, që në fakt, janë licenca për të ushtruar transmetim në Kosovë, duke e bërë dallimin në mes radio transmetimeve dhe shërbime mediale audiovizuele dhe për operatorët e rrjeteve për ofrimin e shërbimeve mediale me përmbajtje audiovizuele; dhe (vi) nenin 30 (Sanksionet) përcakton sanksionet për shkelje të kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve tjera juridike, përfshirë gjoba deri në njëqindmijë (100,000.00) euro.

Raportet e progresit/vendin që ndërlidhet me funksionimin e KPM-së

116. Gjykata vëren se ashtu siç rezulton nga Raportet e Progresit/Vendit për Kosovën të Komisionit Evropian ndër vite, dhe siç do të elaborohet në vijim, është evidentuar nevoja e ndryshimit të Ligjit të KPM-së të vitit 2012, ndër të tjera, për të përcaktuar (i) zgjerimin e kompetencave të KPM-së për të monitoruar edhe mediat online; (ii) rregulla sa i përket transparencës, koncentrimit dhe pronësisë së medieve; (iii) përafrimit me direktivat relevante të BE-së; (iv) rregulla të duhura sa i përket sanksioneve; dhe (v) aspekte tjera të

funksionimit të KPM-së. Megjithatë, ashtu siç do të sqarohet më poshtë, Raporti i vitit 2024 për Kosovën i Komisionit Evropian, përkitazi me Ligjin e kontestuar thekson, ndër të tjera, se (i) amendamentet e Kuvendit kanë dështuar që të reflektojnë shumicën e rekomandimeve të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtarë; (ii) shqetësime mbeten sa i përket: pavarësisë, kompetencave dhe financimit të KPM-së; dhe (iii) ekziston mungesë e qartësisë dhe proporcionalitetit të Ligjit të kontestuar. Të gjeturat e raporteve për Kosovën ndër vite do të përmbledhen në vijim, duke filluar nga vitit 2016 e tutje.

117. Raporti i vitit 2016 për Kosovën i Komisionit Evropian dhe Raporti i vitit 2018, theksojnë, ndër të tjera, se: *“Liria e shprehjes online nuk monitorohet as nga [KPM] as nga Këshilli Kosovar i Shtypit. Edhe pse kjo krijon ambient të papenguar për mediat online, kjo gjithashtu dëmton privatësinë e individëve, duke rezultuar në shumë raste të gjuhës së urrejtës, shpifjeve e sharjeve”* (shih [Raportin e vitit 2016 për Kosovën](#), Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016, SWD (2016) 363 final, të 9 nëntorit 2016, faqe 25; dhe [Raportin i vitit 2018 për Kosovën](#), Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2018, SWD (2018) 156 final, të 17 prillit 2018, faqe 23).
118. Raporti i vitit 2019 për Kosovën i Komisionit Evropian thekson, ndër të tjera, se: *“Gazetat dhe transmetuesit të cilët kanë kaluar në botën online nuk mbikëqyren më. Këshilli i Mediave të Shkruara ndjek shtypin online duke reaguar ndaj ankesave, por nuk ka burime të nevojshme për të realizuar hetime apo analiza të tregut. Komisioni i Pavarur i Mediave nuk ka kompetencë për të licencuar dhe monitoruar shërbimet online të medias audio-vizuale (p.sh. video me kërkesë (VoD), catch-up TV dhe WebTV), të cilat janë mbuluar tashmë nga Direktiva e Shërbimeve të Medias Audio-vizuale të miratuar në vitin 2010. Ndonëse kjo krijon një mjedis të papenguar për median në internet, gjithashtu zvogëlon privatësinë e individëve, duke rezultuar me raste të pretendimeve për gjuhë të urrejtjes, shpifje dhe fyerje”. Për më tepër, i njëjti Raport thekson se “Ligji për Komisionin e Pavarur për Media çoi në krijimin e një rregullatori të pavarur të cilit autoritetet i kanë siguruar kompetenca të mjaftueshme rregullatore, monitoruese dhe zbatuese për të siguruar që pluralizmi i brendshëm dhe i jashtëm i medias mbrohet. Megjithatë, legjislati i tillë nuk mbulon mediat online”* prandaj, Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2019 rekomandon që të rishikohet Ligji për KPM-së “me qëllim të azhurnimit të kompetencave të tij, duke përfshirë shërbimet online mediatike audio-vizuale të mbuluara nga Direktiva e Shërbimeve të Medias Audio-vizuale 2010” (shih [Raportin e vitit 2019 për Kosovën](#), Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2019, SWD (2019) 216 final, të 25 majit 2019, faqe 26).
119. Raporti i vitit 2020 për Kosovën i Komisionit Evropian thekson se: *“[...] pjesërisht për shkak të mungesës së informacionit mbi pronësinë e mediave dhe shpërndarjen e fondeve të reklamave, KPM-ja nuk vendos sanksione efektive ndaj transmetuesve. KPM-ja ka nevojë për staf adekuat dhe fonde të përshtatshme për t’i ushtruar kompetencat e saj ekzistuese në mënyrë të pavarur, por kompetencat e saj duhet të shtrihen edhe në mediat audio-vizuale në internet (p.sh. Catch up TV, video sipas zgjedhjes “VoD” dhe web TV).”* I njëjti Raport po ashtu rekomandon rishikimin e Ligjit për KPM-në “në mënyrë që të rrisë disponueshmërinë e të dhënave në sektorin audio-vizual dhe t’i zgjerojë kompetencat rregullatore, monitoruese dhe zbatuese të rregullatorit.” (shih [Raportin e vitit 2020 për Kosovën](#), Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin

Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, *Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2020* SWD (2020) 2356 final, të 25 majit 2019, faqe 100-101).

120. Raporti i vitit 2021 për Kosovën i Komisionit Evropian, vë theksin gjithashtu në nevojën që të ketë “*Transparencë më të madhe sa i përket pronësisë së mediave dhe koncentrimit të mundshëm ilegal të mediave*”. Gjithashtu i njëjti Raport potencon faktin që KPM “*ende nuk ka kompetencë për të licencuar dhe monitoruar shërbimet e mediave audio-vizuele online [...]*” duke potencuar po ashtu faktin se KPM monitoron përmbajtjen gjatë kampanjave zgjedhore. Gjithashtu, i njëjti Raport thekson se Kosova duhet të rishikojë Ligjin për KPM-në për të “*azhurnuar kompetencat e tij, duke përfshirë shërbimet online mediatike audio-vizuale në linjë me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audio-vizuale*” (shih [Raportin e vitit 2021](#) për Kosovën, Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, *Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2021* SWD (2021) 292 final/1, të 19 tetorit 2021, faqe 30, 31, 32).
121. Raporti i vitit 2022 për Kosovën i Komisionit Evropian, po ashtu vë theksin në nevojën për rishikimin e Ligjit për KPM-në, duke përsëritur se KPM (i) ende nuk ka kompetencë për të licencuar dhe monitoruar shërbimet mediale audiovizuele online, megjithëse këto mbuloheshin nga Direktiva për Shërbimet Mediale Audiovizuele; (ii) aktualisht, KPM-së i mungon personeli dhe burimet adekuate për të ushtruar kompetencat e veta në mënyrë të pavarur; (iii) numri i mediave online që nuk regjistrohen tek Këshilli i Medieve ka vazhduar të rritet dhe se qëndrueshmëria e stabilitetit financiar të Këshillit është vendimtare për funksionimin efektiv; (iv) pjesërisht për shkak të mungesës së informacionit mbi pronësinë e mediave dhe shpërndarjen e fondeve për reklama, KPM nuk vendos sanksione efektive ndaj transmetuesve; (v) Ligji aktual në fuqi për KPM-në ofron gjerësisht kompetenca të mjaftueshme rregullatore, zbatuese dhe monitoruese për të siguruar pluralizëm dhe konkurrencë në treg, megjithatë, (vi) ndryshimi i Ligjit për KPM-në, i cili aktualisht është në proces, duhet ta harmonizojë më tej Ligjin me Direktivën e Shërbimit Medial Audiovizuel për të shtrirë kompetencat e tij në mediat audiovizuele online (shih [Raportin e vitit 2022](#) për Kosovën, Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, *Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2022* SWD (2022) 334 final, të 12 tetorit 2022, faqe 33, 34 dhe 94).
122. Raporti i vitit 2023 për Kosovën i Komisionit Evropian vë theksin në faktin që (i) nuk kishte progres në ndryshimin e Ligjit për KPM-në për të përafruar me Direktivën e lartcekur të BE-së dhe se projektligji për KPM-në i harmanizuar me Direktivën e vitit 2018 të BE-së për Mediat Audiovizuele, është ende në pritje të miratimit në Kuvend, duke kërkuar që e njëjta të harmonizohet edhe më tutje me Direktivën përkatëse për të zgjeruar kompetencat e KPM-së sa i përket mediave audiovizuele online; (ii) Kosova duhet rritur disponueshmërinë e të dhënave të tregut audiovizuel, veçanërisht sa i përket pronësisë së mediave; (iii) procesi duhet jetë transparent dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë mediat dhe shoqërinë civile; (iv); KPM gjatë periudhës raportuese ka qenë në masë të madhe jofunksionale për shkak të mungesës së kuorimit, pasi që Kuvendi ka dështuar në zgjedhjen e një anëtarit të ri deri në mars të vitit 2023; dhe se Raporti po ashtu potencon se (v) mungesa e të dhënave të tregut audiovizuel, veçanërisht sa i përket pronësisë së mediave, mbetet brengë (shih [Raportin e vitit 2023 për Kosovën](#), Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, *Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2023* SWD (2023) 692 final, të 9 nëntorit 2023, faqe 32, 33 dhe 97).

123. Në fund, Raporti i vitit 2024 për Kosovën i Komisionit Evropian, i nxjerrë pas miratimi të Ligjit të kontestuar, vë theksin, ndër të tjera, në faktin që: (i) Ligji i kontestuar është miratuar në Kuvend dhe i njëjti kontribuon në përmirësimin e rregullimit të mediave dhe performancës së KPM-së; megjithatë sipas Raportit të lartcekur (ii) amendamentet e Kuvendit kanë dështuar që të reflektojnë shumicën e rekomandimeve të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtarë. Më konkretisht, i njëjti specifikon se (iii) shqetësime mbeten sa i përket pavarësisë, kompetencave dhe financimit të KPM-së dhe sa i përket mungesës së qartësisë dhe proporcionalitetit të ligjit. Ky raport, ka rekomanduar që të sigurohet zbatimi i Ligjit të kontestuar duke siguruar përafrimin me *Acquis* të BE-së dhe standardet evropiane (shih [Raportin e vitit 2024 për Kosovën](#), Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, *Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2024* SWD (2024) 692 final, të 10 tetorit 2014, faqe 33).

Legjislacioni i Bashkimit Evropian përkitazi me mediat audiovizuele përfshirë ato online

124. Gjykata rikujton se në nivel të Bashkimit Evropian çështja e mediave audiovizuele është e rregulluar, ndër të tjera, me Direktivën AVMS-së 2010/13, e ndryshuar përmes Direktivës 2018/1808 të 14 nëntorit 2018 (në tekstin e mëtejshëm: Direktiva AVMS) dhe [Rregulloren \(EU\) 2024/1083](#) për krijimin e kornizës së përbashkët për shërbimet mediale në tregun e brendshëm dhe amendamentin e Direktivës 2010/11/EU. Në këtë kontekst, Direktiva AVMS 2010/13 vendos rregulla bazë sa i përket shërbimeve mediale duke përcaktuar edhe definicionet, ndër të tjera, për shërbimet mediale audiovizuele, shërbimet mediale audiovizuele sipas kërkesës, dhe ofruesit e shërbimeve të mediave.
125. Ndërsa, Direktiva 2018/1808, ndryshon dhe azhurnon Direktivën bazë AVMS 2010/13, në mënyrë që të zgjerojë aplikueshmërinë e disave nga rregullat e platformave të shpërndarjes së videove edhe përkitazi me përmbajtjen audiovizuale që shpërndahen në disa shërbime të medieve sociale. Në këtë kontekst, pika 1 e Direktivës 2018/1808, përcakton se *“Sidoqoftë, llojet e reja të përmbajtjes, si video klipet, apo përmbajtje e gjeneruar nga përdoruesi, kanë marrë rëndësi të shtuar dhe aktorët e rinj, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve të videove sipas kërkesës dhe platformat e shpërndarjes së videove, vetëm se janë të mirë themeluara. Kjo mbulesë e mediave kërkon një kornizë juridike të azhurnuar për të reflektuar zhvillimet në treg dhe për të arritur një baraspeshë në mes të qasjen në përmbajtjen e shërbimeve online, mbrojtje të konsumatorëve dhe konkurrueshmërisë”*.
126. Gjykata vëren se në ndërkohë që Ligji i kontestuar ishte në procedura të draftimit, në nivel të Bashkimit Evropian ishte nxjerrë edhe Rregullorja e BE-së 2024/1083, e 11 prillit 2024. E njëjta përcakton rregulla më të detajuara sa i përket, ndër të tjera, medieve online, si dhe pronësisë dhe koncentrimin të mediave. Më konkretisht, Rregullorja e BE-së 2024/1083, thekson se (i) shërbimet mediatike janë gjithnjë e më shumë në dispozicion qoftë në internet apo përtej kufijve, por nuk iu nënshtrohen rregullave të njëjta dhe shkallës së njëjtë të mbrojtjes në shtete anëtare të ndryshme (pika 1); (ii) në hapësirën e mediave digjitale, qytetarët dhe bizneset iu qasen dhe konsumojnë përmbajtje dhe shërbime mediatike, të cilat janë në dispozicion të menjëhershëm në pajisjet e tyre personale, gjithnjë e më tepër në suaza përtej kufijve. E tillë është situata kur kemi të bëjmë me shërbimet e mediave audio-vizuale, radion dhe shtypin, të cilat janë lehtësisht të qasshme përmes internetit, për shembull nëpërmjet podkasteve ose portaleve të lajmeve në internet (pika 3); (iii) në përgjigje të sfidave ndaj pluralizmit të mediave dhe lirisë së mediave në internet, disa shtete

anëtare kanë marrë masa rregulluese, ndërsa shtetet e tjera anëtare me gjasë po ashtu do ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo rrezikon të çojë më tej divergjencat në qasjen e shteteve dhe kufizimet e lëvizjes së lirë në tregun e brendshëm. Prandaj, është e nevojshme të harmonizohen disa aspekte të rregullave të shteteve që lidhen me pluralizmin mediatik dhe pavarësinë editoriale, duke garantuar kështu standarde të larta në atë fushë (pika 7); (iv) përkufizimi i shërbimit mediatik duhet të mbulojë, në veçanti, transmetimet në televizion ose radio, shërbimet e mediave audio-vizuale me kërkesë, podkastet audio ose publikimet e shtypit. I njëjti duhet të përjashtojë përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit, të cilët ata e ngarkojnë në ndonjë platformë interneti, përveç nëse nuk kemi të bëjmë me ndonjë aktivitet profesional që normalisht ofrohet për t'u marrë parasysh, qoftë i natyrës financiare apo i një natyre tjetër. I njëjti gjithashtu duhet të përjashtojë korrespondencën puro private, si p.sh. postën elektronike, dhe të gjitha shërbimet që nuk kanë si qëllim kryesor ofrimin e programeve apo publikimeve të shtypit, që do të thotë kur përmbajtja është thjesht e rastit për shërbimin dhe jo qëllim kryesor i tij, si fjala bie reklama ose informacione që lidhen me një produkt ose shërbim të ofruar nga faqet e internetit të cilat nuk ofrojnë shërbime mediatike. Komunikimi i korporatave dhe shpërndarja e materialeve për qëllime informimi ose promovimi të subjekteve publike ose private duhet të përjashtohet nga fushëveprimi i përkufizimit. Më tutje, duke qenë se funksionimi i ofruesve të shërbimeve mediatike në tregun e brendshëm mund të ketë forma të ndryshme, përkufizimi i ofruesit të shërbimit mediatik duhet të mbulojë një spektër të gjerë të aktorëve profesionistë të mediave që bien në kuadër të përkufizimit të shërbimit mediatik, duke përfshirë profesionistët e lirë (pika 9); (v) në tregun e mediave digjitale, ofruesit e platformave për shpërndarje të videove ose ofruesit e platformave shumë të mëdha në internet mund të bien në kuadër të përkufizimit të ofruesit të shërbimit mediatik. Në përgjithësi, këta ofrues luajnë një rol kyç në organizimin e përmbajtjes, duke përfshirë përmes mjeteve të automatizuara ose përmes algoritmeve, por nuk ushtrojnë përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjen në të cilën ata ofrojnë qasje. Megjithatë, në mjedisin mediatik gjithnjë e më konvergjent, disa ofrues të platformave për shpërndarje të videove ose ofrues të platformave shumë të mëdha në internet kanë filluar të ushtrojnë kontroll editorial mbi një pjesë ose disa pjesë të shërbimeve të tyre. Për këtë arsye, kur këta ofrues ushtrojnë kontroll editorial mbi një pjesë ose disa pjesë të shërbimeve të tyre, atëherë i njëjti mund të cilësohet edhe si ofrues i një platforme për shpërndarjen e videove edhe si ofrues i një platforme shumë të madhe në internet dhe si ofrues i një shërbimi mediatik; (vi) platformat shumë të mëdha në internet iu shërbejnë shumë përdoruesve si një portë për të ofruar qasje në përmbajtjen mediatike dhe shërbimet mediatike. Ofruesit e shërbimeve mediatike që ushtrojnë përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjen e tyre luajnë një rol kyç në shpërndarjen e informacionit dhe në ushtrimin e të drejtës për të pranuar dhe për të komunikuar informata në internet. Kur të ushtrojnë një përgjegjësi të tillë editoriale, nga ofruesit e shërbimeve mediatike është e pritshme që të veprojnë me zell dhe të ofrojnë informata të besueshme, si dhe t'i respektojnë të drejtat themelore, në përputhje me kushtet e rregullatorit ose mekanizmat bashkë-rregullues ose vetërregullues, të cilave ata iu nënshtrohen në shtetet anëtare. Prandaj, edhe sa i takon të drejtës së përdoruesve për të pranuar dhe për të komunikuar informata, kur ofruesi i një platforme shumë të madhe në internet konsideron se përmbajtja e ofruar nga ofruesit e shërbimeve mediatike është e papajtueshme me kushtet dhe konditat e tij, ai duhet ta ketë në konsideratë ashtu si duhet lirinë e mediave dhe pluralizmin e mediave, në përputhje me Rregulloren (BE) 2022/2065, dhe të ofrojë, sa më shpejt që të jetë e mundur, shpjegimet e nevojshme për ofruesit e shërbimeve mediatike në një arsyetim, siç përcaktohet në nenin 4 (1) të Rregullores (pika 50); (vii) është e justifikuar, duke pasur parasysh ndikimin pozitiv të pritshëm në lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe lirinë e shprehjes, që kur ofruesit e shërbimeve mediatike i respektojnë standardet e caktuara rregullatore, bashkë-rregulluese ose vetërregulluese,

ankesat e tyre kundër vendimeve të ofruesve të platformave shumë të mëdha në internet të trajtohen me prioritet dhe pa vonesa të panevojshme (pika 52).

127. Gjykata po ashtu vëren se neni 18 (Përmbajtja e ofruesve të shërbimeve mediatike në platforma shumë të mëdha në internet) përcakton:

“1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha në internet do të sigurojnë një funksionalitet që iu mundëson pranuesve të shërbimeve të tyre të:

(a) deklarojnë se janë ofrues të shërbimeve mediatike;

(b) deklarojnë se janë në përputhje me nenin 6 (1);

(c) deklarojnë se nga aspekti editorial, ata janë të pavarur nga Shtetet anëtare, partitë politike, vendet e treta dhe subjektet e kontrolluara ose financuara nga vendet e treta;

(d) deklarojnë se iu nënshtrohen kushteve të rregullatorit për ushtrimin e përgjegjësisë editoriale në një ose më shumë Shtete anëtare dhe mbikëqyrjes nga një autoritet ose organ shtetëror kompetent rregullator ose që ata i përmbahen një mekanizmi bashkë-rregullues ose vetërregullues me të cilin rregullohen standardet editoriale gjërësisht të njohura dhe të pranuar në sektorin përkatës të mediave në një ose më shumë Shtete anëtare;

(e) deklarojnë se nuk ofrojnë përmbajtje të krijuar nga sistemet e inteligjencës artificiale pa iu nënshtruar shqyrtimit njerëzor ose kontrollit editorial;

(f) japin emrin e tyre ligjor dhe detajet kontaktuese, duke përfshirë adresën e postës elektronike, përmes së cilës ofruesi i platformës shumë të madhe në internet mund të komunikojë shpejt dhe drejtpërdrejt me ta; dhe

(g) japin detajet kontaktuese të autoriteteve ose organeve përkatëse rregullatore shtetërore ose përfaqësuesve të mekanizmave bashkë-rregullues ose vetërregullues të përmendur në pikën (d).

Kur ka dyshime të arsyeshme në lidhje me pajtueshmërinë e ofruesit të shërbimit mediatik me pikën (d) të nënparagrafit të parë, ofruesi i platformës shumë të madhe në internet do të kërkojë konfirmim për këtë çështje nga autoriteti ose organi përkatës rregullator shtetëror ose nga bashkë-rregullatori ose mekanizmi përkatës vetërregullues.

2. Ofruesit e platformave shumë të mëdha në internet duhet të sigurojnë që informatat e deklaruar sipas paragrafit 1, me përjashtim të informatave të përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafi i parë, pika (f), do të jenë të disponueshme për publikun në një mënyrë lehtësisht të qasshme në ekranin e pajisjes së tyre.

3. Ofruesit e platformave shumë të mëdha në internet do të konfirmojnë pranimin e deklaratave të paraqitura në përputhje me paragrafin 1 dhe do të japin detajet e tyre kontaktuese, duke përfshirë një adresë të postës elektronike, përmes së cilës ofruesi i shërbimit mediatik mund të komunikojë drejtpërdrejt dhe shpejt me ta.

[...]”

Parimet kushtetuese dhe të GJEDNJ-së në lidhje me lirinë e medieve

128. Sa i përket lirisë së mediave, dhe në ndërlidhje me pavarësinë e institucioneve që mbikëqyrin mediat, Gjykata thekson se neni 42 i Kushtetutës përmban 3 paragrafë. Paragrafi 1 i këtij neni (i) garanton lirinë dhe pluralizmin e medieve, ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni (ii) përcakton se censura është e ndaluar dhe se askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

129. Gjykata vëren se neni 42 i Kushtetutës është i ndërlidhur edhe me nenin 40 [Liria e Shprehjes], i cili në paragrafin 1 përcakton: “*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*” Përderisa paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton kufizimet e mundshme duke theksuar specifikisht se “*Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*”
130. Gjithashtu, sipas GJEDNJ-së, por edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, të ushtruarit e lirisë së shprehjes në mënyrë efektive dhe kuptimplotë, nuk kushtëzohet vetëm nga obligimi për mosndërhyrje nga ana e shtetit, por gjithashtu nga obligimi pozitiv i shtetit për të siguruar masa pozitive të mbrojtjes, përmes ligjit dhe praktikës. Prandaj, GJEDNJ thekson se, duke pasur parasysh rëndësinë e asaj që mbrohet përmes nenit 10 të KEDNJ-së, shteti duhet të jetë garantuesi përfundimtar i pluralizmit (shih rastin e GJEDNJ-së [Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë](#), nr. 13936/02, Aktgjykim i 17 shtatorit 2009, paragrafi 99; dhe rastin e Gjykatës [KO134/21](#), parashtrues *Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 gushtit 2023, paragrafi 133). Gjykata dhe GJEDNJ më tej kanë theksuar se mënyrat e realizimit të këtyre qëllimeve varen gjerësisht nga rrethanat vendore, prandaj shtetet gëzojnë një kuadër të gjerë vlerësimi lidhur me këtë (shih rastin *Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*, cituar më lart, paragrafi 100; dhe rastin e Gjykatës [KO134/21](#), cituar më lart, paragrafi 134).
131. Gjykata i referohet edhe njëherë [Përmbledhjes së Opinioneve të Komisionit të Venecias përkitazi me Lirinë e Shprehjes dhe Mediat](#), CDL-PI(2020)008, sipas së cilit (i) pluralizmi i mediave mund të konsiderohet si një aspekt i lirisë së shprehjes dhe e njëjta arrihet kur ka shumësi të mediave autonome dhe të pavarura në nivel kombëtar, regional dhe lokal, që sigurojnë varietete të përmbajtjes të që reflektojnë pikëpamje të ndryshme politike dhe kulturore; (ii) shteti është garantuesi përfundimtar i pluralizmit, veçanërisht sa i përket mediave audiovizuale, programet e të cilave zakonisht transmetohen gjerësisht; (iii) zhvillimi në fushën e shërbimeve të reja të komunikimit mund të çojë në krijimin e pozitës dominuese në treg dhe se sa i përket transmetimit digjital, shteteve u kërkohet të krijojnë rregulla sa i përket qasjes në sistem dhe shërbime, të cilat janë të drejta, transparente dhe jodiskriminuese; (iv) vlerësimi i masës së koncentrimit që bazohet në ndarjen e kanaleve apo programeve, nuk mund të jetë e dobishme për të përcaktuar pozicionin e një kompanie në radion nacionale apo tregun televiziv (shih [Përmbledhjen e Opinioneve të Komisionit të Venecias përkitazi me Lirinë e Shprehjes dhe Mediat](#), CDL-PI(2020)008, faqet 7, 18, 19 dhe 20.).
132. Për më tepër, Gjykata rikujton edhe njëherë Aktgjykimin e saj në rastin KO134/21, i cili “*vë theks në rëndësinë e pavarësisë së transmetuesit publik, por edhe detyrimet pozitive të shtetit, përkatësisht Republikës së Kosovës, për të mbrojtur dhe garantuar lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe të gjitha garancitë që burojnë nga të drejtat kushtetuese të përcaktuara në kontekst të lirisë së shprehjes dhe të mediave, përfshirë siç është interpretuar nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përcaktuar nga instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.*” (shih rastin e Gjykatës KO134/21, cituar më lart, paragrafi 177).

Fushëveprimi i Ligjit të kontestuar

133. Gjykata rikujton se Ligji i kontestuar (i) ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të KPM-së me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shërbimeve audiovizuele, që u shërben të gjithë qytetarëve; (ii) ndër kompetencat e KPM-së të përcaktuara në nenin 4 (Kompetencat e KPM-së) përfshihen: (a) lëshimi i lejeve për ofruesit e shërbimeve audio, audiovizuele, platformat për shpërndarjen e videove, operatorët e shpërndarjes, operatorët e rrjetit dhe operatorët e multipleksit, të definuara sipas nenit 3 (Përkufizimet) të Ligjit të kontestuar; (b) mbajtja dhe përditësimi i regjistrit të shërbimeve mediale-audiovizuele online; (c) emërimi i Kryeshefit të Zyrës Ekzekutive; (d) nxjerrja e rregullores për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës; (e) themelimi i Këshillit të Ankesave që trajton ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit; dhe (f) shqiptimi i sanksioneve. Ligji i kontestuar po ashtu (iii) përcakton në nenin 7 (Pavarësia e KPM-së), KPM-në si institucion që gëzon pavarësi organizative, administrative, funksionale dhe financiare në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tij. Në nenin 10 (Edukimi medial), Ligji i kontestuar përcakton se (iv) KPM përgatit materiale tekstuale, animacione, video dhe forma tjera të komunikimit për të promovuar edukimin medial, duke detyruar transmetuesin publik dhe kanalet tjera gjeneraliste që të transmetojnë materiale të edukimit medial dhe të shfaqin emisione dhe debate në funksion të edukimit medial, në intervale të caktuara. Po ashtu (v) neni 12 (Politika e transmetimit) i Ligjit të kontestuar përmban dispozita sipas së cilave, ndër tjera, aty ku është e mundur dhe me mjetet e duhura, që transmetuesit rezervojnë të paktën dhjetë përqind (10%) të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping, ose me radhë, të paktën dhjetë përqind (10%) të buxhetit të tyre programor për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit. Për më tepër, sipas neneve 14 (Përbërja e KPM), 15 (zgjedhja e anëtarëve të KPM-së), 17 (Mandati i Kryetarit dhe anëtarët e KPM-së) dhe 18 (Shkarkimi i anëtarëve të KPM-së) të Ligjit të kontestuar, (vi) KPM përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë; (vii) përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës, përderisa zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore; (viii) anëtarët dhe kryetari i KPM-së zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të deputetëve të tij, që janë të pranishëm dhe që votojnë, pas rekomandimit të Komisionit përkatës për media të Kuvendit; (ix) Kryetari dhe anëtarët e KPM-së zgjedhen me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër, por përjashtimisht nëse kryetari dhe anëtarët e rinj nuk kanë mundur të zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj, kryetari dhe anëtarët e KPM-së të cilëve u ka skaduar mandati vazhdojnë të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe anëtarëve të rinj nga Kuvendi; (x) Kryetari dhe anëtari i KPM-së shkarkohet nga detyra me shumicë të thjeshtë të votave kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për shkarkim, pasi propozimi për shkarkim nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për media; (xi) bazat për shkarkim, ndër tjera, përfshijnë marrjen pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje, dhe humbjen e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM. Ndërsa, (xii) neni 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve) obligon të licencuarit/regjistruarit që për ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të marrin aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja, dhe që një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotëroj më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar /regjistruar tjetër; dhe (xiii) neni 60 (Sanksionet dhe gjobat) përcakton veprimet që ngërthejnë sanksione dhe shumën e gjobave për personat fizikë dhe juridikë, duke përcaktuar kufirin e poshtëm dhe të epërm të gjobave dhe kushtet sipas së cilave gjobat mund të dyfishohen.

Pretendimet e parashtguesve të kërkesës dhe argumentet/kundërgargumentet e palëve të interesuara

134. Gjykata thekson se thelbi i pretendimeve të parashtguesve të kërkesave, ndërlidhet me konsultimet publike përkitazi me Ligjin e kontestuar, cenimin e pavarësisë kushtetuese të KPM-së, cenimin e lirisë së medieeve, cenimin e të drejtës për mjet juridik ndaj vendimeve të KPM-së, dhe kolizionin e të njëjtit me ligje të tjera, sepse Ligji i kontestuar, sipas parashtguesve të kërkesave, ndër të tjera: (i) është aprovuar në mungesë të konsultimeve publike dhe gjithëpërfshirjes gjatë procesit të draftimit, duke cenuar kështu parimet themelore kushtetuese të transparencës dhe demokracisë; (ii) cenon të të drejtën për mjete juridike ndaj vendimeve të KPM-së të përcaktuar me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, pasi duke kaluar kompetencën e zgjedhjes së Bordit të Ankesave nga Kuvendi, siç ishte me Ligjin aktual, tek vet KPM ashtu siç përcaktohet, sipas tyre, në paragrafin 2.21 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, ka ngritur dyshime lidhur me pavarësinë dhe anshmërinë e Bordit të Ankesave dhe, për më tepër, i njëjti nuk përcakton në mënyrë shprehimore se ndaj vendimeve të Bordit të Ankesave lejohet mbrojtje gjyqësore; (iii) në kundërshtim me lirinë e medieeve të garantuar me nenin 42 të Kushtetutës, Ligji i kontestuar përmes neneve 10 dhe 12 detyron transmetuesin publik dhe të gjitha kanalet gjeneralistike të transmetojnë materiale të edukimit medial dhe të rezervojnë një përqindje të kohës së transmetimit dhe një përqindje të buxhetit të tyre për *“veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesi”*; (iv) zgjedhja, mandati, përbërja dhe mënyra e shkarkimit të anëtarëve të KPM-së e përcaktuar përmes neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar cenojnë pavarësinë e KPM-së të garantuar me nenin 141 të Kushtetutës, parimin e barazisë gjinore të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, dhe parimin e sundimit të ligjit të garantuar me nenin 7 të Kushtetutës; (v) neni 43 i Ligjit të kontestuar që rregullon pronësinë e të regjistruarve dhe mënyrën e transferimit të pronësisë kërkon aprovimin e KPM-së, nëse ndryshimi i pronësisë kalon dhjetë përqind (10%) të vlerës së aksioneve, si dhe ndalon që një subjekt tjetër i licencuar të zotërojë më tepër se dhjetë përqind (10%) të aksioneve, në një subjekt tjetër të licencuar, duke cenuar kështu lirinë e medieeve të garantuar me nenin 42 të Kushtetutës dhe të drejtën për veprimtari ekonomike të garantuar përmes nenit 119 të Kushtetutës; dhe (vi) neni 60 i Ligjit të kontestuar që përcakton sanksionet dhe gjobat përkitazi me shkeljen e dispozitave të Ligjit të kontestuar, është në kolizion me nenin 29 (Sanksioni kundërvajtës me gjobë) të Ligjit për Kundërvajtje.
135. Gjykata rikujton që parashtguesit e kërkesës në rastin KO152/24, kërkojnë nga Gjykata që të shpall nenet 4, 10, 12, 15, 17, 18, 43 dhe 60 të Ligjit të kontestuar në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa parashtguesit e kërkesës në rastin KO158/24 kërkojnë shfuqizimin e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij, por duke paraqitur argumente konkrete përkitazi me procedurën e ndjekur për miratimin e ligjit dhe lidhur me nenet 4, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar. Pretendimet e lartcekura mbështeten edhe nga Avokati i Popullit dhe AGK, ndërsa kundërshtohen nga Qeveria.
136. Gjykata rikujton po ashtu se përkitazi me Ligjin e kontestuar gjatë procesit të draftimit, ishin parashtruar komente nga organizata të ndryshme, përfshirë organizatat ndërkombëtare. Në këtë kontekst, dokumentacioni i dorëzuar në Gjykatë përmban edhe një opinion ligjor përkitazi me Ligjin e kontestuar të Divizionit për Bashkëpunim sa i përket Lirisë e Shprehjes të Këshillit të Evropës, i 24 majit 2024, i draftuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Opinioni i lartcekur, i cili përmban referenca edhe në komentet e organizatave tjera, siç është Misioni i OSBE-së në Kosovë, dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, përkitazi me Ligjin e kontestuar, ndër

të tjera, thekson: (i) Projektligji, përgjithësisht, është në harmoni me Direktivën e Bashkimit Evropian për Media Audiovizuale. Megjithatë, i njëjti ngre disa çështje sa i përket (ii) qartësisht të qëllimit të Ligjit; (iii) qartësisht të obligimit të shërbimeve të medieve audiovizuale për të mbrojtur fëmijët dhe për të siguruar përmbajtje të qasshme për personat me nevoja të veçanta; (iv) eliminimin e definicionit të “*shërbimeve mediale audiovizuale online*” për hir të qartësisë; (v) caktimit të sanksioneve proporcionale, sidomos përkitazi me qartësinë e sanksionit për “*shkeljet e përcaktuara me këtë Ligj*”; (vi) qartësimi i kompetencave të KPM-së dhe forcimi i pavarësisë; (vii) forcimi i transparencës sa i përket pronësisë së mediave; (viii) adresimin e çështjes së dezinformimit dhe promovimit të edukimit medial; dhe (ix) promovimin e vetërregullimit dhe bashkë-rregullimit.

137. Thënë këtë, (i) marrë parasysh pretendimet dhe argumentet respektive të parashtruesve të kërkesave si dhe përgjigjet e palëve të interesuara; dhe (ii) ndërlihdjen e neneve respektive me njëri-tjetrin, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, do të vlerësojë (i) pretendimet e parashtruesve sa i përket procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar; si dhe nenet e Ligjit të kontestuar, si në vijim: (ii) nenet 14, 15, 17 dhe 18 sipas së cilave (a) Kuvendi zgjedh anëtarët e KPM-së me shumicë të thjeshtë të votave, bazuar në rekomandimet e Komisionit përkatës për media të Kuvendit; (b) zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së “*reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore*”; (c) Ligji i kontestuar ka krijuar mundësinë për zgjatjen e mandatit deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, pavarësisht se mandati i anëtarëve të KPM-së është katër (4) vjet me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat; (d) anëtarët e KPM-së shkarkohen me shumicë të votave, ndër të tjera, për shkak të humbjes së besimit, përfshirë duke u bazuar në kriterin e “*integritetit të cenuar*”; (iii) nenin 4 (Kompetencat e KPM-së), përkatësisht paragrafin 2.21 të këtij neni që përcakton se KPM themelon Këshillin e Ankesave që trajton ankesat në përputhje me Ligjin e kontestuar dhe aktet nënligjore; (iv) nenet 10 (Edukimi medial) dhe 12 (Politika e transmetimit) që përcaktojnë se Transmetuesi publik dhe kanalet gjeneraliste obligohen që të transmetojnë disa minuta në javë, përkatësisht në muaj materialet mediale të përgatitura nga KPM, si dhe që transmetuesit të rezervojnë një përqindje të transmetimit dhe buxhetit për veprat evropiane të krijuara nga producentë të pavarur nga transmetuesit; (v) nenin 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarave/regjistruarave) të Ligjit të kontestuar që obligon të licencuarit/regjistruarit që për ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të marrin aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja, dhe që përcakton se një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotëroj më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar /regjistruar tjetër; dhe (vi) nenin 60 (Sanksionet dhe gjobë) i Ligjit të kontestuar masat ndëshkuese për personat fizikë dhe juridikë në rast të shkeljes së ligjit, përfshirë mundësinë për dyfishimin e sanksionit nëse plotësohen kushtet e caktuara. Gjykata gjithashtu, do të vlerësojë argumentet dhe kundërgargumentet e palëve për aq sa ato ndërlihdhen me pretendimet e parashtruesve të kërkesave, si palë të autorizuar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Si rrjedhojë, kjo e fundit përmes kërkesave aktuale nuk është e autorizuar të vlerësojë pretendimet e palëve të interesuara përkitazi me kushtetutshmërinë e dispozitave të Ligjit të kontestuar, të cilat nuk janë kontestuar nga palët e autorizuar sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
138. Gjykata më tej thekson se me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të kontestuar të Ligjit të kontestuar, kjo e fundit për secilin pretendim, për aq sa janë relevante, do të përmbledhë: (i) pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe kundërgargumentet e palëve; (ii) parimet e përgjithshme siç janë të saktësuara me Kushtetutë dhe të sqaruara më tej përmes praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-

së, si dhe parimet e përgjithshme ndërkombëtare dhe praktikën e vendeve tjera aty ku kjo është relevante; si dhe (iii) do të zbatohet të njëjtat në rastin konkret.

I. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës për miratimin e Ligjit të kontestuar

139. Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesave kontestojnë procedurën e ndjekur për miratimin e ligjit duke theksuar se gjatë hartimit të Ligjit të kontestuar nuk kishte konsultime publike të mjaftueshme për të përfshirë mediat, gazetarët, qytetarët dhe grupet e interesit që ndikohen direkt nga Ligji i kontestuar. Për më tepër, ata pretendojnë se përkitazi me Ligjin e kontestuar Komisioni funksional i Kuvendit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal *“organizoi konsultime publike vetëm 3 ditë”* përkatësisht nga 21 marsi 2024 deri më 25 mars 2024, me ç’ rast dy (2) nga këto ditë, ishin ditë vikendi. Lidhur me këtë ata nuk saktësojnë ndonjë nen të Kushtetutës, i cili mund të jetë shkelur si rezultat i kësaj, por theksojnë se me këtë është cenuar *“rëndë transparenca dhe demokracia si parime themelore kushtetuese në vendimarrje për çështje me interes publik”*. Këto pretendime mbështeten nga AGK, sipas së cilës, ndër të tjera, (i) megjithëse konsultimi publik në kuadër të Qeverisë përkitazi me Ligjin e kontestuar ka qenë i hapur nga 15 nëntori 2021 deri më 3 dhjetor 2021, në faqen e dokumentacionit përcjellës *“nuk ka informatë tjetër lidhur me kontributet e dorëzuara”* përderisa për projektligjet tjera të njëjtat figurojnë; (ii) drafti i projektligjit i hedhur për konsultim publik ndryshon thellësisht nga versioni i miratuar në Qeveri, ku përfshihen edhe dispozitat që kontestohen nga parashtuesit e kërkesave, përfshirë ato që ndërlidhen me zgjedhjen e kryesuesit të KPM-së, si dhe nuk është e qartë për cilin version është lëshuar Opinion Ligjor për Përputhshmëri me legjislacionin e BE-së. Këto pretendime kundërshtohen nga Qeveria, me arsyetimin se (i) pas konsultimeve publike të mbajtura nga 15 nëntori 2021 deri më 3 dhjetor 2021, është zhvilluar edhe procedura e diskutimit publik më 25 nëntor 2021 dhe më 6 dhe 7 shtator 2022, tryezë me ekspertët e Bashkimit Evropian dhe palët e interesit; ndërsa (ii) në nivel të Kuvendit, përkitazi me Ligjin e kontestuar Komisioni përgjegjës i Kuvendit ka organizuar gjithashtu diskutime publike në shtatë (7) rajone kryesore të vendit, dhe i njëjti ka mbajtur një dëgjim publik.
140. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht thekson se neni 3 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, përcakton se: *“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumëtnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore”*; ndërsa paragrafi 1 i nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], përcakton që *“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.”*
141. Për më tepër, paragrafi 1 i nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës përcakton se: *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”*
142. Për sa i përket dispozitave kushtetuese që rregullojnë çështjen e ligjbërjes në Kuvend, Gjykata vë në pah dispozitat kushtetuese, respektivisht, (i) nenin 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe*

mënyrën e punës së Kuvendit.”; dhe (ii) nenin 77 [Komisionet] të Kushtetutës, i cili përcakton se: “1. Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc [...] 4. Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit”, si dhe (iii) nenin 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës, i cili përcakton se: “1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit [...] 2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.”

143. Gjykata gjithashtu vë në pah faktin që ushtrimi i pushtetit legjislativ është funksioni më thelbësor i Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar në nenet 4 [Forma e qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Këtë funksion i njëjti, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, e ushtron sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 79 [Nisma Legjislative] dhe nenin 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, ndërsa deputetët ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, siç është saktësuar në nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës. Për më tepër, Kushtetuta u përcakton rol të veçantë Komisioneve të Kuvendit, me theks, në procesin e ligjërjes. Më saktësisht dhe në këtë kontekst, e njëjta në nenin 77 [Komisionet] të saj, përcakton kategoritë e komisioneve, duke i klasifikuar në të përhershme, funksionale dhe *ad hoc*, duke vënë theks në rëndësinë e përbërjes së tyre, përfshirë rolin e komuniteteve joshumicë dhe duke deleguar rolin dhe procedurat përkatëse për t’u rregulluar më tej në nivel të Rregullores së Kuvendit.
144. Gjykata gjithashtu, thekson se bazuar në nenin 99 [Procedurat] të Kushtetutës, që përcakton se “*Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri rregullohen me ligj dhe me rregullore.*” Në kontekst të kësaj të fundit dhe që ndërlidhet me pretendimet specifike të parashtruesve të kërkesës, Gjykata sa i përket mbarëvajtjes së procesit të konsultimeve, vëren që paragrafi 1 i nenit 7 [Konsultimi paraprak] të Rregullores 09/2011 e Punës së Qeverisë (e zbatueshme në kohën kur Ligji i kontestuar ka qenë në shqyrtim në Qeveri), përcaktonte që “*Para dorëzimit për shqyrtim në Qeveri, nga organi propozues ose nga një trup qeveritar, të koncept dokumenteve, memorandumeve shpjeguese, apo projekt aktet ligjore dhe nënligjore, planeve strategjike të ministrive ose strategji sektoriale, Organi i cili ka përgatitur materialin (“organi propozues”) është përgjegjës për të siguruar që të gjitha organet e larta të administratës shtetërore, organet qendrore të administratës shtetërore, organet e pavarura të administratës shtetërore dhe organet tjera relevante, me të cilat qeveria është e obliguar të konsultohet në pajtim me Kushtetutën, apo puna e të cilave mund të ndikohet nga propozimi përkatës (projektligji, akti nënligjor apo politika), të kenë mundësi të komentojnë lidhur me propozimin.* [...]”
145. Gjykata po ashtu i referohet edhe paragrafit 1 të nenit 32 (Konsultimet publike) të Rregullores së lartcekur sipas së cilit, “*Gjatë përgatitjes së propozimeve për të cilat kërkohet koncept dokumenti, përveç konsultimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës publike sipas nenit 7 të kësaj rregullore, organi propozues duhet të publikojë përmbajtjen e propozimit të saj për komente nga publiku dhe në mënyrë specifike do të kërkojë komente nga organizatat jo-qeveritare të cilat ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga propozimi.*”

146. Ndërsa, sa i përket procesit legjislativ në Kuvend, Gjykata i referohet nenit 39 (Dëgjimi publik legjislativ) të Rregullores së Punës së Kuvendit që rregullon çështjen e dëgjimeve publike brenda komisioneve parlamentare, ku ndër të tjera përcaktohet se (i) dëgjimi publik legjislativ organizohet për mbledhjen e informacioneve, vërejtjeve dhe rekomandimeve për projektligjet dhe çështjet tjera që janë në procedurë të shqyrtimit nga komisioni; (ii) dëgjimi publik organizohet në mes të leximit të parë dhe leximit të dytë, për t'i mundësuar publikut të gjerë, përfshirë pjesëtarët e shoqërisë civile, komunitetin e biznesit, botën akademike dhe grupet e tjera të interesit që të paraqesin para Komisionit çështjet me interes për ta dhe grupet që i përfaqësojnë brenda fushëveprimit të projektligjit përkatës; dhe (iii) dëgjimi publik mbahet në ambientet e selisë së Kuvendit, apo edhe në ambiente tjera jashtë selisë së Kuvendit, nëse vlerësohet që mundëson pjesëmarrje më të gjerë të publikut.
147. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në rregullat e lartcekura, por edhe parimet relevante të ligjbërjes, legjislacioni duhet t'i nënshtrohet konsultimeve publike dhe se gjatë procesit legjislativ duhet të krijohet mundësia që palët e interesit të paraqesin pikëpamjet e tyre përkitazi me legjislacionin në fjalë. Për më tepër, Gjykata thekson se kjo nuk kërkon vetëm plotësimin e aspekteve formale për konsultime publike, por konsultimet duhet të përfshijnë debat përmbajtësor përkitazi me të gjitha aspektet e një nisme ligjore. Gjithashtu një obligim i tillë është evidentuar edhe në Raportin e vitit 2023 për Kosovën të Komisionit Evropian, i cili vë theksin në faktin që procesi për draftimin e Ligjit të KPM-së duhet jetë transparent dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë mediat dhe shoqërinë civile. Po ashtu, Komisioni i Venecias vë theksin në kontributin e jashtëm sa i përket procesit të ligjbërës duke potencuar se kjo mund të bëhet, ndër të tjera përmes konsultimeve publike nëpërmjet të cilave publiku mund të adresoj propozime dhe komente me shkrim apo mënyra të tjera (shih [Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias përkitazi me procedurat ligjbërëse dhe kualitetin e ligjit](#), CDL-PI(2021)003, të aprovuar në Sesionin e 126-të plenar të Komisionit të Venecias, të 19-20 marsit 2021, faqe 16-17).
148. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se Kushtetuta ka përcaktuar procedurat për miratimin e ligjeve në Kuvend përfshirë çështjen e funksionimit të komisioneve parlamentare, por duke deleguar çështjet e organizimit të mëtejme të procedurave legislative, përfshirë çështjen e konsultimeve publike, që nuk janë të rregulluara me Kushtetutë në nivel të akteve tjera, përfshirë Rregulloren e punës së Qeverisë dhe atë të Kuvendit.
149. Megjithatë, përderisa paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton se dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur, Gjykata është e autorizuar që të vlerësojë respektimin e procedurës për miratimin e një ligji ashtu siç përcaktohet në Kushtetutë. Një qëndrim të tillë të vlerësimit të procedurës legislative bazuar në normat kushtetuese, Gjykata e ka ndjekur edhe në praktikën e saj të mëhershme gjyqësore (shih rastet e Gjykatës, parashtrues: për kërkesën KO216/22 - *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë*, dhe për KO220/22 *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, Aktgjykimi i 2 gushtit 2023, paragrafët 201-214). Për aq sa, argumentet e parashtruara të palëve nuk argumentojnë cenimin e procedurave të përcaktuara me Kushtetutë, Gjykata, sipas praktikës së saj gjyqësore, nuk ka shpallur ligje të kontestuara, në kundërshtim me Kushtetutën në aspekt procedural.
150. Megjithatë, bazuar në materialet e pranuar nga Kuvendi rezulton se Ligji i kontestuar ka kaluar procedurat parlamentare, duke u shqyrtuar nëpër komisionet relevante të Kuvendit.

Kjo pasi, më 11 janar 2024, Projektligji për KPM-në, së bashku me shkresat përcjellëse, përfshirë Memorandumin Shpjegues dhe listën me komente nga institucionet e administratës publike dhe organizatave të shoqërisë civile përkitazi me Projektligjin e KPM-së, u procedua në Kuvend për shqyrtim parlamentar. Më 15 janar 2024, Kryetari i Kuvendit ngarkoi Komisionin funksional, që të shqyrtojë Projektligjin për KPM-në dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime. Më 7 shkurt 2024, Komisioni funksional, pas shqyrtimit të parë të Projektligjit për KPM-në, Kuvendit i rekomandoi miratimin e të njëjtit në parim. Më 7 mars 2024, Kuvendi, pas shqyrtimit të parë, miratoi në parim Projektligjin për KPM-në. Kuvendi, ngarkoi komisionet e përhershme, që të shqyrtojnë Projektligjin për KPM-në dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandimet e tyre. Ndërmjet 5 qershorit 2024 dhe 19 qershorit 2024, komisionet e përhershme dorëzuan raportet e tyre në lidhje me Projektligjin për KPM-në. Më 21 qershor 2024, Komisioni funksional pas shqyrtimit të Projektligjit për KPM-në, miratoi Raportin me rekomandime. Raporti përfundimtar i Komisionit funksional, së bashku me amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit, me rekomandimin që Projektligji për KPM-në, bashkë me amendamentet e propozuara, të miratohet. Më 11 korrik 2024, Kuvendi, pas shqyrtimit të dytë, e miratoi Ligjin e kontestuar.

151. Për më tepër, Gjykata vëren se gjatë procedurës së shqyrtimit të Ligjit të kontestuar, komente përkitazi me draftin e Ligjit të kontestuar kanë paraqitur, ndër të tjera, Zyra e Bashkimit Evropian, OSBE, KPM, dhe organizata tjera. Gjithashtu, sipas komenteve të pranuar nga Qeveria, diskutime publike përkitazi me draftin e Ligjit të kontestuar janë organizuar në shtatë (7) rajone kryesore të vendit gjatë muajit prill 2024, dhe një dëgjim publik të organizuar nga Kuvendi më 25 mars 2024. Përkitazi me diskutimin publik të organizuar në Prishtinë, theksohet se i njëjti nuk është mbajtur për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile.
152. Prandaj, bazuar në parimet kushtetuese të lartcekura, Gjykata vlerëson se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet 77 [Komisionet] 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] dhe 80 [Miratimi i Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar përkitazi me zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, përbërjen dhe përfaqësimin gjinor, si dhe mandatin dhe shkarkimin e tyre

153. Gjykata fillimisht vëren se bazuar në nenet 14 (Përbërja e KPM), 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM), 17 (Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të KPM) dhe 18 (Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së) të Ligjit të kontestuar (i) KPM përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë; (ii) përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinorë të Republikës së Kosovës përderisa përzgjedhja e Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore; (iii) Kryetari dhe anëtarët e KPM-së zgjidhen dhe shkarkohen nga Kuvendi me shumicë të votave pas rekomandimit nga Komisioni përkatës për media të Kuvendit; (iv) Kryetari dhe anëtarët e KPM-së zgjedhen me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat dhe përjashtimisht, sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin e kontestuar, të njëjtit mund të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj; dhe (v) anëtarët e KPM-së mund të shkarkohen, ndër të tjera, nëse kanë marrë pjesë në një proces “vendimmarrje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje”; ose

për “humbje të besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM”.

A. Pretendimet dhe kundërargumentet e palëve

154. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave pretendojnë se zgjedhja, mandati, përbërja dhe mënyra e shkarkimit të anëtarëve të KPM-së, e përcaktuar përmes neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të kontestuar cenojnë pavarësinë e KPM-së të garantuar me nenin 141 të Kushtetutës, parimin e barazisë gjinore të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, dhe parimin e sundimit të ligjit të garantuar me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës. Kjo për faktin se, sipas tyre (a) Kuvendi zgjedh anëtarët e KPM-së me shumicë të thjeshtë të votave, duke krijuar kontroll të drejtpërdrejtë të KPM-së nga shumica parlamentare, përfshirë faktin që Kryetari zgjidhet drejtpërdrejtë nga Kuvendi; (b) zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së minon përfaqësimin gjinor pasi nuk përcakton kuotat gjinore, siç përcakton Ligji aktual në fuqi i KPM-së, por Ligji i kontestuar vetëm bën referencë në *“legjislacionit përkatës për barazi gjinore”*; (c) pavarësisht se mandati i anëtarëve të KPM-së është katër (4) vjet me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat, Ligji i kontestuar ka krijuar mundësinë për zgjatjen e mandatit deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj në shpërputhje të plotë me konceptin e mandatit të kufizuar kohor të përcaktuar me Ligjin e kontestuar dhe me standardet kushtetuese të institucioneve të pavarura; (d) anëtarët e KPM-së shkarkohen me shumicë të thjeshtë të votave dhe për më tepër që, në Ligjin e kontestuar nuk janë përcaktuar kriteret për shkarkim të Kryetarit të KPM-së, përderisa anëtarët, ndër të tjera, mund të shkarkohen për shkak të humbjes së besimit dhe bazuar në kriterin e *“integritetit të cenuar”*.
155. Pretendimet e parashtruesve të kërkesave përkitazi me shkarkimin e anëtarëve të KPM-së mbështeten nga Avokati i Popullit i cili, ndër të tjera, thekson se (i) shkarkimi me shumicë të thjeshtë i anëtarëve të KPM-së mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e pavarur të kësaj të fundit; (ii) Ligji i kontestuar përbën trajtim të pabarabartë ndërmjet kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së sepse nuk përcakton qartë kriteret në bazë të të cilave shkarkohet kryetari i KPM-së dhe e bënë Kryetarin të mos ketë përgjegjësi për veprimet e veta; (iii) kushtet për shkarkim të anëtarëve të KPM-së janë të paqarta sepse nuk përcaktohet organi që vlerëson paaftësinë profesionale dhe se kriteret e përcaktuara për shkarkim mund të vendosin në pasiguri juridike anëtarët e KPM-së dhe mundësojnë ndërhyrjet politike. Komentet e parashtruesve të kërkesave po ashtu mbështeten edhe nga AGK, duke theksuar se dispozitat e Ligjit të kontestuar përkitazi me numrin e anëtarëve, mandatin, shkarkimin e kryetarit të KPM-së cenojnë pavarësinë kushtetuese të KPM-së të garantuar me nenin 141 të Kushtetutës, sepse, ndër të tjera, (i) për dallim nga Ligji aktual në fuqi për KPM-në, kryetarin e KPM-së e zgjedh vet Kuvendi duke ia marrë të drejtën anëtarëve të KPM-së që të menaxhojnë me organizmin dhe funksionimin e këtij institucioni; (ii) Ligji i kontestuar rrit numrin e anëtarëve nga shtatë (7) sa janë aktualisht, në njëmbëdhjetë (11) anëtarë dhe arsyet për këtë nuk janë të qarta; (iii) mundësia e zgjatjes së mandatit të Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, përtej afatit katër (4) vjeçar nëse kryetari/anëtarët e rinj nuk mund të zgjedhën bien ndesh me parimin e mandatit të kufizuar për poste publike, dhe sipas këtij rregullimi anëtarët e KPM-së mund të vazhdojnë mandatin pafundësisht, duke krijuar *“vartësi”* dhe *“vartësi”* ndaj Kuvendit; (iv) Ligji kontestuar nuk ia njeh të drejtën KPM-së që të propozoj shkarkimin e anëtarëve të KPM-së, por ekskluzivisht komisionit relevant të Kuvendit, përderisa kriteri për shkarkim nëse kryetari ose anëtari i KPM-së *“humbet besimin nga organi mbikëqyrës”* krijon *“ndërhyrje”* kundërkushtetuese në pavarësinë e KPM-së që rezulton në *“varësi”* dhe *“vartësi”* të KPM-së ndaj Kuvendit, si dhe krijon ndërhyrje direkte në vendimmarrjen e KPM-së, është kriter

subjektiv, dhe për më tepër i mungon qartësia dhe parashikueshmëria; dhe (v) Ligji i kontestuar ka eliminuar tërësisht përfaqësimin obligativ të të paktën dy (2) grave në përbërjen e KPM-së, siç është përcaktuar me Ligjin aktual, pasi Ligji i kontestuar vetëm i referohet “*legjislacionit përkatës për barazi gjinore*” pa përcaktuar kuota specifike, duke cenuar kështu nenin 7 të Kushtetutës.

156. Në anën tjetër, pretendimet e parashtresve të kërkesave kundërshtohen nga Qeveria, me arsyetimin se (i) Kryetari i KPM-së është i barabartë me anëtarët e KPM-së, zgjedhja e tij nga Kuvendi nuk është e ndaluar nga Kushtetuta dhe është në përputhje me praktikën e institucioneve tjera, siç është Organi Shqyrtues i Prokurimit apo Autoriteti i Konkurrencës; (ii) mundësia e vazhdimit të mandatit të anëtarëve të KPM-së deri në zgjedhjen e anëtarëve tjerë është bërë për të pamundësuar zbrazëtitrat që mund të rezultojnë në rast se rrethanat pamundësojnë përzgjedhjen e anëtarëve të rinj në kohë; (iii) përveç në rastet kur shprehimisht përcaktohet me Kushtetutë një shumicë më e lartë e zgjedhjes së funksionarëve publikë siç janë Avokati i Popullit, Presidenti i Republikës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, zgjedhja e anëtarëve të KPM-së rregullohet me ligj dhe ashtu siç bëhet emërimi, me të njëjtën shumicë bëhet shkarkimi; (iv) Kryetari i KPM-së është i barabartë me anëtarët tjerë dhe çdo rregull që vlen për anëtarët e KPM-së zbatohet edhe për Kryetarin, përfshirë shkarkimin; (v) çështja e integritetit nuk mund të përkufizohet përmes kuantitetit, por ajo është subjekt i vlerësimit të Komisionit mbikëqyrës parlamentar dhe pavarësisht kësaj, anëtari i KPM-së mund të shkarkohet vetëm nëse për këtë voton shumica e deputetëve të Kuvendit.
157. Në vijim të pretendimeve të parashtresve të kërkesës, Gjykata do të vijojë me elaborimin dhe vlerësimin e pretendimeve të lartcekura, e që në thelb ndërlidhen me pavarësinë e KPM-së dhe lirinë e medieve, duke elaboruar dhe vlerësuar nëse, (i) mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të KPM-së nga Kuvendi cenon pavarësinë e KPM-së të garantuar me Kushtetutë; (ii) përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin gjinor të Kosovës; (iii) Kryetari dhe anëtarët e KPM-së që ju ka përfunduar mandati mund të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj; dhe nëse (iv) anëtarët e KPM-së mund të shkarkohen, për arsye të përcaktuara në Ligjin e kontestuar, përfshirë “*humbjen e besimit nga organi mbikëqyrës*”.

1. Në lidhje me mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të KPM-së

A. Parimet e përgjithshme që ndërlidhen me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese në Kapitullin XII të Kushtetutës

158. Gjykata fillimisht rikujton dispozitat relevante kushtetuese lidhur me parimin e ndarjes së pushteteve, gjegjësisht nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] të Kushtetutës, ndërsa sa i përket pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, Gjykata i referohet dispozitave kushtetuese për institucionet e pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], gjegjësisht në nenet 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave], si dhe përkitazi me Gjykatën siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.
159. Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, ka sqaruar se: “[...] neni 4 i Kushtetutës dhe i cili përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, mes tjerash saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e

balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës [...]” (shih rastet e Gjykatës, [KO100/22 dhe KO101/22](#), cituar më lart, paragrafi 154; dhe rastin KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 240.)

160. Gjykata ka konsoliduar praktikën e saj gjyqësore mbi parimet përkitazi me ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, përmes aktgjykimeve që përfshijnë por nuk kufizohen në (i) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO73/16](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës; (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO171/18](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; (iii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO203/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët publikë; (iv) Aktgjykimin në rastin [KO219/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik; (v) Aktgjykimin në rastin [KO127/21](#), me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-29 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; dhe (vi) Aktgjykimin në rastin e Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), me parashtrues të kërkesës KO100/22, *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; dhe të kërkesës KO101/22, *Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastet KO100/22 dhe KO101/22).
161. Nga aktgjykimet e lartcekura rezulton se: (i) ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë, mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, është “*ndarja e pushteteve*”; (ii) funksionimi i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit të balancit në mes tyre; (iii) të tri pushtetet e pavarura të përcaktuara me Kushtetutë, përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve dhe se raporti në mes tyre mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit të balancimit në mes tyre; (iv) secili nga pushtetet, përfshirë edhe institucionet e pavarura, janë të rregulluara në kapituj të veçantë kushtetues dhe secili prej këtyre kapitujve përcakton parimet e përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre, që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra-tjetrën, pa krijuar ndonjë “*ndërhyrje*”, “*varësi*” apo “*vartësi*” kundërkushtetuese në mes tyre, që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo tjetrit pushtet; (v) përveç tri pushteteve klasike, vend të veçantë në sistemin e ndarjes së pushteteve ka edhe Gjykata Kushtetuese, si institucion përgjegjës për garantimin përfundimtar të kushtetutshmërisë në nivel vendi, Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit

demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës; dhe në fund, (vi) ndarja e pushteteve si parim themelor i nivelit më të lartë kushtetues, është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë, është i panegociueshëm (shih rastet e Gjykatës, [KO100/22 dhe KO101/22](#), cituar më lart, paragrafi 158; dhe KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 243).

162. Gjykata vëren se KPM përfshihet në Kapitullin XII të Kushtetutës, së bashku me institucionet e tjera, përkatësisht Avokatin e Popullit; Auditorin e Përgjithshëm; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; dhe Bankën Qendrore e Kosovës.
163. Sa i përket KPM-së, Gjykata i referohet nenit 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës në paragrafin 1 të tij që përcakton se Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur; duke mandatuar të njëjtin që të (i) rregullojë spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës (ii) licencojë transmetuesit publikë dhe privatë; (iii) përcaktojë dhe zbaton politikën e transmetimit; si dhe (iv) ushtrojë kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.
164. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 2 të nenit 141 të Kushtetutës që përcakton se anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjidhen sipas ligjit, në bazë të një procesi transparent.
165. Rrjedhimisht, Gjykata përsërit se neni i lartcekur i Kushtetutës (i) përcakton KPM-në si organ të pavarur; (ii) që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës; (iii) licencën transmetuesit publikë dhe privatë; (iv) përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit. Përderisa neni 141 i Kushtetutës përcakton rregullimin në nivel ligji të kompetencave të tjera të KPM-së dhe zgjedhjen e anëtarëve të KPM-së, me kushtin që procesi për zgjedhjen e tyre të jetë transparent. Neni 141 i Kushtetutës po ashtu nuk përcakton as çështjen e zgjedhjes së Kryetarit dhe mandatit të anëtarëve të KPM-së dhe as mënyrën e shkarkimit të tyre, duke lënë këtë çështje që të rregullohet në nivel ligji, gjithsesi, me kushtin e ruajtjes së pavarësisë së këtij institucioni të përcaktuar me Kushtetutë.

B. Parimet e Këshillit të Evropës dhe ato të Komisionit të Venecias lidhur me komisionin e medieve

166. Lidhur me standardet ndërkombëtare sa i përket organeve rregullatorë të medieve, Gjykata i referohet [Rekomandimit Rec\(2000\)23](#) të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare përkitazi me *Funksionimin e Autoriteteve Rregullatore të Sektorit të Transmetimit*, i Këshillit të Evropës i 20 dhjetorit 2000.
167. Bazuar në pikën 1 të Kapitullit I (Korniza e përgjithshme ligjore), përkatësisht paragrafit 1 të rekomandimit të lartcekur, shtetet anëtare duhet të sigurojnë krijimin dhe funksionimin e papenguar të autoriteteve rregullatore të sektorit të transmetimit, duke krijuar një kornizë të duhur ligjore për këtë qëllim. Rregullat dhe procedurat që qeverisin ose ndikojnë në funksionimin e autoriteteve rregullatore duhet që në mënyrë të qartë të afirmojnë dhe mbrojnë pavarësisë e tyre. Ngjashëm bazuar në paragrafin 2 të rekomandimit të lartcekur të Këshillit të Evropës, detyrat dhe funksionet e autoriteteve rregullatore në sektorin e transmetimit dhe mënyra në të cilën ata mbahen përgjegjës, procedura për emërimin e anëtarëve dhe mënyra e financimit, duhet të përcaktohet qartë dhe me ligj.

168. Më specifikisht, ky rekomandim përmban një kapitull të veçantë, përkatësisht Kapitullin II (emërimin, përbërjes dhe funksionimit) përkitazi me zgjedhjen, përbërjen dhe funksionin e këtyre rregullatorëve. Në këtë kontekst, paragrafi 4 i Rekomandimit Rec (2000)23, përcakton se rregullat specifike duhet të përcaktohen sa i përket papërshtatshmërisë, në mënyrë që të evitohet që autoritetet rregullatore të jenë nën influencën e pushteteve politike, anëtarët e autoriteteve rregullatore të mbajnë funksione apo interesa në ndërmarrje apo organizata të tjera në medie apo sektor të ndërlidhur, e që mund të dërgojë në konflikt interesi në lidhje me përbërjen e autoriteteve rregullatore. Për më tepër, paragrafi 5 i këtij rekomandimi përcakton që rregullat duhet të garantojnë që anëtarët e këtyre autoriteteve (i) emërohen në mënyrë demokratike dhe transparente; (ii) nuk mund të marrin instruksione nga ndonjë individ apo organ; dhe (iii) të mos bëjnë asnjë deklaratë apo të ndërmarrin ndonjë veprim që mund të paragjykojë pavarësinë e funksionit të tyre dhe të mos nxjerrë asnjë përfitim prej tyre.
169. Sipas Memorandumit Sqarues të Rekomandimit (2000)23 të Këshillit të Evropës, përkatësisht në pikën 16 të këtij Memorandumi, *“rregulla të qarta duhet të përcaktohen që anëtarët e trupave rregullative nuk marrin mandat apo instruksion nga personat apo trupa dhe nuk bëjnë asnjë deklaratë apo veprim që mund të paragjykojë pavarësinë e funksionit të tyre dhe nuk marrin avantazhe nga kjo e fundit për qëllime politike.”*
170. Për më tepër, [Memorandumit Sqarues](#) sa i përket [Rekomandimit Rec \(2000\) 23](#) të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtarë përkitazi me *Funksionimin e Autoriteteve Rregullatore të Sektorit të Transmetimit*, i Këshillit të Evropës i 20 dhjetorit 2000, përkatësisht, pika 33 e këtij Memorandumi përcakton se *“Rekomandohet që brenda kornizës ligjore, autoriteti rregullator duhet të ketë kompetencë që të bëjë rregullimin e cila i mundëson atyre që të veprojnë me fleksibilitet dhe në mënyrë adekuate sa i përket pyetjeve që mund të jenë të paparashikueshme dhe që janë shpesh komplekse, pasi jo të gjitha mund të zgjidhen, apo parashikohen, nga korniza ligjore. Në fakt, konsiderohet që autoritetet rregullatore janë në pozitë më të mirë për të përcaktuar “rregullat e lojës” në detaje, pasi të njëjtat kanë njohuri të sektorit të transmetimit. Për më tepër, autoritet rregullatorë duhet, brenda kornizës ligjore, të kenë kompetencën për të nxjerr aktet të brendshme për të definuar organizmin dhe vendimmarrjen më në detaje, në pajtim me autonominë e tyre administrative.”*
171. Gjithashtu, sa i përket shkarkimit, në paragrafin 6 të rekomandimit të lartcekur, është vendosur përcaktimi i rregullave precize në lidhje me shkarkimin e anëtarëve të autoriteteve rregullatore në mënyrë që të shmanget që shkarkimi të përdoret si presion politik.
172. Sipas paragrafit 7 të rekomandimit të lartcekur, veçanërisht shkarkimi duhet të jetë i mundur vetëm në rast të mosrespektimit të rregullave të papërshtatshmërisë të cilat ata duhet t'i respektojnë ose në rast të pamundësisë të ushtrimit të funksionit të përcaktuar, pa paragjykim për mundësinë që personi në fjalë të ankohet para gjykatës ndaj shkarkimit të tij. Për më tepër, shkarkimi bazuar në arsyet që ndërlidhet apo jo me funksionin e tyre duhet të jetë i mundur në raste serioze të përcaktuara qartë në ligj, subjekt i vendimit përfundimtar gjyqësor.
173. Dhe në fund, bazuar në paragrafin 8 të rekomandimit të lartcekur, duke pasur parasysh natyrën specifike të sektorit të transmetimit dhe veçantinë e misionit të tyre, autoritetet rregullatore duhet të përfshijnë ekspertë të fushave që bien brenda kompetencave të tyre.

174. Në këtë aspekt, Gjykata u referohet edhe rastit të GJEDNJ-së, që përkitazi me pavarësinë e institucioneve rregullatore i referohet Rekomandimit Rec (2000) 23 Këshillit të Evropës i 20 dhjetorit 2000, duke theksuar: “[...] rëndësinë për shtetet që të miratojnë rregulla të detajuara që përfshijnë anëtarësimin dhe funksionin e trupave të tilla rregullatorë për të mbrojtur ndaj ndërhyrjeve politike dhe influencës” (shih rastin e GJEDNJ-së [Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë](#), nr. 13936/02, Aktgjykim i 17 shtatorit 2009, paragrafi 102).
175. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe [Opinionit Nr.980/2020 të Komisionit të Venecias CDL-AD\(2020\)013](#), të 19 qershorit 2020, përkitazi me Draft Amendamentet e Ligjit Nr.97/2013 për Shërbimet e Mediave Audiovizuale të Shqipërisë. Opinioni i lartcekur në paragrafin 34 përcakton se “edhe pse nuk ka një model evropian të organizmit të autoriteteve rregullatorë të medieve, parimi i mbizotërues është se institucioni që mbikëqyr mediat duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm: kjo duhet të reflektohet në mënyrën se si emërohen anëtarët e saj”; ndërsa në paragrafin 39 përkitazi me trupat rregullatore të mediave ky Opinion përcakton se “është e nevojshme që këto trupa të kenë përbërje pluraliste, të gëzojnë pavarësi nga partitë politike dhe bizneset e mëdha, të respektojnë procedurat e duhura dhe profesionalisht të kryejnë detyrat e reja”. Në këtë kontekst, në rastin e Shqipërisë Komisioni i Venecias kishte ngritur çështjen pavarësisë së trupës rregullatore përkundër faktit që në rastin konkret, nga shtatë (7) anëtarët e kësaj trupe, tre (3) anëtarë duhet të kishin mbështetjen e shumicës ndërsa tre (3) përfaqësonin opozitën.
176. Ndërsa, në Opinionin e Komisionit të [Venecias Nr.798/2015 për Legjislacionin e Mediave në Hungari CDL-Ad \(2015\) 015](#), të 22 qershorit 2015, Komisioni i Venecias përkitazi me shumicën e nevojshme për të zgjedhur anëtarët e trupave rregullatore të mediave, në paragrafin 64 të këtij Opinioni, përkitazi me shumicën e kualifikuar për të zgjedhur anëtarët e këshillit të mediave që ishte përcaktuar përmes ligjit të propozuar, ka theksuar se “në rrethana normale, qëllimi i detyrimit për shumicë të kualifikuar është për të siguruar mbështetje ndër partiake për një masë të caktuar apo personalitet. Megjithatë, në rastet kur kërkesa për një shumicë të kualifikuar përcaktohet me iniciativën e një grupi politik që e ka atë shumicë të kualifikuar, kjo rregull, në vend që të sigurojë pluralizëm dhe depolitizim të trupës rregullatore, në fakt “çimenton” influencën e këtij grupi brenda trupës rregullatore dhe mbron këtë influencë ndaj ndryshimeve politike.” Në rastin e Hungarisë, Komisioni i Venecias kishte theksuar se ka mënyra të ndryshme për të reduktuar, nëse jo për të larguar komplet rrezikun e politizimit. Në këtë aspekt, përmes paragrafëve 69 dhe 70 të raportit të lartcekur, ndër të tjera, ka theksuar se do të ishte ideale të gjithë anëtarët do të zgjidheshin në mënyrë që është e ndarë nga procesi politik; por nëse kjo nuk është e mundur mekanizma tjerë do të mund të zbatoheshin, siç janë, (i) reflektimi i diversitetit politik; (ii) delegimit të anëtarëve nga komuniteti i mediave dhe industrisë së mediave; dhe (iii) pjesëmarrjes së grupeve të shoqërisë civile në proces.
177. Bazuar në dispozitat e lartcekura kushtetuese, standardet për rregullatorët e sektorit të transmetimit, përfshirë opinionet e Komisionit të Venecias, rezulton se:
- (i) brenda kornizës ligjore, autoriteti rregullator duhet të ketë kompetencë që të bëjë rregullimin e cila i mundëson atyre që të veprojnë me fleksibilitet dhe në mënyrë adekuate sa i përket çështjeve që mund të jenë të paparashikueshme dhe që janë shpesh komplekse, përfshirë që të nxjerrë akte të brendshme për të definuar organizmin dhe vendimmarrjen më në detaje, në pajtim me autonominë e tyre organizative;

- (ii) rregullat dhe procedurat që qeverisin apo ndikojnë në funksionimin e autoriteteve rregullatore duhet që në mënyrë të qartë të afirmojnë dhe mbrojnë pavarësinë e tyre;
- (iii) procedurat e emërimit të anëtarëve dhe mënyra e financimit duhet po ashtu të definohet qartë me ligj;
- (iv) përbërja e këtyre trupave:
 - (a) duhet të evitojë politizimin dhe të sigurojë pluralizëm; dhe
 - (b) duhet të përfshijë ekspertë të fushave që bien brenda kompetencave të tyre;
- (v) anëtarët e këtyre autoriteteve:
 - (a) emërohen në mënyrë demokratike dhe transparente duke siguruar neutralitet politik;
 - (b) nuk mund të marrin instruksione nga ndonjë individ apo organ; dhe
 - (c) nuk bëjnë ndonjë deklaratë apo nuk ndërmarrin ndonjë veprim që mund të paragjykojë pavarësinë e funksionit të tyre dhe nuk kanë ndonjë përfitim nga to;
- (vi) shkarkimi duhet të jetë i mundur vetëm në rast të mosrespektimit të rregullave të qarta të cilat ata duhet t'i respektojnë.

B. Vlerësimi i Gjykatës

178. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesave theksojnë që Kuvendi zgjedh anëtarët e KPM-së me shumicë të thjeshtë të votave, duke krijuar kontroll të drejtpërdrejtë të KPM-së nga shumica parlamentare, përfshirë faktin që Kryetari i KPM-së nuk zgjedhet nga KPM por drejtpërdrejtë nga Kuvendi, sipas tyre duke e bërë pozitën e Kryetarit të varur nga Kuvendi e jo nga anëtarët e KPM-së. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se neni 141 i Kushtetutës përcakton KPM-së si institucion të pavarur, duke mandatuar të njëjtin që (i) të rregullojë spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës (ii) licencojë transmetuesit publikë dhe privatë; (iii) të përcaktojë dhe zbatojë politikën e transmetimit; si dhe (iv) të ushtrojë kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.
179. Thënë këtë, dhe në kuptim të përcaktimit të paragrafit 2 të nenit 141 të Kushtetutës që përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të përcaktohet në nivel ligji, Gjykata konsideron që një ligj i tillë duhet të sigurojë që nëpërmjet rregullimit të përbërjes, mënyrës së zgjedhjes, raportimit, shkarkimit, nuk cenohet pavarësia e KPM-së e garantuar me nenin 141 të Kushtetutës.
180. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se për dallim nga institucionet e tjera të pavarura nga Kapitulli XII i Kushtetutës, të cilat kryesisht dhe në parim janë mandatuar me Kushtetutë për të zbatuar legjislacionin në fuqi për çështjet që ndërlidhen me mandatin e tyre apo që kanë kompetenca kontrolli (shih, kompetencat e Bankës Qendrore të Kosovës sipas nenit 140 të Kushtetutës; kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas nenit 139 të Kushtetutës dhe Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, sipas nenit 137 të Kushtetutës), KPM është institucion i pavarur në këtë kapitull të Kushtetutës që ka rol dhe funksion rregullativ. Përkatesisht, KPM-së vet Kushtetuta, në paragrafin 1 të nenit 141 të saj, sa i përket spektrit të Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës; dhe përcaktimit dhe zbatimit të politikave të transmetimit i ka përcaktuar rol rregullativ. Përderisa kompetencat tjera janë lënë të rregullohen në nivel ligji.

181. Po ashtu, sa i përket institucioneve tjera të pavarura të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, Gjykata vëren se Kushtetuta apo ligjet kanë përcaktuar mënyrën e funksionimit të tyre, përfshirë mënyrën e (i) propozimit; dhe (ii) zgjedhjes së trupave udhëheqëse/krerëve të këtyre institucioneve, bazuar në karakteristikat e secilit institucion. Në këtë kontekst, sa i përket (i) Avokatit të Popullit, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, që përcakton se “*Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij*”, përderisa neni 8 (Procedura e propozimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit) i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton se propozimin për Avokat të Popullit e bënë Komisioni kompetent për të drejtat e njeriut i Kuvendit, por bazuar në listën e ngushtë të përgatitur nga Paneli përzgjedhës i caktuar nga Komisioni kompetent për të drejtat e njeriut. Sa i përket (ii) Auditorit të Përgjithshëm, bazuar në paragrafin 3 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] të Kushtetutës, Auditori i Përgjithshëm “*zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës*”. Sa i përket (iii) Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në nenin 139 (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve) të Kushtetutës, (a) Kryesuesin e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli; ndërsa (b) anëtarët e tjerë emërohen nga grupet parlamentare dhe nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb dhe komunitetet e tjera. Sa i përket, (iv) Bankës Qendrore të Kosovës, bazuar në nenin 38 (Emërimet) të Ligjit për Bankën Qendrore, përkritazi me pozitën e Guvernatorit apo anëtarëve jo ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore, konstituohet një panel i përbërë nga anëtarët e tjerë të Bordit dhe Guvernatori, ku asnjëri nuk kërkon riemërim, i cili i dërgon Kuvendit listën me aplikantët që i plotësojnë kriteret për pozitën përkatëse, me ç’ rast Kuvendi zgjedh nga një individ për secilën pozitë të lirë, dhe pasi Kuvendi të bëjë përzgjedhjen, propozimet miratohen nga Presidenti i Republikës.
182. Në kontest të Ligjit të kontestuar, Gjykata i referohet nenit 7 (Pavarësia e KPM-së) të Ligjit të kontestuar, i cili në paragrafin 1 përcakton që: “*KPM gëzon pavarësi organizative, administrative, funksionale dhe financiare në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij*” ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se “*Anëtarët e KPM-së si dhe personeli i KPM-së, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga organet qeveritare, ndonjë person apo subjekt tjetër publik ose privat. Pavarësia e KPM-së respektohet në çdo kohë dhe asnjë person, subjekt tjetër publik apo privat nuk lejohet të ndikojë tek anëtarët dhe personeli i KPM-së në realizimin e detyrave të tyre*”.
183. Gjykata vëren se KPM bazuar në nenin 14 (Përbërja e KPM) të Ligjit të kontestuar përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, e cila përbërje sipas paragrafit 4 të këtij neni përfshin: së paku një (1) anëtar/e nga fusha e drejtësisë; një (1) anëtar/e nga fusha e financave; një (1) anëtar/e nga fusha e inxhinierisë së telekomunikimit; dhe një (1) anëtar/e nga fusha e gazetarisë. Për më tepër, sipas paragrafit 5 të këtij neni “*Anëtarët e KPM-së emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë KPM-së. Atyre nuk u lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë udhëzim në lidhje me aktivitetet e KPM-së nga asnjë person apo subjekt jashtë institucionit*”.
184. Bazuar në elaborimin e dispozitave të lartcekura, përveç faktit që përbërja e KPM-së është e rregulluar më Ligjin e kontestuar, ky i fundit përmes paragrafit 5 të nenit 14 të tij, në mënyrë specifike përcakton pavarësinë institucionale të vet KPM-së dhe të anëtarëve të saj, të cilët veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga organet qeveritare, ndonjë person apo subjekt tjetër publik ose privat, dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë KPM-së.

185. Në raport me zgjedhjen e kryetarit të KPM-së drejtpërdrejt nga Kuvendi, Gjykata vëren se Kuvendi ndjek të njëjtën procedurë për emërimin e Kryetarit sikurse për emërimin e anëtarëve të KPM-së. Emërimi i kryetarit të KPM-së i nënshtrohet të njëjtave rregulla edhe sa i përket mandatit dhe mundësisë së shkarkimit nga ana e Kuvendit. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron që vetëm fakti se emërimi i Kryetarit i bërë drejtpërdrejtë nga Kuvendi, në vetvete, nuk e cenon pavarësinë e KPM-së apo se kjo e vendos të njëjtën në raport varësie ndaj Kuvendit dhe jo ndaj anëtarëve të KPM-së. Për më tepër, Kryetari i KPM-së në raport me vendimmarrjen brenda KPM-së ka statusin e njëjtë me të gjithë anëtarët e tjerë të KPM-së dhe se anëtarët e KPM-së nuk i detyrohen Kryetarit sa i përket vendimmarrjes së tyre brenda KPM-së.
186. Në vijim, sa i përket zgjedhjes së anëtarëve, bazuar në nenin 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së), përkatësisht paragrafit 1, anëtarët dhe kryetari i KPM-së zgjidhen nga Kuvendi në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, ndërsa bazuar në nënparagrafët 1.3. dhe 1.4, të nenit 15 të Ligjit të kontestuar, rekomandohen dy (2) kandidatë për një pozitë nga komisioni përkatës, përderisa Kuvendi zgjedh njërin nga dy (2) kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të tij, që janë të pranishëm dhe që votojnë. Thënë këtë, Gjykata rikujton që, para saj kontestohet mënyra e përzgjedhjes së Kryetarit dhe e anëtarëve të KPM-së, duke përfshirë zgjedhjen e tyre me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi.
187. Lidhur me këtë, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore veçse ka theksuar që në shqyrtim të kushtetutshmërisë së një Ligji, ajo asnjëherë nuk vlerëson se a është një ligj i bazuar në politika të mira publike apo jo, por vetëm nëse i njëjti mund të ketë cenuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (shih, rastet e Gjykatës KO73/16, parashtues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2016, paragrafi 52; rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafi 357; KO12/18, parashtues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 29 majit 2018, paragrafi 117; KO219/19, cituar më lart, paragrafi 259; dhe KO216/22 dhe KO220/22, parashtues: për kërkesën KO216/22 - *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë*, dhe për KO220/22 *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Aktgjykimi i 2 gushtit 2023, paragrafi 312).
188. Në vijim, dhe në kuptim të zgjedhjes me shumicë të thjeshtë, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore e që ndërlidhet me shumicën e nevojshme për të zgjedhur bartësit e institucioneve të ndryshme, ka theksuar se: “Gjykata rikujton paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, bazuar në të cilin ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. Këto përjashtime, Kushtetuta i përcakton në mënyrë specifike, duke i ndarë në dy (2) kategori, përkatësisht (i) rastet kur kërkohet shumicë që dallon nga e thjeshta; dhe (ii) rastet kur vendimmarrja është kushtëzuar edhe me shumicën e caktuar të komuniteteve jo-shumicë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe të cilat janë shtjelluar detajisht në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO100/22 dhe KO101/22” (shih, rastet e Gjykatës KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafët 275-277; dhe [KO46/23](#), parashtues *Abelard Tahiri dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Aktgjykim i 20 qershorit 2024, paragrafi 447). Thënë këtë, Gjykata në rastin KO46/23, kishte konstatuar se “Marrë parasysht që Kushtetuta nuk ka përcaktuar

ndryshe, zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore bie në kuadër të nenit 80 të Kushtetutës, përkatësisht zgjedhjes me shumicë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Për pasojë dhe marrë parasysh (i) paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë; dhe (ii) faktin që ky nuk është rasti përkitazi me themelimin e funksionimit të Agjencive të Pavarura sipas nenit 142 të Kushtetutës, zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në dy raundet e para të votimit dhe para se të delegohet kjo kompetencë në Komisionin Mbikëqyrës në rast të dështimit të zgjedhjes nga Kuvendi, nuk është në kundërshtim me nenet e lartcekura”.

189. Prandaj, edhe në rastin konkret, marrë parasysh paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është e përcaktuar ndryshe me Kushtetutë, shumica e nevojshme për votimin e anëtarëve të KPM-së, e përcaktuar me Ligjin e kontestuar, nuk është në vetvete në kundërshtim dispozitën e lartcekur.
190. Megjithatë, Gjykata thekson se pavarësisht se në rastin konkret, marrë parasysh (i) paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me Kushtetutë; dhe (ii) faktin që ky nuk është rasti përkitazi me KPM-në sipas nenit 141 të Kushtetutës, dhe si e tillë shumica e nevojshme për votimin e anëtarëve të KPM-së është në harmoni me nenin 80 të Kushtetutës, Gjykata thekson se mënyra e votimit të anëtarëve të KPM-së, përfshirë Kryetarin e saj, është vetëm një element që ndërlidhet me pavarësinë e një institucioni të pavarur, siç është KPM-ja. Në këtë kontekst, bazuar edhe në parimet e përgjithshme të përcaktuara më lart, emërimi i anëtarëve të KPM-së duhet shikuar në kontekst edhe të elementeve tjera të rëndësishme që garantojnë pavarësinë e një institucioni, siç janë (i) mënyra e propozimit të anëtarëve të KPM-së; (ii) raporti i tyre me institucionet tjera, përkatësisht organet qeveritare apo organin zgjedhës në kuptim të udhëzimeve që mund të pranojnë apo varësisë që ekziston në lidhje me aktivitetet e KPM-së; (iii) kohëzgjatja e mandatit; si dhe (iv) mënyra e shkarkimit dhe raportimi, të cilat do të trajtohen në kuadër të pretendimeve tjera të parashtruesve të kërkesave.
191. Në këtë aspekt, Gjykata vë theksin në çështjen e propozimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të KPM-së. Bazuar në nënparagrafin 1.2 dhe nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së), (i) kandidaturat e pranuarat për kryetar dhe ato për anëtarë shqyrtohen nga Komisioni përkatës për media i Kuvendit të Kosovës; ndërsa (ii) komisioni përkatës për media, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë të lirë të kryetarit dhe anëtarit të KPM-së, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, përgatitjes profesionale, integritetit dhe përkushtimit të tyre për fushëveprimin e KPM-së.
192. Prandaj, Gjykata vëren se përderisa është shumica parlamentare ajo e cila i miraton apo i zgjedh përfundimisht, me shumicë të thjeshtë të votave, anëtarët e KPM-së, dhe sipas sqarimeve të dhëna më lart, kjo shumicë është në harmoni me nenin 80 të Kushtetutës, sipas Ligjit të kontestuar është po ashtu shumica parlamentare më së shumti e përfaqësuar në komisionin përkatës të Kuvendit që bënë propozimet për Kryetar dhe anëtarë të KPM-së.
193. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se përderisa secili institucion i pavarur nga Kapitulli XII i Kushtetutës, ku bënë pjesë edhe KPM, bazuar në specifikat e tyre zgjedh anëtarët/trupat

udhëheqëse në mënyra të ndryshme, emëruesi i përbashkët i tyre është se përmes vet Kushtetutës ose ligjit përkatës, (i) ka një shumicë më të lartë për përzgjedhjen e tyre në Kuvend, siç është rasti i Avokatit të Popullit dhe Auditorin e Përgjithshëm ku kërkohet shumica e “të gjithë” deputetëve të Kuvendit për emërimin e tij/saj (shih paragrafin 1 të nenit 134 të Kushtetutës dhe paragrafin 3 të nenit 136 të Kushtetutës); ose (ii) sigurohet përfaqësimi i grupeve parlamentare ose përfaqësuesve të komuniteteve, siç është rasti me Komisionin Qendror për Zgjedhjet, ndërsa kryesuesi i kësaj trupe zgjedhet nga Presidenti (shih nenin 139 të Kushtetutës); ose/dhe (iii) përderisa përcaktohet shumica e thjeshtë e votave apo e të gjithë deputetëve, për vendimmarrje në Kuvend, propozimi i kandidatëve për pozitë e tilla, është përcaktuar që të bëhet nga një trupë/institucion që nuk ndërlidhet me shumicën parlamentare në Kuvend, siç është rasti me Auditorin e Përgjithshëm që propozohet nga Presidenti (shih, paragrafin 3 të nenit 136 të Kushtetutës), dhe Guvernatorin ose anëtarët joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore, që propozohen përmes sistemit të brendshëm të Bankës Qendrore, ku përcaktohet edhe roli i Presidentit të Republikës (shih nenin 38 të Ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës). Bazuar në elaborimin e këtyre përcaktimeve me Kushtetutë, rezulton që në të gjitha institucionet e pavarura nga Kapitulli XII i Kushtetutës, nuk rezulton që anëtarët e trupave udhëheqëse (i) të propozohen nga trupa brenda Kuvendit që dominohen nga shumica parlamentare; dhe në të njëjtën kohë (ii) të propozuarit të zgjedhën me shumicë të thjeshtë të votave nga Kuvendi, pa rol edhe të institucioneve të tjera.

194. Prandaj, Gjykata vlerëson se në kontekstin specifik të mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve të KPM-së, si organ i pavarur kushtetues, sipas Kapitullit XII të Kushtetutës, duhen marrë për bazë (i) pavarësinë që i garantohet KPM-së përmes nenit 141 të Kushtetutës; (ii) parimet ekzistuese kushtetuese përkitazi me propozimin/përzgjedhjen e trupave udhëheqëse të institucioneve të pavarura kushtetuese pjesë e Kapitullit XII të Kushtetutës; por edhe (iii) standardin e vendosur përmes rekomandimeve të Këshillit të Evropës, dhe opinioneve të Komisionit të Venecias, e që ndërlidhen me pavarësinë e një organi të pavarur rregullativ të mediave.
195. Thënë këtë, marrë për bazë edhe kufizimet që rezultojnë nga neni 80 i Kushtetutës lidhur me shumicën e nevojshme për të miratuar vendimet e Kuvendit, Gjykata konsideron se në rrethanat e KPM-së duhet të sigurohet një balancë në mes të (i) propozimit; dhe (ii) emërimit të anëtarëve të KPM-së nga ana e Kuvendit, në mënyrë që përbërja e zgjedhur e KPM-së të reflektojë pavarësi institucionale dhe profesionale, ashtu siç reflektojnë edhe dispozitat kushtetuese e ligjore përkitazi me anëtarët/trupat udhëheqëse të institucioneve të pavarura nga Kapitulli XII i Kushtetutës.
196. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se propozimi i anëtarëve të KPM-së nga Komisioni përkatës i Kuvendit i cili dominohet nga shumica parlamentare, dhe zgjedhja me shumicë të thjeshtë të votave të marra së bashku, nuk siguron balancin e duhur të pavarësisë së përbërjes së KPM-së, (i) sipas standardeve kushtetuese të cekura më lart; (ii) nenin 141 të Kushtetutës; dhe (iii) mënyrën e zgjedhjes së trupave të institucioneve tjera të pavarura të përfshira në Kapitullin XII të Kushtetutës.
197. Prandaj, Gjykata vlerëson se propozimi i anëtarëve nga Komisioni parlamentar të dominuar nga shumica parlamentare, shikuar së bashku me shumicën e nevojshme për të zgjedhur anëtarët e KPM-së, nuk siguron pavarësinë e KPM-së të përcaktuar në nenin 141 të Kushtetutës.

198. Në vijim të këtij vlerësimi, Gjykata po ashtu konsideron se garantimi i një KPM-je të pavarur ashtu siç është specifikua edhe në nenin 141 të Kushtetutës, merr rëndësi edhe më të madhe bazuar edhe në kompetencat e zgjeruara që i janë dhënë KPM-së përmes Ligjit të kontestuar, përfshirë edhe mbikëqyrjen e mediave online.
199. Në vijim, dhe në kontekstin specifik të Ligjit të kontestuar, Gjykata i referohet edhe raporteve të Komisionit të Venecias, të shtjelluara më lart, përmes të cilave në parim është theksuar që do të ishte ideale të gjithë anëtarët do të zgjidheshin në mënyrë që është e ndarë nga procesi politik, por nëse kjo nuk është e mundur, mekanizma tjerë do të mund të zbatoheshin, siç janë, delegimi i anëtarëve nga komuniteti i mediave dhe industrisë së mediave; dhe pjesëmarrjes së grupeve të shoqërisë civile në proces. Në lidhje me këtë, Gjykata vendos theksin në [Opinionin Nr. 980/2020 të Komisionit të Venecias CDL-AD \(2020\) 013](#), të 19 qershorit 2020, përkitazi me Draft Amendamentet e Ligjit Nr. 97/2013 për Shërbimet e Mediave Audiovizuale të Shqipërisë, përmes të cilit specifikisht është theksuar që pavarësia dhe paanshmëria e një autoritetit rregullativ për medie reflektohet nga mënyra e emërimit të anëtarëve të saj (shih, paragrafin 34 të [Opinionin Nr. 980/2020 të Komisionit të Venecias CDL-AD\(2020\)013](#)).
200. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se (i) një trupë më gjithëpërfshirëse, përfshirë përfaqësues të institucioneve tjera të pavarura, shoqërinë civile, përfaqësues të vet sektorit të mediave apo të autoriteteve vetërregulluese, që shqyrton dhe bën përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KPM-së, të cilët në vijim do t'i rekomandonte Kuvendit kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore për t'u emëruar Kryetar dhe/ose anëtarë të KPM-së; ose (ii) mundësinë që institucione të tjera, përfshirë autoritetet vet-rregulluese të mund të delegojnë një numër anëtarësh drejtpërdrejtë apo të propozojnë anëtarë të KPM-së që do të votoheshin nga Kuvendi, për aq sa plotësohen kriteret e pajtueshmërisë me funksionin, do të mund të plotësonin standardin që KPM të jetë e pavarur, ashtu siç përcaktojnë parimet kushtetuese dhe vetë Ligji i kontestuar.
201. Gjykata vëren se një mënyrë të ngjashme të emërimit të anëtarëve të KPM-së, si në rastin e Ligjit të kontestuar e përcaktonte edhe Ligji aktual i KPM-së i vitit 2012, përkatësisht që anëtarët e KPM-së zgjidhen “me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë”, pas rekomandimit të një “komisioni ad-hoc” të Kuvendit. Megjithatë, Gjykata thekson se Ligji i KPM-së i vitit 2012, nuk ishte kontestuar para Gjykatës.
202. Prandaj, bazuar në elaborimin si më sipër, marrë për bazë (i) parimet kushtetuese të paanshmërisë në raport me institucionet e pavarura, të përfshira në Kapitullin XII të Kushtetutës; (ii) rolin e autoritetit rregullativ të KPM-së të përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës; (iii) parimet kushtetuese dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së ndërlidhur me lirinë e mediave, përfshirë rolin e autoriteteve rregullative dhe të transmetuesve publikë në lirinë e mediave; dhe (iv) standardet ndërkombëtare përkitazi me parimin e paanshmërisë dhe të pavarësisë që duhet të reflektojnë një autoritet rregullativ për medie, Gjykata konsideron se mënyra e propozimit të anëtarëve e specifikuar përmes nënparagrafëve 1.2. dhe 1.3 të nenit 15 të Ligjit të kontestuar, nuk i plotëson kërkesat e vendosura përmes parimeve të lartcekura kushtetuese dhe atyre të vendosura përmes mekanizmave ndërkombëtarë.
203. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së) i Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

2. Në lidhje me përfaqësimin gjinor në përbërjen e KPM-së

A. Parimet e përgjithshme

204. Përkitazi me barazinë gjinore, Gjykata rithekson se Republika e Kosovës është përcaktuar për një rend kushtetues në të cilin barazia gjinore përbën një nga vlerat themelore. Bazuar në nenin 7 të Kushtetutës, kjo vlerë ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe jetësimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore (shih rastet e Gjykatës KI45/20 dhe KI46/20 (raste të bashkuara), me parashtrues *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, Aktgjykimi i 26 marsit 2021, paragrafi 73 dhe rasti KI195/22, parashtrues: *Besim Morina*, Aktgjykim i 29 janarit 2024, paragrafi 36).
205. Nevoja e krijimit të mundësive të barabarta krijon për shtetin detyrime pozitive për përdorim të instrumenteve dhe masave të ndryshme, duke përfshirë edhe normime ligjore, me qëllim të eliminimit të “*pabarazive faktike*” ndërmjet grave dhe burrave (shih rastet e Gjykatës KI45/20 dhe KI46/20, cituar më lart, paragrafi 75; dhe rasti KI195/22, cituar më lart, paragrafi 37).
206. Sipas Kushtetutës, shprehimisht në paragrafin 3 të nenit 24 të Kushtetutës parashihet që parimet e mbrojtjes së barabartë nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla të veçanta paraqesin instrumente me të cilat Shteti, respektivisht Republika e Kosovës, zhvillon politikën e mundësive të barabarta, si dhe zbut ose eliminon pabarazinë faktike (shih rastet e Gjykatës KI45/20 dhe KI46/20, cituar më lart, paragrafi 75; dhe rasti KI195/22, cituar më lart, paragrafi 38).
207. Lidhur parimin e sigurisë juridike, Gjykata rithekson parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, praktika e saj gjyqësore dhe Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, sipas së cilave parimi i sigurisë juridike, i cili është i mishëruar në konceptin e sundimit të ligjit, i garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, dhe në të gjitha nenet e KEDNJ-së, kërkon që të drejtat dhe detyrimet të jenë të “*përcaktuara me ligj*” (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër Italisë](#), nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 109; [Hentrich kundër Francës](#), nr. 1361/88, Aktgjykim i 22 shtatorit 1994, paragrafi 42; dhe [Lithgoë dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; [9405/81](#), Aktgjykim i 8 korrikut 1986, paragrafi 110; dhe, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), parashtruesit: *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë, si dhe Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Aktgjykim i 24 marsit 2023, paragrafi 347).
208. Në këtë kontekst, “*përcaktueshmëria me ligj*” përveç që kërkon që masa e ndërmarrë duhet të ketë bazë ligjore në legjislacionin shtetëror, kërkon gjithashtu që dispozitat relevante të ligjit të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*”. “*Parashikueshmëria*”, bazuar në parimet e lartcekura, kërkon që ligji të formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre respektivisht (shih, ndër të tjera, *Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias*, [CDL-](#)

[Ad\(2016\)007](#), Strasburg, 18 mars 2016, paragrafët 58 dhe 59; dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 347).

B. Vlerësimi i Gjykatës

209. Gjykata vëren se paragrafi 2 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar përcakton se zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së *“reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore”*.
210. Gjykata rikujton se përkitazi me përfaqësimin gjinor në KPM, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së minon përfaqësimin gjinor të garantuar me nenin 7 dhe nenin 24 të Kushtetutës, pasi nuk përcakton numrin e anëtarëve të KPM-së, siç përcakton Ligji aktual në fuqi i KPM-së, ku parashihet që së paku dy (2) nga anëtarët e KPM-së duhet të jenë të gjinisë femërore, por vetëm bënë referencë në *“legjislacionit përkatës për barazi gjinore”*, i cili sipas tyre, nuk paraqet kuota detyruese të përfaqësimit, pretendim ky që mbështetet edhe nga AGK dhe kundërshtohet nga Qeveria.
211. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar tek parimet e përgjithshme se Republika e Kosovës është përcaktuar për një rend kushtetues në të cilin barazia gjinore përbën një nga vlerat themelore, ashtu siç përcaktohet në nenin 7 të Kushtetutës. Gjithashtu, nevoja e krijimit të mundësive të barabarta krijon për shtetin detyrime pozitive për përdorim të instrumenteve dhe masave të ndryshme, duke përfshirë edhe përcaktime ligjore, me qëllim të eliminimit të pabarazive faktike ndërmjet grave dhe burrave. Në këtë kontekst, sipas Kushtetutës, shprehimisht në paragrafin 3 të nenit 24 të Kushtetutës parashihet që parimet e mbrojtjes së barabartë nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Gjykata ka theksuar se masat e tilla të veçanta paraqesin instrumente me të cilat shteti, respektivisht Republika e Kosovës, zhvillon politikën e mundësive të barabarta, si dhe zbut ose eliminon pabarazinë e mundshme faktike. Këto masa mund të zbatohen deri në realizimin e qëllimit për të cilin edhe janë vendosur.
212. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Ligji aktual në fuqi i KPM-së i vitit 2012, në paragrafin 5 të nenit 10 (Përbërja e KPM-së) ka përcaktuar se *“së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore”*.
213. Për dallim nga kjo dispozitë, paragrafi 6 i nenit 14 (Përbërja e KPM-së) i Ligjit të kontestuar përcakton se *“përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës”*. Prandaj, përderisa i njëjti sa i përket komuniteteve joshumicë përcakton se të paktën tre (3) anëtarë të KPM-së emërohen nga radhët e komuniteteve joshumicë, nuk përcakton kuota specifike gjinore.
214. Në anën tjetër, Gjykata vëren se paragrafi 2 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar përcakton se zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së *“reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore”*.
215. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 8 të nenit 6 të Ligjit për Barazi Gjinore i cili parasheh që: *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe të vendimmarrëse;”*.

216. Lidhur me këtë, siç ka theksuar Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, Kuvendi si ligjvënës nuk e ka formuluar këtë përqindje si një kuotë obligative ligjore, por e ka formuluar më tepër në formë të një ideali kushtetues, ligjor e faktik që shoqëria demokratike e Republikës së Kosovës duhet ta arrijë dhe se vetëm pas arritjes së saj sigurohet barazia e vërtetë faktike. Pra, pesëdhjetë përqindëshi (50%-shi) i normuar në paragrafin 8 të nenit 6 të Ligjit për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm (shih rastet e Gjykatës KI45/20 dhe KI46/20, cituar më lart, paragrafi 142).
217. Ndonëse ideali kushtetues dhe fryma e Kushtetutës e reflektuar në nenin 7 të saj synojnë arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive, Gjykata Kushtetuese është e vetëdijshme që nuk është në kompetencën e saj që të caktojë politika të reja publike e as të vlerësojë nëse një politikë publike e deritashme është e mirë apo e duhur. Gjithashtu, nuk i takon Gjykatës që të rivendosë kuota të reja ligjore ose të rrisë përqindjen e kuotave ligjore të përfaqësimit gjinor në favor të asnjërës gjini. Andaj, në rrethanat e rastit KI45/20 dhe KI46/20, që ndërlidhej me kuotat e përfaqësimit në Kuvend, Gjykata ka theksuar se ligjvënësit e Republikës së Kosovës janë ata që kanë vendosur kuotën prej 30% si kuotë të vetme ligjore të aplikueshme, e cila duhet të ruhet në çdo rrethanë përderisa autoritetet kompetente nuk vendosin që të bëjnë ndryshime ligjore në këtë aspekt, nëse ato e shohin të nevojshme. Janë gjithashtu ligjvënësit ata që kanë caktuar 50%-shin si ideal kushtetues të përfaqësimit të barabartë gjinor duke theksuar se përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet vetëm kur sigurohet përfaqësim 50%-50% për secilën gjini (shih, rastet e Gjykatës KI45/20 dhe KI46/20, cituar më lart, paragrafi 143).
218. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar dallon nga Ligji për Zgjedhjet që ka përcaktuar kuotën për përfaqësim në Kuvend prej tridhjetë përqind (30%) si minimum të përfaqësimit të secilës gjini, dhe Ligji i vitit 2012 që në paragrafin 5 të nenit 10 (Përbërja e KPM-së) ka përcaktuar se “*së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore*”.
219. Gjykata së pari vëren se, paragrafi 6 i nenit 14 (Përbërja e KPM-së) i Ligjit të kontestuar përcakton qartë detyrimin se përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin “*gjinor të Kosovës*”, duke determinuar detyrimisht përfaqësim gjinor në përbërjen e KPM-së.
220. Së dyti, përderisa paragrafi 6 i nenit 14 të Ligjit të kontestuar përcakton se përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron edhe karakterin gjinor të Kosovës, paragrafi 2 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar ka bërë referencë specifike në legjislacionin “*për barazi gjinore*”, sa i përket zgjedhjes së kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së. As njëra nga këto dispozita nuk ka përcaktuar kuota gjinore specifike në përbërjen e KPM-së.
221. Në këtë kontekst, marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vlerëson se pavarësisht që kuota prej pesëdhjetë përqind (50%) e normuar në paragrafin 8 të nenit 6 të Ligjit për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm, siç ka përcaktuar Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, kur ligjvënësi përmes një Ligji specifik i referohet “*legjislacionit përkatës për barazi gjinore*” sa i përket përbërjes së një trupe specifike, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së) të Ligjit të kontestuar, kjo përfaqëson vullnetin e ligjvënësit që një kuotë të tillë, ta bëjë të detyrueshme në rrethanat e rastit konkret. Kjo për më tepër që, edhe paragrafi 6 i nenit 14 (Përbërja e KPM-së) i Ligjit të kontestuar përcakton qartë detyrimin që përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin “*gjinor të Kosovës*”.

222. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se (i) referimi në legjislacionin përkatës për barazi gjinore sa i përket zgjedhjes së kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së; në ndërlidhje me (ii) përcaktimin e detyrimit që përbërja e KPM-së të reflektojë karakterin gjinor të Kosovës, rezulton në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, përfshirë në kontekst të paragrafit 8 të nenit 6 të Ligjit për Barazi Gjinore, që përcakton kuotën prej pesëdhjetë përqind (50%) të përfaqësimit në KPM.
223. Prandaj, në kontekst të përbërjes së KPM-së, kjo nënkupton që nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë sa parashihet të ketë KPM, të paktën pesë (5) nga ta duhet të jenë të gjinisë së kundërt, në mënyrë që të plotësohet standardi i barazisë gjinore i përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 14 dhe paragrafin 2 të nenit 15 të Ligjit të kontestuar, në ndërlidhje me Ligjin për Barazi Gjinore.
224. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesve të kërkesave se Ligji i kontestuar nuk ka respektuar kuotat gjinore të përcaktuara me Ligjin aktual, nuk është i bazuar pasi Ligji i kontestuar duke iu referuar specifikisht legjislacionit për barazi gjinore në kontekst të përbërjes së KPM-së reflekton vullnetin e ligjvënësve që kjo kuotë të jetë deri në pesëdhjetë përqind (50%) të përfaqësimit të secilës gjini.
225. Prandaj, Gjykata konstaton se paragrafi 2 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

3. Në lidhje me vazhdimin e mandatit të anëtarëve të KPM-së deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj

226. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave pretendojnë se pavarësisht se mandati i anëtarëve të KPM-së bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të Ligjit të kontestuar, është katër (4) vjet me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat, Ligji i kontestuar përmes paragrafit 2 të nenit 17, ka përcaktuar mundësinë për zgjatjen e mandatit deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, kjo sipas parashtruesve të kërkesave është në shpërputhje të plotë me konceptin e mandatit të kufizuar kohor të përcaktuar me Ligjin e kontestuar dhe me standardet kushtetuese të institucioneve të pavarura dhe parimin e sigurisë juridike si pjesë përbërëse e parimit të sundimit të ligjit, e përcaktuar në nenin 7 të Kushtetutës.
227. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se neni 141 i Kushtetutës (i) e përcakton KPM-në si organ të pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publikë e privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit. Ndërsa i njëjti determinon rregullimin në nivel ligji të zgjedhjes e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KPM-së, me kushtin që procesi për zgjedhjen e tyre të jetë transparent. Çështja e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të trupave të pavarura, siç është KPM, dhe mundësia e rizgjedhjes ndërlidhet edhe me pavarësinë e anëtarëve të tyre.
228. Lidhur me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 17 të Ligjit të kontestuar, mandati i kryetarit dhe anëtarëve është katër (4) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat.
229. Përgjithësisht, sipas paragrafit 2 të nenit 17 të Ligjit të kontestuar, nëse pas përfundimit të mandatit, kryetari dhe anëtarët e rinj nuk kanë mundur të zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara, kryetari dhe anëtarët e KPM-së të cilëve u ka skaduar mandati vazhdojnë të ushtrjnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre deri në zgjedhjen e kryetarit, përkatësisht anëtarëve të rinj, nga Kuvendi. Kjo me përjashtim të rasteve kur të njëjtit janë shkarkuar

apo kanë dhënë dorëheqjeje, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2, nënparagrafin 2.1 të këtij neni.

230. Gjykata vëren se një praktikë e tillë zbatohet edhe në rastin e institucionit të Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur kushtetues i përcaktuar me Kapitullin II [Institucionet e pavarura] të Kushtetutës. Në këtë kontekst, bazuar në paragrafin 3 të nenit 14 (Përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/sa) të Ligjit Nr. 05/L--019 për Avokatin e Popullit *“Në rast të përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit apo zëvendësi i tij/saj do ta ushtroj funksionin e tij deri në zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit, përkatësisht zëvendësit të ri”*.
231. Prandaj, Gjykata vëren se edhe Ligji për Avokatin e Popullit parasheh mundësinë e vazhdimit të mandatit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj, edhe pas përfundimit të mandatit të rregullt të tyre. Kjo pavarësisht faktit që (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 9 (Zgjedhja e Avokatit të Popullit) të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje; përderisa (ii) sipas paragrafit 6 të nenit 10 (Procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të popullit) të Ligjit për Avokatin e Popullit, zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjidhen nga Kuvendi, me mandat tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.
232. Për më tepër, një dispozitë e tillë është përfshirë edhe në Ligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur të Shërbimit Civil të Kosovës, i cili në paragrafin 7 të nenit 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit) përcakton se *“Me qëllim të ruajtjes së funksionimit të institucionit, në rast të përfundimit të mandatit të rregullt dhe pamundësisë së emërimit të anëtarit të Këshillit për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, anëtari i Këshillit do të vazhdojë të ushtroj funksionin e tij deri në zgjedhjen e anëtarit të ri të Këshillit”*.
233. Për më tepër, një praktikë e tillë e qëndrimit në detyrë derisa të zëvendësohet parashihet edhe në nivel të gjyqtarëve të GJEDNJ-së, pavarësisht se sipas paragrafit 1 të nenit 23 (Kohëzgjatja e Mandatit) të KEDNJ-së, parashihet se *“Gjyqtarët zgjidhen për një afat prej nëntë vjetësh dhe ata nuk mund të rizgjidhen”*, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton shprehimisht se *“Gjyqtarët qëndrojnë në detyrë derisa të zëvendësohen. Megjithatë, ata vazhdojnë me shqyrtimin e çështjeve që kanë marrë në shqyrtim”*.
234. Gjykata vëren se ky rregullim ka për qëllimin që të evitohet vakumi institucional brenda KPM-së në rast se Kuvendi është në pamundësi për të zgjedhur anëtarët e rinj të KPM-së, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjeve që shqyrton KPM sipas Kushtetutës dhe ligjit.
235. Gjykata vëren po ashtu se rëndësia që KPM të jetë funksionale është evidentuar edhe nga Komisioni Evropian. Në këtë kontekst, Raporti i vitit 2023 për Kosovën i Komisionit Evropian thekson se KPM gjatë periudhës raportuese ka qenë në masë të madhe jofunksionale për shkak të mungesës së kuorumit. Kjo, pasi mandati i një anëtari ka kaluar ndërsa Kuvendi ka dështuar në zgjedhjen e një anëtari të ri deri në mars të vitit 2023 (shih Raportin e vitit 2023 për Kosovën i Komisionit Evropian, cituar më lart, faqe 33).
236. Andaj, në rastin konkret, Kushtetuta nuk e përcakton çështjen e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KPM-së, specifikisht në nenin 141 që ndërlidhet me mandatin e KPM-së. Prandaj, përderisa neni 141 i Kushtetutës, e delegon çështjen e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KPM-së në nivel ligji, Ligji i kontestuar përcakton pavarësinë e KPM-së dhe anëtarëve të KPM-së, përfshirë atë që gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk mund të marrin instruksione nga jashtë.

237. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, vazhdimi i mandatit të Kryetarit, përkatësisht anëtarëve të KPM-së deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, i shërben qëllimit që të evitohet vakumi institucional brenda KPM-së në rast se Kuvendi është në pamundësi për të zgjedhur anëtarët e rinj të KPM-së.
238. Prandaj, Gjykata vlerëson se parashtresit e kërkesave nuk e kanë dëshmuar se përcaktimi ligjor për vazhdimin e mandatit të Kryetarit dhe anëtarëve deri në zgjedhjen e Kryetarit, përkatësisht anëtarëve të rinj, i përcaktuar në Ligjin e kontestuar, cenon pavarësinë e KPM-së të përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës.
239. Ndërsa, në kontekst të sigurisë juridike, Gjykata thekson se siguria juridike sa i përket faktit se, në njërën anë neni 17 përcakton mandatin e kufizuar katër (4) vjeçar, ndërsa në anën tjetër mundëson vazhdimin e tij deri në zgjedhjen e kryetarit përkatësisht anëtarëve të rinj të KPM-së, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar është i qartë dhe i parashikueshëm në kuptimin që mandati katër (4) vjeçar përfundon, me kushtin që zgjedhën anëtarët e rinj, përndryshe i njëjti mund të vazhdojë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, përveç në rast të shkarkimit apo dorëheqjes së kryetarit apo anëtarëve të KPM-së.
240. Përfundimisht, Gjykata thekson se ky përcaktim ligjor nuk liron Kuvendin nga përgjegjësia që të zgjedhë anëtarët e KPM-së bazuar në procedurën e përcaktuar në nenin 15 të Ligjit të kontestuar, dhe atë brenda afateve të përcaktuara ku, ndër të tjera, përcaktohet në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të këtij neni që procedura fillon brenda afatit nëntëdhjetë (90) ditë para kalimit të mandatit të kryetarit apo anëtarëve të KPM-së. Kuvendi është i detyruar që të përmbush obligimin ligjor për zgjedhjen, dhe atë brenda afateve të përcaktuara ligjore, të kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, ashtu siç përcaktohen me ligj.
241. Prandaj, Gjykata bazuar në të lartcekurat, konstaton se paragrafi 2 i nenit 17 të Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet 141 [Komisioni i Pavarur i Medie] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës .

4. Në lidhje me shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së

242. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar që përcakton se: *“Kryetari dhe anëtari i KPM-së shkarkohet nga detyra kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për shkarkim sipas paragrafit 3 të këtij neni”*.
243. Paragrafi i 2 i të njëjtit nen përcakton procedurën për shkarkim, duke specifikuar se (i) propozimi bëhet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për medie; ndërsa, (ii) Kuvendi me shumicë të thjeshtë vendos për shkarkimin e Kryetarit apo anëtarit të KPM-së.
244. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se edhe Kryetari edhe anëtarët mund të shkarkohen nga funksioni me propozimin të Komisionit përkatës të Kuvendit, por paragrafi 1 i nenit 18 të Ligjit të kontestuar, vendos theksin në atë se edhe kryetari edhe anëtarët e KPM-së mund të shkarkohet vetëm bazuar në bazat për shkarkim të përcaktuara në paragrafin 3 të Ligjit të kontestuar.
245. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se bazat për shkarkim të përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar përfshijnë, (i) paaftësinë profesionale; (ii) paaftësinë mendore apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit; (iii) dështimit në realizimin e detyrave për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muaj, pa aprovim nga KPM-ja; (iv) marrje pjesë

në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje; (v) humbje e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM; (vi) dënimi për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burgim efektiv; (vii) mospërmblidhja e kushteve sipas nënparagrafëve 1.3 dhe 1.5. të paragrafit 1 të nenit 16 të Ligjit të kontestuar; (viii) mungesa në punë mbi pesëmbëdhjetë (15) ditë pa arsye; dhe (ix) pjesëmarrja aktive në aktivitete politike pas emërimit si anëtar i KPM-së.

246. Gjykata vëren se përkitazi me shkarkimin e anëtarëve të KPM-së, parashtruesit pretendojnë se (a) nuk i ka caktuar kriteret për shkarkim të Kryetarit të KPM-së por vetëm të anëtarëve të saj; përderisa (b) anëtarët mund të shkarkohen me shumicë të thjeshtë të votave, përfshirë për shkak të *“humbjes së besimit”* nga ana e Kuvendit dhe bazuar në kriterin e *“integritetit të cenuar”*.

247. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 18 i Ligjit të kontestuar (a) ka caktuar kriteret për shkarkim të Kryetarit të KPM-së; dhe (b) shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së me shumicë të thjeshtë të votave, përfshirë për shkak të *“humbjes së besimit”* nga ana e Kuvendit dhe bazuar në kriterin e *“integritetit të cenuar”*.

(a) Përkitazi me pretendimin për mos-përcaktueshmëri me Ligjin e kontestuar të kriterëve për shkarkim për Kryetarin, por vetëm për anëtarët e KPM-së

248. Sa i përket kushteve për shkarkimin e kryetarit të KPM-së, dhe pretendimeve të palëve se të njëjtat nuk janë të përcaktuara, Gjykata vëren se bazuar në paragrafin 1 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar shkarkimi edhe i kryetarit edhe i anëtarëve bëhen sipas bazave të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar. Prandaj, pavarësisht faktit që paragrafi 3 i nenit 18 të Ligjit të kontestuar nuk specifikon edhe pozitën e Kryetarit kur përcakton kushtet për shkarkim, një përcaktim i tillë është i rregulluar me paragrafin 1 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar. Prandaj, nga leximi i ndërlidhur i paragrafit 1 dhe 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, Gjykata thekson se edhe kryetari edhe anëtarët, mund të shkarkohen nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar.

249. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore ku ka theksuar se Kushtetuta dhe secila normë e saj duhet të interpretohen në ndërrvarësi me njëra-tjetrën dhe jo të izoluar nga njëra-tjetra, dhe gjithnjë duke pasur parasysh parimet dhe vlerat e saj. Asnjë normë e Kushtetutës nuk mund të interpretohet në mënyrë të ndarë dhe të izoluar nga parimet dhe vlerat e proklamuar në Kushtetutë, përfshirë Preambulën e saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të nxirret jashtë kontekstit dhe të interpretohet në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera të saj (shih rastin KO72/20 parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 majit 2020, paragrafi 346).

250. Gjykata vëren se të njëjtat parime sa i përket ndërlidhjes së normave ligjore vlejnë edhe sa i përket ligjeve. Andaj, edhe në rastin konkret, Gjykata thekson se pretendimi se Ligji i kontestuar ka përcaktuar kriteret sipas së cilave mund të shkarkohen anëtarët KPM-së po jo edhe kryetari i saj, nuk janë të bazuara për faktin se siç rezulton nga leximi i ndërlidhur i paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, si për anëtarët ashtu edhe për

kryetarin e KPM-së, zbatohen kushtet për shkarkim të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar.

(b) Përkitazi me shkarkimin e anëtarëve të KPM-së me shumicë të thjeshtë të votave bazuar në kriteret e Ligjit të kontestuar

251. Parashtruesit e kërkesave kontestojnë mundësinë e shkarkimit të anëtarëve të KPM-së me shumicën të thjeshtë sipas nënparagrafit 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, bazuar në *“humbjen e besimit të organit mbikëqyrës”*, duke kontestuar edhe qartësinë e kriterit për shkarkim për shkak të *“cenimit të integritetit”*.
252. Ashtu siç ka sqaruar Gjykata edhe më lart, kriteret për shkarkim të anëtarëve të institucioneve të pavarura janë element i rëndësishëm për të përcaktuar nëse një institucion i tillë gëzon pavarësinë e nevojshme për të kryer funksionet e saj.
253. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, institucionet e pavarura, janë të rregulluara në kapituj të veçantë kushtetues dhe secili prej këtyre kapitujve përcakton parimet e përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre, që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra-tjetrën, pa krijuar ndonjë *“ndërhyrje”*, *“varësi”* apo *“vartësi”* kundërkushtetuese në mes tyre, që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo tjetrit pushtet. Gjykata po ashtu ka theksuar se përveç tri pushteteve klasike, vend të veçantë në sistemin e ndarjes së pushteteve ka edhe Gjykata Kushtetuese, si institucion përgjegjës për garantimin përfundimtar të kushtetutshmërisë në nivel vendi, Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës; dhe në fund (shih rastet e Gjykatës, [KO100/22 dhe KO101/22](#), cituar më lart, paragrafi 158; dhe KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 243). Kushtetuta kë përfshirë KPM-në si institucion të pavarur në Kapitullin XII të Kushtetutës, ashtu siç përcaktohet në nenin 141 të Kushtetutës.
254. Duke pasur parasysh pavarësinë që gëzon KPM si institucion i pavarur kushtetues, dhe siç rezulton nga parimet e përgjithshme të përcaktuara më lart, përfshirë Rekomandimin e Këshillit të Evropës për organet rregullatorë të sektorit të transmetimit, shkarkimi i anëtarëve të saj duhet të jetë i mundur vetëm në rast të mosrespektimit të rregullave të papërshtatshmërisë të cilat ata duhet t'i respektojnë apo pamundësisë të ushtrimit të funksionit të përcaktuar, pa paragjykim për mundësinë që personi në fjalë të ankohet para gjykatës ndaj shkarkimit të tij. Për më tepër, shkarkimi bazuar në arsyet që ndërlidhet apo jo me funksionin e tyre duhet të jetë i mundur në raste serioze të përcaktuara qartë në ligj, subjekt i vendimit përfundimtar gjyqësor.
255. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në dispozitat e lartcekura kushtetuese, si dhe standardet për rregullatorët e sektorit të transmetimit, për të siguruar pavarësinë e KPM-së ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë (a) procedurat e shkarkimit e Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së duhet të jenë të qarta; (b) shkarkimi duhet të jetë i mundur në raste serioze të përcaktuara qartë në ligj; dhe (c) vendimi për shkarkim duhet të jetë subjekt i vendimit përfundimtar gjyqësor.
256. Prandaj, në vijim Gjykata do të vlerësojë nëse (i) anëtarët KPM-së në rast shkarkimi kanë mundësi që të kontestojnë vendimin për shkarkimin e tyre para institucioneve gjyqësore;

dhe (ii) nëse kriteret për shkarkim të përcaktuara në Ligjin e kontestuar janë qartë të përcaktuara.

257. Bazuar në të lartcekurat, sa i përket mundësisë që një anëtar i të shkarkuar t'i ofrohet mbrojtje gjyqësore për të sfiduar arsyet e shkarkimit, ashtu siç rezulton nga praktika gjyqësore e Gjykatës (i) kryetari/anëtarët i KPM-së që shkarkohet, mund të kontestojë vendimin për shkarkim në procedurë gjyqësore; dhe (ii) një vendimmarrje e tillë mund të kontestohet edhe para Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 113 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se ajo ka trajtuar rastet kur janë kontestuar para saj vendimet e Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të institucioneve të pavarura, me ç' rast Gjykata ka konstatuar se (i) ligjshmëria e një vendimmarrje të tillë, mund të kontestohet nga palët e autorizuar para gjykatave të rregullta; dhe (ii) kushtetutshmëria e atyre vendimeve po ashtu mund të kontestohen në Gjykatë nga palët e autorizuar, siç janë deputetët e Kuvendit sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
258. Këto raste përfshijnë rastet (i) [KO127/21](#), cituar më lart, në të cilin Gjykata kishte konstatuar se Kuvendi duke shkarkuar (5) pesë anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në mënyrë kolektive dhe pa shtjellimin e asnjë fakti e të bazuar në ligj, por vetëm me arsyetimin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës “nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes”, përkatësisht për shkak të vendimmarrjes së tyre në raste konkrete, për të cilën anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës gëzojnë pavarësi dhe imunitet nga shkarkimi dhe e cila vendimmarrje, për më tepër, i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ, ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike, të përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës; (ii) [KO134/21](#), cituar më lart, ku Gjykata konstatoi që në shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së, përkatësisht shkarkimin kolektiv të bordit të transmetuesit publik për “paaftësi profesionale”, të konstatuar përmes shqyrtimit të Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020, Kuvendi ka vepruar pa bazë ligjore në kontekst të shkarkimit të Bordit në tërësinë e tij, si pasojë e refuzimit të raportit përkatës vjetor dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për RTK-në; dhe (iii) [KO157/23](#), parashtruesit: *Vlora Dumoshi dhe 11 deputetë tjerë*, Aktgjykim i 17 majit 2024, ku Gjykata gjeti se as Qeveria dhe as Kuvendi nuk kanë dhënë asnjë arsyetim lidhur me cenimin e pretenduar të “etikës profesionale” të anëtares së OSHP-së, bazë kjo mbi të cilën ishte bërë propozimi dhe shkarkimi i saj, dhe si pasojë kishte konstatuar shkelje kushtetuese përkitazi me vendimin e Kuvendit për shkarkimin e saj.
259. Ndërsa, në anën tjetër, përkitazi me rastin [KO139/21](#) parashtruesit: *Fadil Nura dhe 9 deputetë tjerë*, Aktgjykim i 5 prillit 2023, në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh specifikat e Ligjit nr. 04/L -063 për Hekurudhat e Kosovës, Gjykata vlerësoi që Kuvendi në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, duke shkarkuar pesë (5) anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, nuk kishte tejkaluar kufijtë e funksionit të saj mbikëqyrës sipas paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, përkatësisht kufijtë e përcaktuar në vet ligjin e miratuar nga Kuvendi, përkatësisht Ligjin nr. 04/L -063 për Hekurudhat e Kosovës. Ngjashëm, Gjykata ka vlerësuar edhe në rastin [KO283/23](#), parashtrues: *Abelard Tahiri dhe 9 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 26 nëntorit 2024, ku Gjykata kishte konstatuar se Kuvendi kishte ushtruar rolin e tij ndërlidhur me anëtarët joprokurorë të Këshillit Prokurorial, dhe ka shkarkuar një anëtarë joprokuror bazuar në procedurën dhe bazat e shkarkimit sipas përcaktimeve të Ligjit për Këshillin Prokurorial, përfshirë mbi bazën e një arsyetimi që nuk rezulton të jetë arbitrar.

260. Sa i përket përcaktueshmërisë me Ligjin e kontestuar të kritereve për shkarkim, Gjykata thekson se “*përcaktueshmëria me ligj*”, përveç që kërkon që masa e ndërmarrë duhet të ketë bazë ligjore në legjislacionin shtetëror, kërkon gjithashtu që dispozitat relevante të ligjit të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*”. “*Parashikueshmëria*”, bazuar në parimet e lartcekura, kërkon që ligji të formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre (shih, ndër të tjera, Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, [CDL-Ad\(2016\)007](#), miratuar më 18 mars 2016, paragrafët 58 dhe 59; dhe rastet e Gjykatës KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 347).
261. Në ndërlidhje me rastin konkret, Gjykata vëren se procedura për shkarkim e përcaktuar me Ligjin e kontestuar (i) është e përcaktuar qartë me ligj, dhe në harmoni me nenin 80 të Kushtetutës, me ç’ rast kryetari/anëtari i KPM-së mund të shkarkohet pas propozimit të Komisionit parlamentar përgjegjës për media, dhe me shumicën e thjeshtë të votave në Kuvend.
262. Për më tepër, (ii) shkarkimi i kryetarit apo anëtarit të KPM-së mund të bëhet vetëm për arsyet e përcaktuara specifkisht përmes paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar.
263. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesit kontestojnë qartësinë edhe parashikueshmërinë e kriterit për shkarkim të përcaktuar në nënparagrafin 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht sa i përket humbjes së besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit.
264. Në këtë kontekst, çështja e integritetit, si kriter për shkarkim, dhe formulimi i përdorur ka qenë objekt i shqyrtimit nga Gjykata edhe në kuptim të amendamenteve kushtetuese të shqyrtuara nga Gjykata përmes kërkesës [KO55/23](#), parashtrues *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 2 mars 2023, përmes shkresës nr. 8/3509/Do/1493/1, Aktgjykim i 22 dhjetori 2023, sa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjykata në rastin KO55/23, ka arritur në përfundim se formulimi “*ka integritet të cënueshëm*”, si bazë e përhershme e shkarkimit të gjyqtarit dhe/ose prokurorit, karakterizohet me mungesë të përkufizimit të “*qartë*” dhe të “*parashikueshëm*”.
265. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se në bazë të gjuhës së përdorur në këtë dispozitë, nënparagrafi 3.5 i paragrafit 3 i nenit 18 përdor kriterin për shkarkim “*humbje e besimit*” në ndërlidhje me “*cenimin e integritetit*” ose “*qëndrimeve të anshme*” të anëtarit të KPM-së. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se si të tilla, këto kritere, të marra së bashku karakterizohen me mungesë qartësie sa i përket plotësimit të tyre në mënyrë që një anëtar i KPM-së të mund të shkarkohet.
266. Prandaj, nënparagrafit 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, i mungon qartësia sa i përket “*cenimit të integritetit*”, por edhe formulimit për “*qëndrimet e anshme në favor të një pale të licencuar*”, pasi të njëjtat në mungesë të një formulimi të qartë, mundësojnë vlerësim subjektiv në raport me anëtarët e KPM-së, pa definuar qartë me ligj se cilat veprime do të rezultojnë në shkelje të tilla dhe, për më tepër, duke përdorur formulimin “*humbje e besimit nga organi mbikëqyrës*”. Kjo sjellë pasiguri juridike për anëtarët e KPM-së, dhe ndikon në pavarësinë e tyre si anëtarë të KPM-së.
267. Në ndërlidhje me kriterin për shkarkim të përcaktuar në nënparagrafin 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, Gjykata gjithashtu i referohet edhe nënparagrafit 3.4 të

paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, sipas të cilit një anëtar i KPM-së mund të shkarkohet edhe për *“marrje pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje”*.

268. Gjykata vlerëson se edhe këtij kriteri për shkarkim i mungon qartësia dhe mundëson vlerësim subjektiv në raport me anëtarët e KPM-së, pa definuar qartë me ligj se cilat veprime do të rezultonin në shkelje të tilla. Gjykata bazuar edhe në praktikën gjyqësore të referuar më lart, veçanërisht nën dritën e rasteve të Gjykatës KO127/21, KO134/21 dhe KO157/23, vlerëson se formulimi i përcaktuar në paragrafin 3.4 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, sjellë në pasiguri juridike për anëtarët e KPM-së sa i përket marrjes pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje.
269. Prandaj, Gjykata vlerëson se kriteret për shkarkim të përcaktuara në nënparagrafët 3.4 dhe 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar (i) cenojnë sigurisë juridike në kuadër të parimit të sundimit të ligjit të garantuar me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe pavarësinë e anëtarëve dhe të KPM-së të garantuar me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës.
270. Gjykata gjithashtu vëren se nënparagrafi 3.8 i paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar përcakton edhe mundësinë e shkarkimit në rast se një anëtar i KPM-së mungon *“në punë mbi pesëmbëdhjetë (15) ditë pa arsye”*. Përderisa formulimi i tillë për mungesë mbi pesëmbëdhjetë (15) ditë, është i qartë, Gjykata thekson se formulimi *“pa arsye”* duhet të vlerësohet bazuar në kritere objektive përfshirë dëshmitë përkatëse.
271. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, Gjykata konstaton se nënparagrafët 3.4 dhe 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenin 141 [Këshilli i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës dhe nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës.

III. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nënparagrafit 2.21, të paragrafit 2, të nenit 4 (Kompetencat e KPM-së) të Ligjit të kontestuar përkitazi me Këshillin e Ankesave

A. Pretendimet dhe kundër-argumentet e palëve

272. Gjykata fillimisht sqaron se neni 4 i Ligjit të kontestuar përcakton në paragrafin 1 se KPM është organ i pavarur, përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcakton kompetencat e KPM-së të cilat, ndër të tjera, përfshijnë, kompetencën e përcaktuar në nën-paragrafin 2.21 të paragrafit 2 të këtij neni, sipas të cilit KPM themelon Këshillin e Ankesave që trajton ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, si dhe harton e miraton rregulloren e funksionimit të këtij këshilli.
273. Parashtruesit e kërkesave në thelb pretendojnë që Ligji i kontestuar, duke përcaktuar në nënparagrafin 2.21, të paragrafit 2, të nenit 4, se Këshilli i Ankesave themelohet nga vetë KPM, dhe duke mos përcaktuar, përbërjen, detyrat dhe efektet e vendimmarrjes, ka cenuar të drejtën për mjete juridike të garantuar nenin 32 të Kushtetutës, pasi Këshilli i Ankesave ashtu siç përcaktohet në Ligjin e kontestuar, nuk mund të bëjë vlerësimin e paanshëm të ankesave ndaj vendimeve të KPM-së dhe nuk mund të jetë efektiv në kuptim të së drejtës për mjete juridike.

274. Këto pretendime mbështeten nga AGK, të cilët theksojnë se (i) ligji në fuqi për KPM-në i vitit 2012, që ka përcaktuar themelimin e Bordit të Ankesave, përmban nëntë nene që rregullojnë në mënyrë të detajuar çështjen lidhur me ankesat kundër vendimeve të KPM-së, për dallim nga Ligji i kontestuar që nuk përmban fare Bordin e Ankesave, duke e eliminuar në tërësi këtë mekanizëm të brendshëm korrigjues; dhe për më tepër (ii) bazuar në paragrafin 1, nënparagrafin 2.21 përmes Ligjit të kontestuar, rezultojnë se vendimet e KPM-së do t'i nënshtrohen rishikimit administrativ nga një organ i caktuar nga vetë KPM dhe që ka një funksion subordinues ndaj KPM-së, duke shkelur të drejtën për mjete juridike të garantuar nën 32 të Kushtetutës. Pretendimet e parashtresve të kërkesave kundërshtohen nga Qeveria pasi sipas tyre (i) neni 32 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën e ankesës përmes procedurës administrative, përderisa një e drejtë e tillë është e garantuar me ligj para gjykatave; dhe (ii) Bordi i Ankesave ndaj vendimeve të KPM-së nuk është kategori kushtetuese dhe për të sfiduar vendimet e KPM-së mund të iniciohet proces gjyqësor në gjykata dhe se një qasje e tillë është përcaktuar edhe sa i përket vendimeve të institucioneve të tjera të pavarura.

B. Vlerësimi i Gjykatës

275. Gjykata vëren se për dallim nga Ligji i kontestuar, Ligji i cili është aktualisht në fuqi përkritazi me KPM-në përfshin një kapitull të veçantë, përkatësisht Kreun VI (Bordi për Ankesa) i cili përcakton përgjegjësitë, përbërjen, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit, papajtueshmërinë e funksionit, mandatin, shkarkimin, procedurën dhe vendimmarrjen e saj. Bazuar në nenin 36 (Përgjegjësitë) të Ligjit të vitit 2012, përkatësisht paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, Bordi i ankesave është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe se i njëjti shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit për sa i përket, ndër të tjera, lejeve transmetuese, shqiptimit të sanksioneve dhe çështjeve tjera që mbështeten në aktet nënligjore. Prandaj, për dallim nga Ligji i vitit 2012, Ligji i kontestuar ka themeluar një organ tjetër që dallon nga Bordi i Ankesave, përkatësisht (i) Këshillin e Ankesave, me kompetencën për të (ii) trajtuar ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit, (iii) bazuar në rregulloren mbi funksionin e Këshillit të Ankesave të nxjerrë nga KPM.
276. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, Ligji i kontestuar nuk përcakton bord të ankesave, këshill të ankesave apo organ tjetër, që trajton ankesat e palëve ndaj vendimeve që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimmarrjes së KPM-së.
277. Kjo pasi, Gjykata vëren se nga leximi i paragrafit 2, nënparagrafit 2.21 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar rezultojnë se Këshilli i Ankesave i përcaktuar në këtë dispozitë është organ që (i) trajton ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit; (ii) në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore; përderisa (iii) rregulloren e funksionimit të këtij Këshilli e miraton vetë KPM.
278. Andaj, siç rezultojnë nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.21 i nenit 4 të Ligjit të kontestuar, Këshilli i Ankesave është organ i brendshëm i KPM-së që trajton dhe ndihmon Këshillin përkritazi me ankesat e palëve ndaj/në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit dhe vendimmarrjen e KPM-së sa i përket këtyre ankesave. Këshilli i ankesave, sipas paragrafit 2, nënparagrafi 2.21 i nenit 4 të Ligjit të kontestuar, nuk është organ që trajton ligjshmërinë e vendimeve të KPM-së bazuar në ankesat e të licencuarave/regjistruarave.

279. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se sipas pikës 33 të Memorandumi Shpjegues të Rekomandimit (2000) 23 të Këshillit të Evropës *“autoritet rregullatorë duhet, brenda kornizës ligjore, të kenë kompetencën për të nxjerr akte të brendshme për të definuar organizmin dhe vendimmarrjen më në detaje, në pajtim me autonominë e tyre organizative.”*
280. Siç është sqaruar më sipër, përderisa Ligji i vitit 2012, ka përcaktuar Bordin për Ankesa i cili shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit për sa i përket, ndër të tjera, lejeve transmetuese, shqiptimit të sanksioneve dhe çështjeve tjera që mbështeten në aktet nënligjore, Ligji i kontestuar nuk ka përcaktuar ndonjë organ të veçantë që shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit të KPM-së, por ka referuar ankesat kundër vendimmarrjes së KPM-së për shqyrtimin e gjykatave kompetente.
281. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet nenit 39 (Shkeljet e kushteve të lejes) që, ndër të tjera, përcakton në paragrafët 2, 3 dhe 4 se (i) KPM-ja shqyrton ankesat që pretendojnë shkeljen e kushteve të lejes, kodit të etikës dhe akteve të tjera; (ii) KPM përmes Zyrës Ekzekutive, njofton me shkrim subjektin transmetues për çdo pretendim lidhur me shkeljen e kushteve të lejes, kodit të etikës dhe akteve të tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj, dhe siguron që subjekti transmetues të ketë mundësi efektive për të paraqitur deklaratat e tij; dhe (iii) KPM nxjerr vendim bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit përkatës. Në këtë aspekt, pas vendimmarrjes së KPM-së, bazuar në paragrafin 5 të nenit 39 të Ligjit të kontestuar, (iv) të licencuarit nga KPM kanë të drejtë ankese në gjykatën kompetente, lidhur me lejen, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të KPM-së.
282. Gjykata po ashtu i referohet edhe paragrafit 2 të nenit 61 (Sanksionet tjera) që përcakton se vendimi i KPM-së për të shqiptuar një apo më shumë nga sanksionet e përcaktuara në këtë kapitull, është përfundimtar në procedurë administrative.
283. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se bazuar në dispozitat e lartcekura, Ligji i kontestuar nuk ka përcaktuar trupë brenda KPM-së që trajton ankesat e të licencuarave/regjistruarave ndaj vendimeve të KPM-së. Megjithatë, Ligji i kontestuar ka përcaktuar që drejtën që vendimet e KPM-së të sfidohen para gjykatave kompetente përkitazi me ligjshmërinë e tyre, ashtu siç rezulton nga paragrafi 5 i nenit 39 të Ligjit të kontestuar dhe nga paragrafi 2 i nenit 61 të Ligjit të kontestuar.
284. Në kontekst të këtyre përcaktimeve, Gjykata i referohet edhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili në nenin 13 (Parimi i të drejtës në mjete juridike) përcakton se *“Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik.”* I njëjti ligj, në paragrafin 6 të nenit 124 (Legjitimitimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative), përcakton se shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, megjithatë, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, ndër të tjera, nëse parashikohet shprehimisht me ligj. Rrjedhimisht, bazuar në Ligjin për Procedurën Administrative, ligji i veçantë, sikur në rrethanat e rastit konkret, mund të përcaktojë që ndaj një organi administrativ, mund të kërkohet mbrojtje gjyqësore drejtpërdrejt në gjykatë.

285. Gjykata po ashtu rikujton se Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, në fuqi në kohën e miratimit të Ligjit të kontestuar (në tekstin e mëtejme: LKA nr. 03/L-202), ka përcaktuar mjete juridike efektive për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative. Siç ka sqaruar Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, vet qëllimi i LKA-së nr. 03/L-202, siç përcaktohet në nenin 2 (Qëllimi) është të sigurojë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë dhe palëve të tjera, të cilëve u janë shkelur të drejtat dhe interesat me: (i) aktet individuale; ose (ii) veprimet e organeve të administratës publike. Më tutje bazuar në nenin 3, paragrafin 1.1 të LKA-së nr. 03/L-202 përcaktohet se organet e administratës publike janë organe të administratës qendrore, ndërsa paragrafi 1.2 i të njëjtit e cilëson si akt administrativ çdo vendim të organit administrativ të nxjerrë pas procedurës administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi cenon të drejtat, liritë apo interesat e personave fizikë dhe juridikë të njohura ligjërisht. Përveç dispozitës me të cilën përcaktohet qëllimi i ligjit, më konkretisht neni 10 i LKA-së nr. 03/L-202, ndër të tjera, parashikon mundësinë e fillimit të një konflikti administrativ kundër akteve për të cilat një person fizik ose juridik konsideron se është shkelur një e drejtë ose interes ligjor. (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI214/21](#), me parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykimi i 7 dhjetorit 2022, paragrafët 115 dhe 116).
286. Ngjashëm edhe Ligji nr. 08/L-182 për Konflikte Administrative, që ka hyrë në fuqi në janar 2025 (në tekstin e mëtejme: LKA nr. 08/L-182), në nenin 1 (Qëllimi) po ashtu përcakton se qëllimi i të këtij ligji është që *“të sigurojë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të subjekteve të së drejtës kundër veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të kryera gjatë ushtrimit të autoritetit publik si dhe ligjshmërinë në ushtrimin e këtij autoriteti.”* Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 17 (Shterimi i mjeteve juridike administrative të rregullta) të Ligjit të lartcekur përcakton në paragrafin 1 se *“Padia e anulimit, padia për nxjerrjen e një akti dhe padia ndaj veprimit tjetër administrativ, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të mjeteve juridike administrative të rregullta, sipas ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.”* Ndërsa, në paragrafin 2 përcakton se përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, padia mund të paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në rastet kur (i) nuk ekziston organi epror në procedurë administrative; (ii) palës së tretë i janë cenuar të drejtat, apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën; (iii) parashikohet shprehimisht me ligj.
287. Andaj, Gjykata përsërit se Ligji i kontestuar nuk ka përcaktuar ndonjë organ të veçantë që shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së apo që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit të KPM-së. Megjithatë, siç rezulton nga paragrafi 5 i nenit 39 të Ligjit të kontestuar, paragrafi 2 i nenit 61 i Ligjit të kontestuar, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe legjislacioni në fuqi për konflikte administrative, çdo person i cili është i prekur drejtpërdrejt nga vendimmarrja e KPM-së ka të drejtë që të kontestojë ligjshmërinë e vendimmarrjes në fjalë para gjykatave kompetente.
288. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse një përcaktim i tillë përmes Ligjit të kontestuar që vendimmarrja e KPM-së mund të jetë subjekt i vlerësimit të ligjshmërisë para gjykatave të rregullta, por që nuk përcakton mjet ankese në procedurë administrative, cenon dispozitat kushtetuese përfshirë të drejtën për mjet juridik të garantuar me Kushtetutë.
289. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht i referohet nenit 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës, që përcakton në paragrafin 1 se Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës,

- licencon transmetuesit publikë dhe privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit, si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 2 të nenit 141 të Kushtetutës që përcakton se anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhën sipas ligjit, përmes një procesi transparent.
290. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se neni i lartcekur i Kushtetutës (i) përcakton KPM-në si organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publikë dhe privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit. Ndërsa i njëjti determinon rregullimin përmes ligjit të (ii) kompetencave të tjera të KPM-së që nuk u cekën më lart; dhe (iii) zgjedhjen e anëtarëve të KPM-së, me kushtin që procesi për zgjedhjen e tyre të jetë transparent.
291. Me fjalë të tjera, neni 141 i Kushtetutës detyron themelimin e KPM-së si organ të pavarur dhe përcakton rregullimin përmes ligjit të, ndër të tjera, të mënyrës së zgjedhjes (me kushtin që procesi të jetë transparent) dhe kompetencat e tjera të KPM-së. Për më tepër, neni 141 i Kushtetutës është i heshtur në raport me mënyrën e vendimmarrjes brenda KPM-së, përfshirë të drejtën për mjete juridike në procedurë administrative. Andaj, i njëjti nuk përcakton detyrimisht themelimin e ndonjë organi ankimor brenda KPM-së, që trajton ligjshmërinë e vendimmarrjes së KPM-së.
292. Në këtë kontekst, dhe duke iu referuar pretendimeve të parashtruesve sa i përket të drejtës për mjete juridike, përkatësisht pretendimit se palët që afektohen me vendimet e KPM-së janë zhveshur nga mundësia që të përdorin në mënyrë efektive mjetet juridike përmes ankesës brenda KPM-së dhe përmes gjykatave, Gjykata rikujton nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. I pari përcakton që: *“secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*; ndërsa i dyti, që *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*.
293. Ashtu siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe e cila bazohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim dhe në tërësinë e tyre, neni 54 i Kushtetutës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 32 i Kushtetutës për të drejtën në mjet juridik dhe neni 13 i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ-në (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI48/18](#), parashtrues: *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 198 dhe Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), cituar më lart, paragrafi 346).
294. Prandaj, sipas të lartcekurave, përderisa mbrojtja gjyqësore përkitazi me vendimet administrative është e siguruar, dhe siç rezulton nga dispozitat e lartcekura kushtetuese e ligjore, përfshirë Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cilat jo domosdoshmërisht kërkojnë të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të KPM-së në nivel administrativ, nëse një gjë e tillë përcaktohet me ligj, siç është rasti konkret, nuk mund të kërkohej detyrimisht që të sigurohet mundësi ankese në nivel administrativ.

295. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se në rastin konkret, pavarësisht se Ligji i kontestuar nuk ka përcaktuar mjete juridike ndaj vendimeve të KPM-së brenda vet KPM-së, neni 141 i Kushtetutës nuk kërkon specifikisht që një organ i tillë ankimor të jetë pjesë përbërëse e KPM-së, përderisa siç rezulton nga neni 39 dhe neni 61 i Ligjit të kontestuar, dhe dispozitat relevante të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Konflikt Administrativ, çdo vendimmarrje e KPM-së mund të kontestohet nga palët e afektuara para gjykatave kompetente, për të vlerësuar ligjshmërinë e një vendimmarrje të tillë.
296. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nënparagrafi 2.21, i paragrafit 2 i nenit 4 të Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

IV. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 10 (Edukimi medial) dhe nenit 12 (Politika e transmetimit) të Ligjit të kontestuar

A. Pretendimet dhe kundërgargumentet e palëve

297. Gjykata fillimisht rikujton se sipas paragrafit 1 të nenit 10 (Edukimi medial) të Ligjit të kontestuar, (i) KPM përgatit materiale tekstuale, animacione, video dhe forma tjera të komunikimit për të promovuar edukimin medial, ndërsa paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni obligojnë (ii) transmetuesin publik që materialet e edukimit medial t'i transmetojë së paku një herë në javë në kohën prime sipas rekomandimeve të KPM-së me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë, dhe të gjitha kanalet gjeneralistike që të transmetojnë materialet e edukimit medial së paku një herë në muaj me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë; (iii) transmetuesi publik dhe kanalet tjera gjeneralistike të shfaqin emisione ose debate në funksion të edukimit medial së paku një herë në tre (3) muaj. Për më tepër, paragrafi 7 i nenit 12 (Politika e transmetimit) i Ligjit të kontestuar përcakton që KPM siguron, aty ku është e mundur dhe me mjetet e duhura, që (i) transmetuesit rezervojnë të paktën dhjetë përqind (10%) të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping, ose me radhë, (ii) të paktën dhjetë përqind (10%) të buxhetit të tyre programor për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit
298. Parashtruesit e kërkesave përkitazi me nenin 10 (Edukimi medial) dhe nenin 12 (Politika e transmetimit) të Ligjit të kontestuar, që detyrojnë (i) transmetuesin publik – Radio Televizionin e Kosovës dhe të gjitha kanalet gjeneralistike që të transmetojnë materiale të edukimit medial, si dhe të shfaqin emisione ose debate në funksion të edukimit medial; dhe (ii) transmetuesit të rezervojnë një përqindje të kohës së transmetimit ose një përqindje të buxhetit të tyre për *“veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarura nga transmetuesi”*, pretendojnë se janë në kundërshtim me lirinë e mediejeve të garantuar me nenin 42 [Liria e Mediave] të Kushtetutës. Këto pretendime kundërshtohen nga Qeveria duke theksuar se dispozitat e lartcekura nuk përbëjnë ndërhyje në politikat editoriale, por këto dispozita përcaktojnë obligimin që KPM-së që të promovojë edukimin medial dhe për më tepër, përbën transpozim të Direktivës për Shërbimet e Mediave Audiovizuale të BE-së 2010/13, e 10 marsit 2010, e ndryshuar përmes Direktivës 2018/1808 të 14 nëntorit 2018, e cila kërkon që transmetuesit të orientojnë një pjesë të buxhetit ndaj veprave evropiane të krijuara nga producentët e pavarur nga transmetuesi.

B. Vlerësimi i Gjykatës

299. Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesave pretendojnë se dispozitat e lartcekura të Ligjit të kontestuar cenojnë lirinë e medieve të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në kontekst të këtij pretendimi, Gjykata thekson se neni 42 i Kushtetutës përmban 3 paragrafë. Paragrafi 1 i këtij neni (i) garanton lirinë dhe pluralizmin e medieve. Paragrafi 2 i këtij neni (ii) përcakton se censura është e ndaluar dhe se askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Përderisa paragrafi 3 i nenit 42 të Kushtetutës përcakton se (iii) çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin. Për më tepër, Gjykata rikujton se neni 42 i Kushtetutës është i ndërlidhur edhe me nenin 40 [Liria e Shprehjes], i cili në paragrafin 1 përcakton: *“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”*. Përderisa paragrafi 2 i të njëjtit përcakton kufizimet e mundshme duke theksuar specifikisht se *“Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”*.
300. Në kontekst të të drejtave të lartcekura dhe në dritën e pretendimeve të parashtuesve të kërkesës për kundërkushtetutshmërinë e këtij neni, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

- “1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*
- 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*
- 3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*
- 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*
- 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar”*.

301. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata thekson se testi i nenit 55 të Kushtetutës, përcakton se kufizimi i një të drejte ose lirie: (i) mund të bëhet vetëm me *“ligj”*; (ii) duhet të ketë një *“qëllim legjitim”*; (iii) duhet të jetë i *“domosdoshëm dhe proporcional”*; dhe (iv) duhet të jetë *“i nevojshëm në një shoqëri demokratike”*. Të gjitha këto kritere duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që një kufizim të arsyetohet. Për qëllime interpretative të këtyre nocioneve dhe koncepteve, Gjykata thirret në faktin që edhe GJEDNJ përdorë të tilla teste për të vendosur se në një rast konkret a ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me KEDNJ-në (shih rastin [KO54/20](#), parashtues, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafi 198; shih, *mutatis mutandis*, po ashtu rastin e Gjykatës [KO93/21](#) parashtues, *Blerta Deliu-Kodra*

dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2021, paragrafët 287-299).

302. Ndërsa sa i përket KEDNJ-së, Gjykata, siç ka theksuar tek parimet e përgjithshme, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë sipas nenit 53 të Kushtetutës, çështja e pluralizmit të medieve audiovizuele trajtohet në kuadër të lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 10 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk mund të ketë demokraci pa pluralizëm (shih rastin e GJEDNJ-së [Centro Europa 7 S.R.L. dhe Di Stefano kundër Italisë](#), nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012, paragrafi 129).
303. Gjithashtu, sipas GJEDNJ-së, por edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, të ushtruarit e lirisë së shprehjes në mënyrë efektive dhe kuptimplotë, nuk kushtëzohet vetëm nga obligimi për mosndërhyrje nga ana e shtetit, por gjithashtu nga obligimi pozitiv i shtetit për të siguruar masa pozitive të mbrojtjes, përmes ligjit dhe praktikës. Prandaj, GJEDNJ thekson se, duke pasur parasysh rëndësinë e asaj që mbrohet përmes nenit 10 të KEDNJ-së, shteti duhet të jetë garantuesi përfundimtar i pluralizmit (shih rastin e GJEDNJ-së [Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë](#), nr. 13936/02, Aktgjykim i 17 shtatorit 2009, paragrafi 99; dhe rastin e Gjykatës [KO134/21](#), parashtrues *Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 gushtit 2023, paragrafi 133).
304. Gjykata gjithashtu i referohet edhe [Përmbledhjes së Opinioneve të Komisionit të Venecias përkitazi me Lirinë e Shprehjes dhe Mediat](#), CDL-PI(2020)008, të 7 korrikut 2020, sipas së cilit (i) pluralizmi i medieve mund të konsiderohet si një aspekt i lirisë së shprehjes dhe e njëjta arrihet kur ka shumësi të medieve autonome dhe të pavarura në nivel kombëtar, regional dhe lokal, që sigurojnë varietete të përmbajtjes që të reflektojnë pikëpamje të ndryshme politike dhe kulturore (faqe 7); (ii) shteti është garantuesi përfundimtar i pluralizmit, veçanërisht sa i përket medieve audiovizuele programet e të cilave zakonisht transmetohen gjerësisht (faqe 18); (iii) zhvillimi në fushën e shërbimeve të reja të komunikimit mund të qojë në krijimin e pozitës dominuese në treg dhe se sa i përket transmetimit digjital, shteteve u kërkohet të krijojnë rregulla sa i përket qasjes në sistem dhe shërbime fer, transparente dhe jodiskriminuese (faqe 19); (iv) vlerësimi i masës së koncentrimit që bazohet në ndarjen e kanaleve apo programeve, nuk mund të jetë e dobishme për të përcaktuar pozicionin e një kompanie në radion nacionale apo tregun televiziv (faqe 20).
305. GJEDNJ ka theksuar se për të siguruar pluralizëm të vërtetë sa i përket sektorit audiovizuel, nuk është e mjaftueshme që të kemi disa kanale apo që të kemi mundësinë teorike për operatorët potencialë që të qasen në tregun audiovizuel. Por në këtë aspekt, është e nevojshme që për më tepër të lejohen qasje efektive në treg në mënyrë që të garantohet diversiteti i përgjithshëm në përmbajtjen programore, që reflekton atë që është e mundur varietete të opinioneve që haset në shoqëri tek e cila programi drejtohet (shih rastin [Centro Europa 7 S.R.L. dhe Di Stefano kundër Italisë](#), cituar më lart, paragrafi 130).
306. Për më tepër dhe në raport me promovimin e diversitetit përmbajtësor, Gjykata i referohet edhe [Rekomandimit CM/Rec\(2007\)2](#) të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, i miratuar më 31 janar 2007, i cili në Kapitullin II (Masat për promovimin e diversitetit përmbajtësor), në pikën 1, ndër të tjera, përcakton se shtetet anëtare duhet të “*miratojnë masat e nevojshme për të siguruar që informatat e varietetit*

të duhur, opinioneve dhe programeve shpërndahen nga mediat dhe janë të qasshme për publikun”. Gjithashtu, në pikën 2.1 të këtij Kapitulli përcaktohet se, “Shtetet anëtare duhet, duke respektuar parimin e pavarësisë editoriale, të inkurajojnë mediat të shfaqin publikut përmbajtje mediale diverse për promovimin e debatit kritik pjesëmarrjen e gjerë demokratike të personave që i përkasin të gjitha komuniteteve dhe gjeneratave”.

307. Gjykata gjithashtu thekson se Direktiva bazë AVMS 2010/13 ka për qëllim të krijoj dhe siguroj funksionimin e duhur të tregut të vetëm të Bashkimit Evropian sa i përket shërbimeve audiovizuele, përderisa kontribuon në promovimin e dallimeve kulturore, duke krijuar nivel adekuat të mbrojtjes së konsumatorëve dhe fëmijëve. E njëjta përcakton rregulla sa i përket, transmetimit televiziv tradicional dhe shërbimeve të medieve audiovizuele sipas kërkesës.
308. Gjykata gjithashtu vëren se neni 17 i Direktivës AVMS përcakton se: *“Shtetet anëtare sigurojnë, aty ku është e praktikueshme dhe me mjetet e duhura, që transmetuesit rezervojnë të paktën 10% të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping, apo në mënyrë aleterantive në diskreconin e shteteve anëtare, të paktën 10% të buxhetit të tyre programor për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit. Ky proporcion, duke pasur parasysh përgjegjësitë informative, arsimore, kulturore dhe argëtuese të transmetuesit ndaj publikut të tij shikues, duhet të arrihet në mënyrë progresive, mbi bazën e kritereve të përshtatshme. Kjo arrihet duke caktuar një proporcion të përshtatshëm për veprat e fundit, si veprat e transmetuara brenda pesë (5) viteve nga prodhimi i tyre”.*
309. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata i referohet sërish nenit 10 (Edukimi medial) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton në paragrafin 1 se (i) KPM përgatit materiale tekstuale, animacione, video dhe forma tjera të komunikimit për të promovuar edukimin medial, ndërsa në paragrafët 2 dhe 3 obligojnë (ii) transmetuesin publik që materialet e edukimit medial t'i transmetojë së paku një herë në javë sipas rekomandimeve të KPM-së me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë, duke vënë theksin *“në kohën prime”*; (iii) të gjitha kanalet gjeneralistike që të transmetojnë materialet e edukimit medial së paku një herë në muaj me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë; dhe përmes paragrafit 4 të nenit të lartcekur që (iv) transmetuesi publik dhe kanalet tjera gjeneralistike të shfaqin emisione ose debate në funksion të edukimit medial së paku një herë në tre (3) muaj.
310. Për më tepër, neni 12 (Politika e transmetimit) i Ligjit të kontestuar përcakton në paragrafin 1 se politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM obligohet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut, përderisa në paragrafët 2, 3, dhe 4, të nenit 12 të Ligjit të kontestuar përcaktohen politikat e transmetimit, përfshirë që KPM siguron që programet të përmbajnë dhe pasqyrojnë barazi ndërmjet qytetarëve të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ndërsa, në anën tjetër, paragrafi 7 i nenit 12 të Ligjit të kontestuar, i cili kontestohet para Gjykatës, përcakton që KPM siguron, aty ku është e mundur dhe me mjetet e duhura, që (i) transmetuesit rezervojnë të paktën dhjetë përqind (10%) të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping, ose me radhë, (ii) të paktën dhjetë përqind (10%) të buxhetit të tyre programor për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit. Sipas të njëjtës dispozitë, ky proporcion, duke pasur parasysh përgjegjësitë informative, arsimore, kulturore dhe argëtuese të transmetuesit ndaj publikut

të tij shikues, duhet të arrihet në mënyrë progresive, mbi bazën e kritereve të përshtatshme. Sipas kësaj dispozite, kjo arrihet duke caktuar një proporcion të përshtatshëm për veprat e fundit, si veprat e transmetuara brenda pesë (5) viteve nga prodhimi i tyre. Gjykata po ashtu vëren se sipas paragrafit 8 të nenit 12 të Ligjit të kontestuar, detyrimi nga paragrafi 7 i këtij neni nuk vlen për ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele me mbulim tokësor lokal dhe rajonal dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele tematike.

311. Prandaj, Gjykata gjithashtu vëren se neni 12 i Ligjit të kontestuar përcakton detyrimin për KPM-në që të sigurohet që (i) brenda një periudhe progresive, dhe (ii) aty ku është e mundur dhe me mjetet e duhura, që (iii) transmetuesit të rezervojnë (a) të paktën dhjetë përqind (10%) të kohës së tyre të transmetimit, duke përfshirë kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshoping, ose me radhë, (b) të paktën dhjetë përqind (10%) të buxhetit të tyre programor, për *“veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit”*.
312. Bazuar në të lartcekurat rezulton se, sipas neneve 10 dhe 12 të Ligjit të kontestuar, (i) transmetuesi publik dhe kanalet gjeneraliste obligohen që së paku një herë në javë, përkatësisht një herë në muaj me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë, të transmetojnë materialet e edukimit medial të përgatitur nga KPM; si dhe së paku një herë në tre (3) muaj të shfaqin emisione ose debate në funksion të edukimit medial; si dhe (ii) transmetuesit një përqindje të programit të tyre ose buxhetit ta rezervojnë për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit.
313. Prandaj, në rastin konkret, duhet vlerësuar nëse (i) obligimi për transmetuesit për shfaqjen e materialeve edukative të përgatitura nga KPM si dhe për të treguar shfaqje dhe debate në funksion të edukimit medial; si dhe (ii) obligimin që, në një periudhë të caktuar kohore ose nëpërmjet një rezervimi buxhetor, transmetuesit kanë për obligim të shfaqin *“veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarura nga transmetuesit”*, përbëjnë kufizim të pluralizmit të mediave apo censurë sa i përket shpërndarjes së informacionit apo ideve në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 42 të Kushtetutës.
314. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se masat e ndërmarra, të cilat janë të përcaktuara përmes nenit 10 dhe 12 të Ligjit të kontestuar, dhe që përfshijnë obligimin që (i) transmetuesi publik dhe kanalet gjeneraliste së paku një herë në javë përkatësisht një herë në muaj me kohëzgjatje nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë të transmetojnë materialet e edukimit medial të përgatitur nga KPM, si dhe të shfaqin emisione dhe debate në funksion të edukimit medial së paku një herë në tre (3) muaj; si dhe që (ii) transmetuesit një pjesë të programit të tyre ose buxhetit ta rezervojnë për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit, kanë për qëllim (i) edukimin medial përmes programeve të përgatitura nga KPM; si dhe (ii) të sigurojnë pluralizëm të mediave në përmbajtje, përmes shfaqjes së veprave evropiane të krijuara nga producentë të pavarur nga transmetuesi.
315. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave sa i përket paragrafit 7 të nenit 12 të Ligjit të kontestuar nuk e kontestojnë faktin që një përcaktim i tillë është (i) i *“përcaktuar me ligj”*, dhe as që ky përcaktim ka (ii) një *“qëllim legjitim”*. Megjithatë, parashtruesit theksojnë se *“përkundër se mund të ketë një qëllim legjitim, përbën një ndërhyrje joproporcionale në lirinë e garantuar të medieve”*. Andaj, parashtruesit pretendojnë se kufizimet për transmetuesit sa i përket detyrimeve për transmetim sipas neneve të kontestuar të Ligjit të kontestuar, nuk janë në pajtim me parimin e (iii) proporcionalitetit.

316. Ashtu siç u sqarua, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, nenin 10 të KEDNJ-së, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe standardeve të vendosura nga Këshilli i Evropës, përderisa liria e medieve është e garantuar, censura është e ndaluar dhe në këtë kuptim askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose ideve nëpërmjet medieve, shteti ka për obligim që të ndërmerr masa, përfshirë ligjore, për të garantuar pluralizmin e medieve, si dhe të përmbajtjes dhe programeve.
317. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se sa i përket transmetimit të materialit edukativ, këto materiale përgatiten nga vet KPM, ndërsa transmetuesit kanë për obligim vetëm t'i shfaqin ato. Në këtë kontekst, Ligji i kontestuar ka bërë dallimin në mes të transmetuesit publik dhe kanaleve gjeneraliste të tjera. Më saktësisht, përderisa (i) transmetuesi publik ka për obligim të bëjë shfaqjen e tyre nga tre (3) deri shtatë (7) minuta dhe pa pagesë çdo javë dhe atë *“në kohën prime”*; (ii) transmetuesit tjerë kanë për obligim që të bëjnë të njëjtën vetëm një herë në muaj, në kohëzgjatjen e njëjtë. Kjo e fundit, duke marrë parasysh edhe faktin që transmetuesi publik, bartë barrë më të madhe duke pasur parasysh edhe faktin që i njëjti financohet nga fondet publike. Përderisa shfaqja e emisioneve ose debateve në funksion të edukimit medial obligon njëjtë sikur transmetuesin publik, por edhe kanalet tjera gjeneraliste, megjithatë një obligim i tillë është i kufizuar në një (1) herë në tre (3) muaj.
318. Prandaj, Gjykata vlerëson se, duke marrë për bazë (i) obligimin pozitiv të shtetit sa i përket sigurimit të pluralizmit të programeve (ii) përmbajtjen e materialeve që do të shfaqen, e që kanë të bëjnë me materiale edukuese; (iii) interesin publik për edukim medial; (iv) kohëzgjatjen dhe intervalet kur do të shfaqen këto materiale; (v) faktin që bëhet edhe dallimi në mes të barrës për transmetuesin publik që financohet edhe nga fondet publike dhe transmetuesit tjerë, Gjykata vlerëson që ndërhyrja e pretenduar nga parashtruesit në lirinë e mediave, në rastin konkret është proporcionale dhe e arsyeshme. Për më tepër, bazuar në nenin 8 (Pluralizmi medial) të Ligjit të kontestuar, (vi) KPM është e obliguar që të themelon fond të veçantë për mbështetjen e programeve mediatike dhe medieve të licencuara apo të regjistruara në përputhje me parimet e këtij ligji në fushën e edukimit, demokracisë, arteve, sporteve dhe ekonomisë.
319. Ndërsa, në kontekst të nenit 12 të paragrafit 7 të Ligjit të kontestuar, Gjykata rikujton që përmes Ligjit Nr. 05/L -069, Kuvendi kishte ratifikuar Marrëveshjen për Stabilizim Asociim ndërmjet Republikës së Kosovës në njërën anë dhe Bashkimit Evropian në anën tjetër. I njëjti ishte shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 1 dhjetor 2015 dhe kishte hyrë në fuqi po atë ditë, bazuar në nenin 3 (Hyrja në fuqi) të këtij ligji. Si e tillë, marrëveshja e lartcekur ndërkombëtare, bazuar në nenin 19 të Kushtetutës, (i) është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, për aq sa zbatimi nuk kërkon nxjerrjen e një ligji; dhe (ii) ka epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës (shih rastet e Gjykatës [KO216/22](#), me parashtrues: *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë* dhe [KO220/22](#), me parashtrues: *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Aktgjykim i 2 gushtit 2023, paragrafi 314).
320. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 109 (Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale) i Marrëveshjes së lartcekur, që sa i përket fushës audio-vizuale, përcakton se Kosova, ndër të tjera, do të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së.
321. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se neni 17 i Direktivës AVMS që përcakton se: *“Shtetet anëtare sigurojnë, aty ku është e praktikueshme dhe me mjetet e duhura, që transmetuesit*

rezervojnë të paktën 10% të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping, apo në mënyrë alternative në diskreconin e shteteve anëtare, të paktën 10% të buxhetit të tyre programor për veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit. Ky proporcion, duke pasur parasysh përgjegjësitë informative, arsimore, kulturore dhe argëtuese të transmetuesit ndaj publikut të tij shikues, duhet të arrihet në mënyrë progresive, mbi bazën e kriterëve të përshtatshme. Kjo arrihet duke caktuar një proporcion të përshtatshëm për veprat e fundit, si veprat e transmetuara brenda pesë (5) viteve nga prodhimi i tyre”.

322. Prandaj, rezulton që përcaktimet e lartcekura të Direktivës AVMS të BE-së, janë inkorporuar përmes paragrafit 7 të nenit 12 të Ligjit të kontestuar në Ligjin e kontestuar, me ç'rast KPM është përcaktuar si organ që do të sigurojë zbatimin e këtyre dispozitave.
323. Përveç kësaj, Gjykata duke marrë për bazë parimet që u cekën më lart, përfshirë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Rekomandimin e lartcekur CM/Rec (2007)2, të Këshillit të Evropës, veçanërisht obligimin pozitiv të shtetit sa i përket sigurimit të pluralizmit të programeve, vlerëson si proporcional obligimin që transmetuesit të rezervojnë të paktën dhjetë përqind (10%) të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping ose me radhë, ose të paktën dhjetë përqind (10%) të buxhetit të tyre programor për “*veprat evropiane të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit*”.
324. Kjo për faktin se paragrafi 7 i nenit 12 të Ligjit të kontestuar, parasheh që një gjë e tillë të bëhet (i) gradualisht dhe jo me efekt të menjëhershëm, dhe për aq sa është e mundur. Për më tepër, ky obligim (ii) nuk dikton përmbajtjen e transmetimit me kushtin që dhjetë përqind (10%) e transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshopping, ose me radhë; ose dhjetë përqind (10%) e buxhetit të tyre programor të orientohet në (i) veprat evropiane; dhe (ii) këto vepra të jenë të krijuara nga producentë që janë të pavarur nga transmetuesit. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se ky kufizim plotëson testin e proporcionalitetit. Gjithashtu, Gjykata përsërit obligimin e lartcekur të KPM-së për themelimin e fondit të veçantë për mbështetjen e programeve mediatike dhe mediave të licencuara apo të regjistruara në fushën e edukimit, demokracisë, arteve, sporteve dhe ekonomisë, sipas nenit 8 të Ligjit të kontestuar.
325. Rrjedhimisht, marrë parasysh vlerësimin e lartcekur, Gjykata konstaton se paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 10 (Edukimi medial) dhe paragrafi 7 i nenit 12 (Politika e transmetimit) të Ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim me nenin 42 [Liria e Medieve] të Kushtetutës.

V. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 43 të Ligjit të kontestuar përkitazi me aprovimin nga KPM të transferimit të pronësisë të të licencuarve/regjistruarave, si dhe ndalimin që një subjekt tjetër i licencuar/regjistruar të zotërojë më tepër se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një subjekt tjetër të licencuar

A. Pretendimet dhe kundërargumentet e palëve

326. Neni 43 i Ligjit të kontestuar rregullon pronësinë e të licencuarve/regjistruarave dhe mënyrën e transferimit të pronësisë të të licencuarve/regjistruarave. Paragrafi 1 i këtij

neni përcakton se “Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë dhe/ose aksioneve të njoftojë më shkrim KPM-në” ndërsa paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar përcakton se “Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të merr aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja”. Për më tepër, paragrafi 4 i këtij neni përcakton se “Një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër”. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 7 të nenit 43 të Ligjit të kontestuar, “KPM bazuar në rezultatet dhe nevojat të cilat rezultojnë nga analiza e tregut medial, me akt nënligjor përcakton rregulla specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave.” Po ashtu dhe në ndërlidhje me këtë, sipas nënparagrafëve 2.4 dhe 2.5 të paragrafit 2 të nenit 4 (Kompetencat e KPM-së) të Ligjit të kontestuar (i) KPM shqyrton dhe miraton çdo ndryshim të pronësisë për të gjithë të licencuarit dhe të regjistruarit; dhe (ii) KPM në rast të miratimit të ndryshimit të pronësisë, e pajis me vërtetim subjektin e licencuar ose regjistruar për lejimin e ndryshimit të pronësisë edhe në regjistrin e bizneseve pranë agjencionit përkatës për regjistrimin e bizneseve.

327. Sipas sqarimeve të lartcekura, rezulton se neni 43 i Ligjit të kontestuar, përcakton detyrimin për të licencuarit/regjistruarit që sa i përket ndryshimit të pronësisë të (i) njoftojnë KPM-në; dhe (ii) të marrin aprovimin nga KPM për ndryshim të pronësisë. Ndërsa, (iii) një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër; përderisa, (iv) delegon kompetencën për rregullim në nivel të aktit nënligjor të nxjerrë nga KPM, të rregullave specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave.
328. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se (i) paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar, përkitazi me obligimin për të marrë aprovimin paraprak nga KPM për ndryshimin e pronësisë mbi vlerën mbi dhjetë përqind (10%) të aksioneve; dhe (ii) paragrafi 4 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar sipas së cilit, një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër, cenojnë të drejtën e lirisë së mediave sipas nenit 42 të Kushtetutës si dhe të drejtën për veprimtari ekonomike të garantuar përmes nenit 119 të Kushtetutës. Këto pretendime kundërshtohen nga Qeveria, duke theksuar se (i) liria e mediave e garantuar me nenin 42 të Kushtetutës përcakton pikërisht detyrimin e ndalimit të koncentrimit të pronësisë së mediave në të njëjtin pronar, andaj neni 43 i Ligjit të kontestuar e zbërthen dhe e zbaton këtë parim; (ii) parimi i pluralizmit zbatohet edhe sa i përket partive politike me ç’ rast sipas legjislacionit zgjedhor nuk lejohet që një person të jetë kryetar i më shumë se një subjekti politik; (iii) përqindja e përcaktuar me Ligjin e kontestuar tashmë është pjesë e Rregullores për pronësinë dhe koncentrimin e të licencuarave të KPM-së; (iv) detyrimi për njoftimin e KPM-së për ndryshim të pronësisë rrjedh edhe nga Direktiva e AVMS-së; dhe (v) KPM duhet të ketë autorizim, siç autorizohet edhe me Ligjin e vitit 2012, që të rregullojë tregun mediatik në përputhje me parimet ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin e Kosovës.

B. Vlerësimi i Gjykatës

329. Sa i përket lirisë së mediave, Gjykata përsërit se neni 42 i Kushtetutës përmban 3 paragrafë. Paragrafi 1 i këtij neni (i) garanton lirinë dhe pluralizmin e medieive, ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni (ii) përcakton se censura është e ndaluar dhe se askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieive, me përjashtim të rasteve kur

një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

330. Gjykata përsërit se neni 42 i Kushtetutës është i ndërlidhur edhe me nenin 40 [Liria e Shprehjes], i cili në paragrafin 1 përcakton se “*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*” Përderisa paragrafi 2 i të njëjti përcakton kufizimet e mundshme duke theksuar specifikisht se “*Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*”
331. Gjithashtu, siç ka sqaruar Gjykata më lart, sipas GJEDNJ-së, por edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, të ushtruarit e lirisë së shprehjes në mënyrë efektive dhe kuptimplotë, nuk kushtëzohet vetëm nga obligimi për mosndërrhyrje nga ana e shtetit, por gjithashtu nga obligimi pozitiv i shtetit për të siguruar masa pozitive të mbrojtjes, përmes ligjit dhe praktikës. Prandaj, GJEDNJ thekson se, duke pasur parasysh rëndësinë e asaj që mbrohet përmes nenit 10 të KEDNJ-së, shteti duhet të jetë garantuesi përfundimtar i pluralizmit (shih rastin e GJEDNJ-së [Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë](#), nr. 13936/02, Aktgjykim i 17 shtatorit 2009, paragrafi 99; dhe rastin e Gjykatës [KO134/21](#), parashtrues *Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 gushtit 2023, paragrafi 133). Gjykata dhe GJEDNJ më tej kanë theksuar se mënyrat e realizimit të këtyre qëllimeve varen gjerësisht nga rrethanat vendore, prandaj shtetet gëzojnë një kuadër të gjerë vlerësimi lidhur me këtë (shih rastin *Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*, cituar më lart, paragrafi 100; dhe rastin e Gjykatës [KO134/21](#), cituar më lart, paragrafi 134).
332. Për më tepër, sa i përket ekonomisë së tregut, Gjykata rithekson që neni 119 i Kushtetutës, në të cilin thirren parashtruesit e kërkesave përcakton detyrimin e Republikës së Kosovës, që (i) të siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private sipas përcaktimeve të paragrafit të parë të tij; (ii) të ndalojë të gjitha veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj, sipas përcaktimeve të paragrafit të tretë të tij; dhe (iii) të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik sipas përcaktimeve të paragrafit pesë të tij. Përtej detyrimeve të lartcekura të Republikës së Kosovës, neni 119 i Kushtetutës, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, gjithashtu përcakton që Republika e Kosovës (i) siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme, sipas përcaktimeve të paragrafit dy të tij; dhe (ii) promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe garanton mbrojtjen e konsumatorëve në pajtim me ligjin (shih, rastet e Gjykatës: [KO173/22](#), Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, Aktgjykim i 8 nëntorit 2023, paragrafi 133).
333. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata i referohet edhe [Direktivës së BE-së 2018/1808 të AVMS](#) e cila thekson, ndër të tjera, se shtetet anëtare mund të nxjerrin masa legjislative që përcaktojnë se ofruesit e shërbimeve të mediave nën juridiksionin e tyre i bëjnë të qasshme informatat sa i përket strukturës së pronësisë, duke

- përfshirë pronarët përfitues. Sipas direktivës së lartcekur, masat e tilla duhet të respektojnë të drejtat e njeriut, siç janë jeta private dhe familjare të pronarëve përfitues dhe duhet të jenë të nevojshme dhe proporcionale dhe duhet të mëtojnë të arrijnë objektivin e interesit të përgjithshëm (shih Direktivën e BE-së 2018/1808 të AVMS, cituar më lart, neni 5, paragrafi 2).
334. Për më tepër, Gjykata rikujton [Rregulloren \(EU\) 2024/1083](#) të Parlamentin dhe Këshillit të 11 prillit 2024, për krijimin e kornizës së përbashkët për shërbimet mediale në tregun e brendshëm dhe amendamentin e Direktivës 2010/11/EU (Aktin Evropian për Lirinë e Medieve), që ndër të tjera, përcakton se ofruesit e shërbimeve mediale duhet të bëjnë lehtësisht dhe drejtpërdrejtë të qasshme për pranuesit e shërbimeve të tyre, të dhëna të azhurnuara të, ndër të tjera, *“emrin apo emrat e pronarit direkt apo indirekt apo pronarëve që kanë aksione që ju mundësojnë për të ushtruar influencën sa i përket operimit dhe vendimmarrjes strategjike, përfshirë pronësinë direkte apo indirekte nga shteti apo autoriteti publik apo entitet”* (shih, Rregulloren (BE) 2024/1083 të Parlamentin dhe Këshillit të 11 prillit 2024, për krijimin e kornizës së përbashkët për shërbimet mediale në tregun e brendshëm dhe amendamentin e Direktivës 2010/11/BE (Aktin Evropian për Lirinë e Medieve), neni 6, paragrafi 1 (b)). Rregullorja e lartcekur po ashtu përcakton se *“shtetet anëtare duhet të ja besojnë autoritetit nacional rregullatorë apo trupave apo autoriteteve tjera kompetente apo trupave zhvillimin e databazave nacionale të pronësisë së mediave”* që përmbajnë informatat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 6 të kësaj Rregullore (Shih, Rregulloren (BE) 2024/1083, cituar më lart, neni 6, paragrafi 2).
335. Sipas pikës 32 të Rregullores së BE-së 2024/1083, *“është vendimtare që pranuesit e shërbimeve mediale të njohuri të sakta se kush i zotëron dhe qëndron prapa mediave ashtu që ata të mund të identifikojnë konfliktin e mundshëm të interesit”*. Gjithashtu, sipas Rregullores së lartcekur *“zbulimi i informatave të paraqitura të pronësisë së mediave prodhon benifite që qartësisht mbipeshojnë çdo ndikimin të mundshëm të obligimit për zbulim në të drejtat fundamentale, duke përfshirë të drejtën për jetë private dhe familjare dhe të drejtën për mbrojtje të të dhënave personale* (shih, Rregulloren (BE) 2024/1083, cituar më lart, pika 32).
336. Sa i përket çështjes së pronësisë dhe koncentrimit të saj, Gjykata i referohet neni 22 (Vlerësimi i koncentrimit të tregut medial) të Rregullores së BE-së 2024/1083 që përcakton që shtetet anëtare, duhet të vendosin, në legjislacionin e tyre nacional, rregulla përmbajtjesore e procedurale që lejojnë vlerësimin e koncentrimit në tregun medial dhe që mund të ketë ndikim me pluralizmin e mediave dhe pavarësinë editoriale, duke përcaktuar kriteret për një vlerësim të tillë. I njëjti nen po ashtu përcakton se vlerësimi i koncentrimit në tregun medial duhet të jetë i ndryshëm nga vlerësimi sipas legjislacionin të BE-së apo legjislacioni nacional të konkurrencës, përfshirë kushtet ligjore për kontrollin e bashkimit (shih Rregulloren (EU) 2024/1083, cituar më lart, pika neni 22, paragrafi 1).
337. Gjykata i referohet edhe Rekomandimit Nr. R(99) 1 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtarë, të Këshillit të Evropës, sa i përket Masave për të promovuar pluralizmin e mediave, i cili në pikën I (Rregullimi i pronësisë (transmetimi dhe shtypi) përcakton se *“Shtetet anëtare duhet të konsiderojnë nxjerrjen e legjislacionit për të parandaluar apo për ndaluar koncentrimin që mund të rrezikoj pluralizmin e mediave në nivel, rajonal apo lokal”* duke shtuar që *“Shtetet anëtare duhet të shqyrtojnë mundësinë e përcaktimit të kuotave - në legjislacion apo autorizimin, licencimin apo procedurat e ngjashme - për të limituar influencën që një kompani e vetëm tregtare apo grup mund të ketë në një apo më tepër sektor të mediave.”* I njëjti Raport thekson se *“limitimi i kapitalit të aksioneve në*

ndërmarrje komerciale të mediave mund po ashtu të konsiderohet” (shih [Rekomandimit Nr. R\(99\) 1 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, të Këshillit të Evropës](#), Masat për të Promovuar Pluralizmin e Mediave, i 19 janarit 1999, pika I.

338. Gjykata gjithashtu i referohet *Vlerësimit të Sistemeve të Licencimit të Shërbimeve të Mediave Audivizuel në BE-28*, të Europan Audiovisual Observatory. Sipas këtij dokumenti, rezulton se (i) çështja e transparencës së pronësisë është e sigurtar përmes legjislacionit të mediave në 23 (njëzet e tri) nga 29 (njëzete nëntë) rastet, me përjashtim të Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Maltës, Holandës dhe Sllovakisë, megjithëse në disa nga këto shtete transparenca sigurohet në praktikë përmes mënyrave tjera por jo përmes legjislacionit (shih *Vlerësimin e Sistemeve të Licencimit të Shërbimeve të Mediave Audivizuele në BE-28*, *Europan Audiovisual Observatory, Strasburg*, 2018, faqe 49).
339. Sa i përket, koncentrimin të mediave, çështja e koncentrimin të mediave merret parasysh në 22 (njëzet e dy) nga 29 (njëzet e nëntë) raste. Në vendet ku çështja e koncentrimin merret parasysh, kjo bëhet përmes masave në vijim:
- (i) pragjet e audiencës (Gjermani, Spanjë, Francë, Hungari, Rumani);
 - (ii) ndalimi i pronësisë nga disa lloje personash (Mbretëria e Bashkuar);
 - (iii) duke marrë parasysh strukturën e pronësisë së aplikuesit (Suedi);
 - (iv) rregullat e pronësisë ndërmjet mediave (Austri, Gjermani, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Kroaci, Itali, Sllovaki);
 - (v) çështje që kanë të bëjnë me pluralitetin për sa i përket përmbajtjes (Finlandë, Irlandë, Portugali);
 - (vi) pragjet e mbulimit të popullsisë (Austri, Republika Çeke, Sllovaki);
 - (vii) prania e AVMS në pronësi të një platforme në ofertën e saj (Hungari);
 - (viii) kufizimi i pronësisë në një numër të caktuar licencash (Qipro, Republika Çeke, Francë, Maltë);
 - (ix) kufizimi i pronësisë së licencave që lejojnë transmetimin e më shumë se një përqindje të caktuar të totalit të AVMS sesa që mund të transmetohet në platformën DTT (Itali) ose në një zonë të caktuar mbulimi (Portugali);
 - (x) kufizimi (plotësisht ose pjesërisht) i pronësisë në një numër të caktuar (ose në një nivel të caktuar) ofruesish të AVMS (Qipro, Republika Çeke, Spanjë, Francë, Kroaci); dhe
 - (xi) duke iu referuar një pozicioni dominues dhe/ose rregullave anti-trust/konkurrencë (Bullgari, Estoni, Francë, Greqi, Letoni, Poloni) (shih, *Vlerësimin e Sistemeve të Licencimit të Shërbimeve të Mediave Audivizuele në BE-28*, cituar më lart, faqe 49-50).
340. Sa i përket shteteve që kanë zgjedhur që të vendosin rregulla të pronësisë në mes të mediave, sipas dokumentit të lartcekur, përqindja e pamundësisë që një media të ketë pronësi në një media tjetër, varion, sipas vendeve, si dhe përqindjes së ndryshme që zbatojnë. Në këtë kontekst, dokumenti i lartcekur i referohet edhe Ligjit të Mediave të Kroacisë, ku përcaktohet pamundësia që një media të ketë pronësi në një media tjetër, në lartësinë që varion nga dhjetë përqind (10%) e më lart.
341. Prandaj, Gjykata thekson se në nivel të BE-së nuk ka një standard të unifikuar përkitazi me kufizimin e koncentrimin të pronësisë, megjithatë, shtetet anëtare përmes legjislacionin të tyre nacional, mund të përcaktojnë rregulla përmbajtjesore e procedurale përkitazi me koncentrimin në tregun medial. Thënë këtë, këto rregulla nuk duhet më kufizuese se që

janë të nevojshme bazuar në standardet e përgjithshme të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së mediave.

342. Në rrethanat e Ligjit të kontestuar, Gjykata fillimisht thekson se nuk është kontestuese që (i) marrja e aprovimit paraprak nga KPM përkitazi me ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarave/regjistruarve; dhe (ii) kufizimi që një i licencuar/regjistruar të mos ketë të drejtë të zotëroj më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër, prek në të drejtat e të licencuarave/regjistruarave që të disponojnë me pronën tyre dhe aktivitetin e tyre ekonomik. Në këtë aspekt, bazuar në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, duhet vlerësuar nëse një ndërhyrje e tillë (i) është e përcaktuar me ligj; (ii) ndjek një qëllim legjitim; dhe nëse po, nëse i njëjti është proporcional. Në këtë kontekst, Gjykata do të vlerësojë dispozitat e kontestuar në ndërlidhje me dispozitat tjera të Ligjit të kontestuar.

343. Thënë këtë, këtë vlerësim Gjykata do ta bëjë ndaras, për (a) ndryshimin e pronësisë mbi vlerën prej dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarave/regjistruarve dhe (b) ndalimin e kalimit të pronësisë nga një i licencuar/regjistruar, në një të licencuar/regjistruar tjetër.

(a) Përkitazi me kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit të kontestuar sa i përket marrjes së aprovimit paraprak nga KPM përkitazi me ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarave/regjistruarve

344. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata thekson se fillimisht është e nevojshme të vlerësohen dispozitat e lartcekura të Ligjit të kontestuar në kuadër të “përcaktueshmërisë” me ligj në kuadër të sigurisë juridike sipas nenit 7 të Kushtetutës. Sa i përket kriterit të cekur më lart, përkatësisht “përcaktueshmërisë me ligj”, Gjykata vëren se vetëm përcaktimi me ligj nuk është i mjaftueshëm që një kufizim të jetë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë. Gjykata rithekson se Komisioni i Venecias ka theksuar se është “thelbësore për besimin në sistemin gjyqësor dhe sundimin e ligjit”, që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize, dhe se kanë për qëllim që situatat dhe marrëdhëniet ligjore të mbesin të parashikueshme (shih, ndër të tjera, Opinionin e Komisionit të Venecias mbi draft-ligjin për amendamentet dhe shtesat në kodin gjyqësor të Armenisë [CDL-AD(2014) 021], e 16 qershorit 2013, paragrafi 18).

345. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës se shprehja “në pajtim me ligjin” kërkon jo vetëm që masa e ndërmarrë të ketë bazë në të drejtën vendore, por gjithashtu i referohet edhe kualitetit të ligjit në fjalë, duke kërkuar që i njëjti të jetë i qasshëm për personat që u referohet dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve. Njëra nga kërkesat që rezulton nga shprehja “në pajtim me ligjin” është parashikueshmëria. Andaj një normë nuk mund të cilësohet “ligj”, përderisa nuk formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre. Andaj, ata duhet të jenë në gjendje, nëse është e nevojshme me këshillat e dhura, të parashohin, në një nivel që është i arsyeshëm brenda rrethanave, pasojat që një veprim mund të ketë. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, këto pasoja nuk duhet të jenë të parashikuara më një precizitet absolut, pasi përvoja ka treguar që një gjë e tillë është e paarrtshme (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Tommasi kundër Italisë*, nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106 dhe 107; dhe rastet e Gjykatës (raste të bashkuara) KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 15 majit 2024, paragrafi 193).

346. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata po ashtu në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar, duke marrë parasysh parimet e lartcekura lidhur me “*parashikueshmërinë*” dhe “*qartësinë*” e ligjit dhe rëndësinë e këtij koncepti për parimin e sigurisë juridike, bazuar edhe në opinionet relevante të Komisionit të Venecias, në parim, “*të drejtat dhe detyrimet*” duhet të jenë “*të përcaktuara me ligj*”, dispozitat e të cilit duhet të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*”, për t’i mundësuar pushtetit ekzekutiv/autoriteteve publike të ushtrojë diskrecion vetëm në fushat ku është deleguar një kompetencë të tillë, e jo thjeshtë sepse ligji është i pasigurt ose i paqartë, por edhe për t’i mundësuar subjekteve juridike që përshtatshmërisht të rregullojnë sjelljen dhe pritshmëritë përkatëse (shih, rastet e Gjykatës KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 227; dhe KO46/23, cituar më lart, paragrafi 295).
347. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht thekson se sa i përket marrjes së aprovimit paraprak nga KPM përkitazi me ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarve/regjistruarve, ky kufizim është i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit të kontestuar. Gjykata gjithashtu vëren se nënparagrafin 2.4 e paragrafit 2 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar përcakton se KPM shqyrton dhe miraton çdo ndryshim të pronësisë për të gjithë të licencuarit dhe të regjistruarit, sipas përkufizimit në nënparagrafin 2.2. të këtij neni. Më tej dhe sipas nënparagrafi 2.5 i paragrafit 2 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar KPM në rast të miratimit të ndryshimit të pronësisë pajis me vërtetim subjektin e licencuar/regjistruar. Për më tepër, paragrafi 5 i nenit 25 (Leja e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre) e Ligjit të kontestuar përcakton se, vazhdimi i shfrytëzimit të lejes mund të bëhet vetëm pasi të jetë miratuar me shkrim ndryshimi i pronësisë nga KPM.
348. Gjykata vëren fillimisht se përderisa në njërën anë (i) paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar, përcakton detyrimin për të marrë aprovim nga KPM vetëm për ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarve/regjistruarve; në anën tjetër (ii) nënparagrafi 2.4 i paragrafit 2 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, në ndërlidhje me nënparagrafin 2.5 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, i jep të drejtë KPM-së që të miratojë “*çdo ndryshim të pronësisë për të gjithë të licencuarit dhe regjistruarit*”. Andaj, përderisa paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar përcakton obligimin për aprovim paraprak nga KPM vetëm për ndryshimin të pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarve/regjistruarve, paragrafi 2.4 i nenit 4 të Ligjit të kontestuar, përcakton detyrim për aprovim, edhe për rastet kur vlera e ndryshimit të pronësisë është dhjetë përqind (10%) apo me e ulët, pasi i njëjti vë theksin në “*çdo ndryshim të pronësisë*”, dhe jo standardin e përcaktuar në nenin 43 të Ligjit të kontestuar, që është vlera mbi dhjetë përqind (10%). Ngjashëm përcakton edhe paragrafi 5 i nenit 25 të Ligjit të kontestuar. Prandaj, kjo ka rezultuar në dispozita kundërthënëse brenda ligjit të cilat nuk plotësojnë kriterin e “*qartësisë*” dhe “*parashikueshmërisë*” së normës ashtu siç kërkohet me parimet kushtetuese të lartcekura, të mishëruara edhe në nenin 7 të Kushtetutës.
349. Për më tepër, Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar përcakton që “*KPM bazuar në rezultatet dhe nevojat të cilat rezultojnë nga analiza e tregut medial, me akt nënligjor përcakton rregulla specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave.*”
350. Gjykata vëren se një përcaktim i tillë për koncentrimin e pronësisë në media, dhe rregullimit të mëtejme me akt nënligjor nga KPM-ja është përcaktuar edhe në paragrafin 1 të nenit 42 (Pronësia dhe koncentrimi i mediave) të Ligjit të kontestuar.

351. Për pasojë, Gjykata vëren se çështjet e pronësisë, përfshirë ndryshimin e pronësisë dhe kushteve për aprovimin e një ndryshimi të tillë, të cilin e bënë KPM, Ligji i kontestuar e ka deleguar rregullimin e mëtejme të tyre në nivel të aktit nënligjor që do të nxjerr vet KPM.
352. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Lista e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias sa i përket procedurës së ligjbërjes nga ekzekutivi, duhet vlerësuar se kur parlamenti delegon kompetencën legjislative tek ekzekutivi, nëse objektivat, përmbajta, dhe fushëveprimi i një delegimi të tillë, definohet në mënyrë eksplicite në aktin legjislativ (shih *Listën e Kontrolluese e Sundimin e Ligjit e Komisionit të Venecias*, citur më lart, paragrafi 48).
353. Përveç këtij kufizimi, Gjykata vlerëson se përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të personave fizikë dhe juridikë, dhe kompetencat e trupave administrative shtetërore, përbëjnë ekskluzivisht çështje që duhet të përcaktohen me ligj, përderisa mënyra dhe realizmi i tyre është subjekt i rregullimit normativ më të detajuar me akte nënligjore. Në këtë kontest Gjykata i referohet Aktgjykimit të saj në rastin KO46/23, parashtrues *Abelard Tahiri dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, ku Gjykata ka theksuar se “*Rrjedhimisht, marrë parasysh parimin e sigurisë juridike, përfshirë detyrimin që normat e aplikueshme të jenë të “qarta” dhe të “parashikueshme”, siç është përcaktuar në parimet e përmendura më lart dhe të përcaktuara në Listën e Kontrollit të Komisionit të Venecias për Sundimin e Ligjit, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe jo përmes akteve nënligjore.*” (shih rastin e Gjykatës [KO46/23](#), parashtrues *Abelard Tahiri dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Aktgjykim i 20 qershorit 2024, paragrafi 342).
354. Në këtë aspekt, siç rezulton nga dispozitat e nenit 141 të Kushtetutës që përcaktojnë KPM-në si institucion i pavarur rregullator, dhe standardet ndërkombëtare përfshirë Rekomandimin (2000)23 të Këshillit të Evropës që përcakton se brenda kornizës ligjore, autoriteti rregullator duhet të ketë kompetencë që të bëjë rregullimin e cila i mundëson atyre që të veprojnë me fleksibilitet dhe në mënyrë adekuate sa i përket pyetjeve që mund të jenë të paparashikueshme dhe që janë shpesh komplekse.
355. Megjithatë, duke u rikthyer edhe njëherë tek rrethanat e rastit konkret, përderisa, paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar, përcakton detyrimin për marrjen e aprovimit paraprak nga KPM përkitazi me ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarve/regjistruarve, paragrafi 7 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar përcakton që rregullat specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave, do të përcaktohen në nivel të aktit nën-ligjor nga KPM. Megjithatë, Gjykata vlerëson se një rregullim i tillë, nuk mund të bëhet më tej me akte nënligjore nëse dispozitat e vetë Ligjit të kontestuar sa i përket aprovimit të kalimit të pronësisë, janë kontradiktore.
356. Kjo pasi paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar, përcakton detyrimin për të marrë aprovim nga KPM vetëm për ndryshimin e pronësisë mbi vlerën dhjetë përqind (10%) të aksioneve të të licencuarve/regjistruarve, në anën tjetër (ii) nënparagrafi 2.4 i paragrafit 2 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, në ndërlidhje me nënparagrafin 2.5 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, i jep të drejtë KPM-së që të miratojë “*çdo ndryshim të pronësisë për të gjithë të licencuarit dhe regjistruarit*”, ngjashëm siç përcaktohet me paragrafi 5 të nenit 25 të Ligjit të kontestuar.

357. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nënparagrafët 2.4 dhe 2.5 të paragrafit 2 të nenit 4 (Kompetencat e KPM-së), paragrafi 5 i nenit 25 (Leja e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre) dhe paragrafi 2 i nenit 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

(b) Përkitazi me paragrafin 4 të nenit 43 të Ligjit të kontestuar dhe pamundësinë e zotërimit të më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër

358. Gjykata fillimisht thekson se në nivel ndërkombëtar nuk ka një standard të mirë përcaktuar sa i përket mënyrës se si shtetet duhet të veprojnë në mënyrë që të parandalojnë koncentrimin e pronësisë së mediave. Siç është sqaruar më lart, ekzistojnë masa të ndryshme që shtetet kanë ndërmarrë në mënyrë që të arrihet ky qëllim. Siç rezulton nga Vlerësimin e Sistemeve të Licencimit të Shërbimeve të Mediave Audivizuele në BE-28, njëra nga këto masa është edhe kufizimi i koncentrimin të mediave në të njëjtin pronar, si në Austri, Gjermani, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Kroaci, Itali, Sllovakia. Por edhe në këtë rast, shtetet dallojnë si për nga përqindja që zbatojnë ashtu edhe për nga mënyra se si e zbatojnë këtë përqindje, të cilat variojnë nga dhjetë përqind (10%) e më tepër, siç është rasti me Kroacinë sa i përket disa llojeve të koncentrimin.

359. Sa i përket, paragrafit 4 të nenit 43 të Ligjit të kontestuar, i njëjti përcakton kufizimin që një i licencuar/regjistruar të mos ketë të drejtë të zotëroj më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër. Në këtë aspekt, duke qenë se kjo përbën kufizim në të drejtën për transferim të pronësisë, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse një kufizim i tillë (i) është i pacaktuar me ligj; (ii) ka një qëllim legjitim; dhe (iii) është proporcional.

360. Në këtë kontekst, dhe sa i përket kushtit të parë që një kufizim të jetë “i përcaktuar me ligj”, Gjykata vlerëson se për dallim nga paragrafi 2 i nenit 43 të Ligjit të kontestuar, paragrafi 4 i nenit 43 i Ligjit të kontestuar, përcakton në mënyrë të qartë të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga norma në fjalë, se një i licencuar/regjistruar të mos ketë të drejtë të zotëroj më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër, dhe se kjo normë është e parashikueshme për subjektet që ju drejtohet dhe atyre që zbatojnë atë.

361. Ndërsa sa i përket hapit të dytë të testit, përkatësisht nëse kufizimi ndjek një “qëllim legjitim”, Gjykata rikujton edhe njëherë se siç rezulton edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, dhe rekomandimit të lartcekur të Këshillit të Evropës, dhe ku vihet theksi në atë se shteti ka për obligim që, përtej sigurimit të lirisë së shprehjes e pluralizmit medial, të ndërmarrë edhe hapa që, përmes legjislacionit, të sigurojë pluralizëm edhe të programeve.

362. Në këtë aspekt, bazuar në përgjigjen e Qeverisë, rezulton se qëllimi i këtij kufizimi që një i licencuar/regjistruar të mos ketë të drejtë të zotëroj më shumë se dhjetë përqind (10%) të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër, ka për qëllim të sigurojë të parandalohet koncentrimi i pronësisë së medias në të njëjtin pronar, pra respektimi i detyrueshëm i pluralizmit medial të përcaktuar me Kushtetutë, në nenin 42 dhe nenin 43 të Ligjit të kontestuar.

363. Gjykata vlerëson se sigurimi i pluralizmit medial mund të shërbejë si qëllim legjitim në kontekst të lirisë së mediave. Prandaj, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë edhe hapin e tretë të testit, përkatësisht nëse një kufizim i tillë është “*proporcional*”.
364. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se ligjvënësi është në pozitë më të favorshme për të vlerësuar politikat publike andaj, Gjykata veçse ka theksuar në praktikën e saj gjyqësore që në shqyrtim të kushtetutshmërisë së një Ligji, ajo asnjëherë nuk vlerëson se a është një ligj i bazuar në politika të mira publike apo jo por vetëm nëse i njëjti mund të ketë cenuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
365. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se (i) kufizimi i kalimit të pronësisë i përcaktuar në Ligjin e kontestuar është i kufizuar në pamundësinë e kalimit të pronësisë vetëm nga një i licencuar/regjistruar në tjetrin; (ii) i njëjti nuk përfshinë kufizim në raport me kalimin e pronësisë në subjekte që nuk janë të licencuar apo të regjistruar sipas Ligjit të kontestuar. Gjithashtu, (iii) kufizimi nuk është i plotë por kufizohet vetëm me kalimin e pronësisë që kalon vlerën e dhjetë përqind (10%) të aksioneve të një të licencuari/regjistruari në tjetrin. E njëjta është po ashtu në harmoni me standardet ndërkombëtare përfshirë, dhe Rekomandimin Nr. R (99) 1 të Këshillit të Evropës, të cekur më lart.
366. Në këto rrethana Gjykata vlerëson se kufizimi i përcaktuar për zotërim të aksioneve të njërit të licencuar/regjistruar në tjetrin, plotëson edhe kriterin e proporcionalitetit.
367. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se paragrafi 4 i nenit 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve) të Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 42 [Liria e Mediave] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

VI. Përkitazi me sanksionet dhe gjobat të përcaktuara me nenin 60 të Ligjit të kontestuar

368. Gjykata fillimisht vëren se neni 60 i Ligjit të kontestuar përcakton sanksionet dhe gjobat përkitazi me shkeljen e dispozitave të Ligjit të kontestuar. Më specifikisht, bazuar në nenin 60 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht paragrafin 1, nënparagrafi 1.1 të këtij neni, KPM shqipton gjobë nga pesëqind (500) deri në katër mijë (4,000) euro për personin fizik në rastin kur operon pa leje nga KPM. Ndërsa, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 autorizon KPM-në që të shqiptoj gjobë nga pesë qind (500) deri në njëzet mijë (20,000) euro për personin juridik nëse plotësohen njëri nga kushtet e përcaktuara në nënparagrafin 1.2, ku përfshihen arsyet për gjoba të tilla, përfshirë, për shkak që subjekti juridik:
- (i) nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga Ligji i kontestuar (siç përcaktohet në pikën 1.2.1 të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar);
 - (ii) nuk dorëzon raportin vjetor në KPM brenda afatit të parashikuar (siç përcaktohet në pikën 1.2.2 të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar);
 - (iii) transmeton, ritransmeton ose shpërndan shërbime mediale audio dhe audiovizuale në mënyrë të paautorizuar (siç përcaktohet në pikën 1.2.16 të nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar); dhe

(iv) nuk respekton obligimet e tjera sipas këtij ligji (siç përcaktohet në pikën 1.2.24 të nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar).

369. Ndërsa nënparagrafi 1.3 i Ligjit të kontestuar autorizon KPM që të dyfishojë sanksionin me gjobë nga nënparagrafi 1.2. i këtij neni, në rastet kur personi juridik:

“ 1.3.1. shkakton në mënyrë të përsëritur interferenca të dëmshme ndaj një subjekti tjetër;

1.3.2. përsërit shkeljet e përcaktuara në nënparagrafin 1.2. të këtij neni;

1.3.3. transmeton, ritransmeton, apo shpërndan përmbajtje programore që nxisin urrejtje, dhunë dhe trazira;

1.3.4. transmeton, ritransmeton, apo shpërndan përmbajtje që cënon rendin dhe sigurinë publike;

1.3.5. transmeton, ritransmeton, apo bën shpërndarje ilegale të përmbajtjeve programore;

1.3.6. nuk dorëzon në afatin parashikuar raportin vjetor në KPM.”

370. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se neni 60 i Ligjit të kontestuar është në kolizion me nenin 29 të Ligjit për Kundërvajtje, i cili në mënyrë uniforme ka rregulluar dhe përcaktuar kundërvajtjen të cilat aplikohen, dhe si pasojë, është cenuar parimi i sigurisë juridike, parimi i ligjshmërisë dhe i parashikueshmërisë, si pjesë përbërëse e sundimit të ligjit, të garantuar me nenin 7 të Kushtetutës.

371. Ashtu siç është theksuar më lart, shprehja “*në pajtim me ligjin*” kërkon jo vetëm që masa e ndërmarrë të ketë bazë në të drejtën vendore, por gjithashtu i referohet edhe kualitetit të ligjit në fjalë, duke kërkuar që i njëjti të jetë i qasshëm për personat që u referohet dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve. Njëra nga kërkesat që rezulton nga shprehja “*në pajtim me ligjin*” është parashikueshmëria. Andaj një normë nuk mund të cilësohet “*ligj*”, përderisa nuk formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre. Si pasojë, ata duhet të jenë në gjendje, nëse është e nevojshme me këshillat e duhura, të parashohin, në një nivel që është i arsyeshëm brenda rrethanave, pasojat që një veprim mund të ketë. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, këto pasoja nuk duhet të jenë të parashikuara me një precizitet absolut, pasi përvoja ka treguar që një gjë e tillë është e paarritshme (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Tommasi kundër Italisë](#), cituar më lart, paragrafët 106 dhe 107; dhe rastet e Gjykatës (raste të bashkuara) KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23 cituar më lart, paragrafi 193).

372. Në kontekst të pretendimeve ndërlidhur me kolizionin e Ligjit të kontestuar me atë për Kundërvajtje, Gjykata rikujton që neni 1 (Qëllimi dhe Fushëveprimi) i Ligjit për Kundërvajtje përcakton, ndër të tjera, “*kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes*”. Ndërsa neni 29 i Ligjit për Kundërvajtje, në paragrafin 1 përcakton se “*Sanksioni kundërvajtës me gjobë, mund të parashihet në shumë të përcaktuar ose në shumë të caktuar.*”

373. Paragrafi 2 i nenit 29 i Ligjit për Kundërvajtje përcakton se sanksioni kundërvajtës me gjobë mund të parashihet në shumë të përcaktuar dhe atë (i) për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik, nuk mund të jetë më pak se tridhjetë (30) euro, dhe jo më shumë se dy mijë (2.000) euro; (ii) për personin fizik që ushtron biznes individual, nuk mund të jetë më pak se dyqind (200) euro, dhe jo më shumë se pesë mijë (5.000) euro; dhe (iii) për personin juridik nuk mund të jetë më pak se pesëqind (500) euro, dhe jo më shumë se njëzet mijë (20.000) euro. Për më tepër, neni 29 i Ligjit për Kundërvajtje përcakton mundësinë që (i) për kundërvajtje të lehta mund të parashihen sanksione kundërvajtëse në shuma më të ulëta se ato të përcaktuara më lart, ndërsa paragrafi 6 i këtij neni përcakton mundësinë që përjashtimisht nga paragrafi 2 i nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje, për kundërvajtjet nga fusha, ndër të tjera, *“të informimit publik”*, sanksioni kundërvajtës, me gjobë mund të dyfishohet në maksimumin e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje.
374. Në ndërlidhje me rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se neni 1, paragrafi 1.1 i Ligjit të kontestuar ka përcaktuar gjoba për personat fizikë në rast kur operojnë pa leje nga KPM, deri në dyfishin e shumës së përcaktuar në nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të kontestuar.
375. Megjithatë, Gjykata vëren se kjo nuk është në kundërshtim me Ligjin për Kundërvajtje pasi që paragrafi 6 i nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje përcakton mundësinë që gjoba mund të dyfishohet nëse ka të bëjë, ndër të tjera, me fushën e informimit publik. Prandaj, në rastin konkret, ligjvënësi ka përdorur diskrecionin e përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje për të përcaktuar shumën prej katërmijë (4,000.00) euro, si maksimumi i gjobës që mund të shqiptohet ndaj personave fizikë.
376. Ndërsa, sa i përket personave juridikë, përmes nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, janë përcaktuar gjobat në shumën e përcaktuar me paragrafin 2, nënparagrafin 2.3 deri në shumën njëzet mijë (20,000.00) euro. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se diskrecionin për të përcaktuar gjoba deri në dyfishin e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje, sipas paragrafit 7 të nenit 29 të këtij Ligji, në rastin e personave juridikë, ligjbërësi e ka përdorur në paragrafin 1.3 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar dhe atë për rastet kur personi juridik (i) shkakton në mënyrë të përsëritur interferenca të dëmshme ndaj një subjekti tjetër; (ii) përsërit shkeljet e përcaktuara në nënparagrafin 1.2. të këtij neni; (iii) transmeton, ritransmeton, apo shpërndan përmbajtje programore që nxisin urrejtje, dhunë dhe trazira; (iv) transmeton, ritransmeton, apo shpërndan përmbajtje që cenon rendin dhe sigurinë publike; (v) transmeton, ritransmeton, apo bën shpërndarje ilegale të përmbajtjeve programore; dhe (iv) nuk dorëzon në afatin e parashikuar raportin vjetor në KPM.
377. Megjithatë, Gjykata thekson se pavarësisht se neni 60 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit për kundërvajtje sa i përket shumave të gjobave, dispozitat ligjore duhet të jenë të qarta, të parashikueshme dhe në harmoni me normat e të njëjtit akt.
378. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i nenit 60 të Ligjit të kontestuar përcakton mundësinë për shqiptimin e gjobës për shkak që subjekti juridik, (i) transmeton, ritransmeton ose shpërndan shërbime mediale audio dhe audiovizuale në mënyrë të paautorizuar, siç përcaktohet në pikën 1.2.16 të nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) nuk dorëzon raportin vjetor në KPM brenda afatit të parashikuar, siç përcaktohet në pikën 1.2.2 të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar.

379. Megjithatë, për të njëjtat veprime, Ligji i kontestuar përcakton mundësinë e dyfishimit të gjobës së përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht kur (i) transmeton, ritransmeton, apo bën shpërndarje ilegale të përmbajtjeve programore siç përcaktohet në pikën 1.3.5 të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, (ii) nuk dorëzon në afatin parashikuar raportin vjetor në KPM, siç përcaktohet në pikën 1.3.6, të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar.
380. Në këtë kuptim, Ligji i kontestuar, për të njëjtat veprime apo veprime të ngjashme që përcakton shumën e gjobës maksimale prej njëzetmijë (20,000.00) euro në nën-paragrafin 1.2 të paragrafit 1, të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, dhe i mundëson KPM-së që të dyfishoj gjobën përmes paragrafit 3 të Ligjit të kontestuar. Andaj, Gjykata vëren se pikat 1.3.5 dhe 1.3.6 të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, janë në kundërshtim me pikat 1.2.16 dhe 1.2.2 të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, çka i bënë këto norma të paparashikueshme për subjektet të cilave ju drejtohet.
381. Për më tepër dhe në raport me pikën 1.2.1 të nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se përderisa të gjitha përcaktimet tjera sa i përket gjobave janë të specifikuara, kjo dispozitë përmban një formulim të përgjithshëm që ndërlidhet me shkeljen e Ligjit të kontestuar, pa specifikuar saktësisht veprimet që janë subjekt i gjobës. Ngjashëm edhe pika 1.2.24 e nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, përmban formulimin “*nuk respekton obligimet e tjera sipas këtij ligji*”.
382. Gjykata thekson se formulimet e tilla, ashtu siç është theksuar edhe nga Opinioni i Këshillit të Evropës, nuk janë mjaftueshëm të qarta, dhe i japin diskrecion të gjerë KPM-së për të caktuar gjoba ndaj subjekteve që ju drejtohet pa specifikuar në mënyrë të qartë veprimet që dërgojnë në një shkelje të tillë.
383. Prandaj, Gjykata thekson se pika 1.2.1 dhe pika 1.2.24 të nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1 të nenit 60 të Ligjit të kontestuar, nuk plotësojnë kriterin e parashikueshmërisë për subjektet që iu drejtohet, ashtu siç përcaktohet me parimet e lartcekura të qartësisë dhe parashikueshmërisë së normës.
384. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pika 1.2.1 dhe pika 1.2.24 e nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1, dhe pikat 1.3.5 dhe 1.3.6 të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 60 (Sanksionet me gjobë) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës.
385. Në fund, Gjykata rikujton se kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Kjo kategori e kërkesave ka efekt suspensiv në raport me ligjet që kontestohen sepse bazuar në nenin 43 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ligji i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar.
386. Megjithatë, duke qenë se, ndër të tjera, nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së) të Ligjit të kontestuar që përcaktojnë mënyrën e

shqyrtimit dhe rekomandimit të kandidatëve për kryetar dhe anëtar të KPM-së, janë shpallur që nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar pa këto dispozita, do të ishte i pamundur pasi një pjesë e rëndësishme e procedurës për emërimin të anëtarëve të KPM-së do të mbetej e pa rregulluar. Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar duhet të shfuqizohet.

387. Gjykata po ashtu ka theksuar se gjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, ajo është kufizuar në pretendimet e ngritura nga vet parashtruesit e kërkesave dhe nuk ka trajtuar pretendimet e palëve tjera që nuk janë ndërlidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesave. Megjithatë, Gjykata vërejt një numër çështjesh që janë ngritur gjatë procesit të draftimit të Ligjit të kontestuar nga institucionet relevante ndërkombëtare, por edhe nga palët e interesuara përmes komenteve të parashtruara në Gjykatë, përfshirë çështjen e disa nga përkufizimet/definicionet e përcaktuara në nenin 3 (Përkufizimet) të Ligjit të kontestuar, si dhe rregullimin e mediave online. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se i takon Qeverisë dhe/ose Kuvendit që gjatë rishqyrtimit të Ligjit të kontestuar të shqyrtoj tutje çështjet e ngritura përkitazi me përkufizimet/definicionet, si dhe obligimet që parashihen nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim sa i përket legjislacionit të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, dhe për më tepër, Gjykata vë theksin në nevojën për gjithëpërfshirje dhe mundësinë për konsultime përmbajtjesore me palët e interesuara, gjatë rishqyrtimit të Ligjit të kontestuar, duke pasur parasysh ndikimin që i njëjti ka në funksionimin e mediave në Republikën e Kosovës.

VIII. Kërkesa për masën e përkohshme dhe pezullimi i hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar

388. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave kanë kërkuar nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe për të pezulluar hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesat nga Gjykata.
389. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 (Afati) të Ligjit, përcakton efektin suspenziv të hyrjes në fuqi të ligjeve që kontestohen sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duke theksuar se “[...] në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”. Bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata më 26 korrik 2024, kishte kërkuar nga Kryetari i Kuvendit, Presidentja dhe Sekretari i Kuvendit që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit.
390. Andaj, duke marrë parasysh që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, Ligji i kontestuar sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte juridike pa nxjerrjen e vendimit nga Gjykata, si dhe në pajtim me nenin 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesat për masë të përkohshme, janë pa objekt shqyrtimi dhe, si të tilla, refuzohen (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO43/19, parashtrues *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, paragrafi 113, dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 411).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113. 5 dhe 116. 2 të Kushtetutës, në nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 45, 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 16 prill 2025, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesat të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së) i Ligjit Nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nuk janë në përputhshmëri me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË KONSTATOJË se nënparagrafët 3.4 dhe 3.5 të paragrafit 3 të nenit 18 (Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së) i Ligjit Nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nuk janë në përputhshmëri me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË se nënparagrafët 2.4 dhe 2.5 të paragrafit 2 të nenit 4 (Kompetencat e KPM-së), paragrafi 5 i nenit 25 (Leja e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre) dhe paragrafi 2 i nenit 43 (Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve) të Ligjit Nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË se pika 1.2.1 dhe pika 1.2.24 e nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1, dhe pikat 1.3.5 dhe 1.3.6 të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 60 (Sanksionet me gjobë) të Ligjit Nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës;
- VI. TË KONSTATOJË që Ligji Nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, shfuqizohet;
- VII. TË REFUZOJË kërkesat për masa të përkohshme;
- VIII. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve; dhe
- IX. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Jeton Bytyqi

Nexhmi Rexhepi